



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 93**

**28 mars**

**2014**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
VENDIME TË GJYKATËS EUROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT		
Vendim i GJEDNJ datë 25.6.2013	Çështja “Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë” - Ankimet nr. 33192/07 dhe 33194/07.....	3
Vendim i GJEDNJ datë 1.10.2013	Çështja “Hysen Spata kundër Shqipërisë” - Ankimi nr. 19985/13	21
Vendim i GJEDNJ datë 8.10.2013	Çështja “Haxhia Kundër Shqipërisë” - Ankimi nr. 29861/03....	22
Vendim i GJEDNJ datë 8.10. 2013	Çështja “Mulosmani kundër Shqipërisë” - Ankimi nr. 29864/03	36
Vendim i GJEDNJ datë 15.10.2014	Çështja “Shero Vogli kundër Shqipërisë” - Ankimi nr. 18343/11	48
Vendim i GJEDNJ datë 5.11.2013	Çështja “Izet Haxhia kundër Shqipërisë” - Ankimi nr. 34783/06	49

**SEKSIONI I KATËRT I MËPARSHËM  
ÇËSHTJA KAÇIU DHE KOTORRI KUNDËR  
SHQIPËRISË**

*(Ankimet nr. 33192/07 dhe 33194/07)*

**VENDIM  
STRASBURG  
25 qershor 2013**

*Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.*

**Në çështjen Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë,** Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt i Mëparshëm), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

David Thór Björgvinsson, *president,*

Lech Garlicki,

Päivi Hirvelä,

George Nicolaou,

Ledi Bianku,

Nebojša Vučinić,

Vincent A. De Gaetano, *gjykatës,*

dhe Françoise Elens-Passos, *regjistruer i Seksionit,*

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 7 shkurt 2012 dhe 28 maj 2013,

shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:

**PROCEDURA**

1. Çështja e ka zanafillën në dy ankimet (nr. 33192/07 dhe 33194/07) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga dy shtetasit shqiptarë, z. Olsi Kaçiu ("ankuesi i parë") dhe z. Elidon Kotorri ("ankuesi i dytë"), më 13 korrik 2007.

2. Ankuesit u përfaqësuan nga z. H. Kopani, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agjentja e atëhershme e saj, znj. E. Hajro, dhe më pas nga znj. L. Mandia nga zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Ankuesit bënë shumë ankesa sipas neneve 3, 5 §§ 1 dhe 3, 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d), si dhe 7 të Konventës që rrjedhin nga procedimet penale paraqitur ndaj tyre në lidhje me vrasjen e tre personave.

4. Më 21 tetor 2009, presidenti i Seksionit të Katërt vendosi të njoftonte Qeverinë mbi ankimet. Gjithashtu, u vendos të shqyrtohej pranueshmëria dhe meritat e ankimeve në të njëjtën kohë (neni 29 § 1).

5. Më 19 prill 2011, presidenti i Seksionit të Katërt vendosi t'i komunikonte Qeverisë një ankim shtesë. Palët iu përgjigjën me shkrim vëzhgimeve të njëra-tjetrës.

**FAKTET**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

6. Ankuesit kanë lindur përkatësisht në vitin 1979 dhe 1975. Ankuesi i parë banon në Tiranë dhe ankuesi i dytë vuan dënimin me burgim të përjetshëm në Burgun e Sigurisë së Lartë në Peqin (Shqipëri).

**A. Historiku i çështjes**

7. Më 11 janar 2000 tre njerëz u vranë dhe një u plagos rëndë. Raporti i vendit të krimit tregonte se sende të ndryshme, duke përfshirë dy kapuçë dhe dy palë doreza u gjenden në vendin e krimit. Në një prej palëve të dorezave u gjenden fije floku. Në bazë të vendimit të oficerit të policisë gjyqësore, këto sende u dërguan për ekzaminim biologjik për të përcaktuar nëse në to mund të gjendeshin fije floku.

8. Më 22 janar 2000, raporti biologjik i ekspertit konfirmoi se në kapuçat dhe një prej palëve të dorezave u gjetën 12 fije floku me rrënjë.

9. Prokuroria vendosi të fillojë hetimin penal.

**B. Arrestimi i ankuesit të parë**

10. Ankuesi i parë ishte punësuar në biznesin e drejtuar nga familja e ankuesit të dytë.

11. Më 18 prill 2000, pas një kontrolli në apartamentin e tij një ditë më parë, ankuesi i parë u arrestua dhe u akuzua për mbajtje pa leje të municionit të gjetur në apartamentin e tij.

12. Më 19 prill 2000, ai u mor në pyetje nga prokurori. Procesverbali i nënshkruar nga ankuesi deklaroi se ankuesi i parë zgjodhi të përfaqësohej vetë. Gjatë marrjes në pyetje, ankuesi pohoi se municioni gjendej në apartamentin e tij që nga trazirat civile të vitit 1997. Për sa i përket krimit të datës 11 janar 2000, ai bëri deklaratë vetinkriminuese, të cilat, gjithashtu, inkriminonin edhe ankuesin e dytë. Rrjedhimisht, ai u akuzua për moskallëzim të krimit të datës 11 janar 2000.

13. Sipas ankuesit të parë, ai bëri këto deklaratë vetinkriminuese, si rezultat i dhunës së rëndë të ushtruar ndaj tij nga oficerët e policisë më 19 prill. Ai pretendoi se nuk ishte lejuar të takonte avokatin mbrojtës të zgjedhur prej tij gjatë dy javëve në vazhdim.

14. Më 20 prill 2000, ankuesi i parë parashtrori se ai duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e dëgjimit për shkak të gjendjes së dobët shëndetësore dhe se ai kishte shenja të dukshme të keqtrajtimit në fytyrë. Në të njëjtën datë, u konfirmua nga Gjykata e Rrethit të Tiranës ("Gjykata e Rrethit") ligjshmëria e arrestimit të tij. Asnjë afat nuk u caktua mbi kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ankuesi i parë u mbrojt nga një avokat mbrojtës i caktuar nga gjykata, megjithëse ai pretendoi se kishte caktuar një avokat mbrojtës të zgjedhur prej tij. Procesverbali tregonte se avokati mbrojtës i caktuar nga gjykata kishte tërhequr vëmendjen e gjykatës mbi shenjat që tregonin se ankuesi ishte rrahur. Procesverbali, në pjesët përkatëse, përcakton:

[“avokati mbrojtës tha]: Klienti im nuk e pranon akuzën e moskallëzimit të krimit. Ai është rrahur në polici dhe ka shenja” [rrahjeje].

15. Ankuesi i parë apeloj, duke kërkuar ndryshimin e urdhrit të ndalimit të caktuar për të.

16. Më 31 maj dhe 14 korrik 2000, përkatësisht Gjykata e Apelit të Tiranës (“Gjykata e Apelit”) dhe Gjykata e Lartë lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 20 prill 2000, me argumentin se ndalimi i ankuesit të parë bazohej në dyshimin e arsyeshëm se ai kishte kryer shkeljet në fjalë.

### **C. Arrestimi i ankuesit të dytë**

17. Më 11 prill 2000, prokurori lëshoi një urdhërarrestip sipas nenit 76 të Kodit Penal (“KP”) në lidhje me ankuesin e dytë për dyshimin se ka kryer krimin e datës 11 janar 2000.

18. Më 18 prill 2000 u arrestua ankuesi i dytë. Procesverbali i datës 18 prill 2000, me deklarime të bëra nga ankuesi i dytë si person ndaj të cilit zhvillohen hetime, paraqiti një dëshmi të detajuar të aktiviteteve të tij më 11 janar 2000, data në të cilën janë kryer veprat për të cilat ai dyshohej. Ankuesi dha deklarimet në mungesë të një avokati mbrojtës dhe nënshkroi procesverbalin. Ai, gjithashtu, bëri deklarime në lidhje me aktivitetet e tij më 23 dhjetor 1999, datë në të cilën ishte kryer një vrasje tjetër.

19. Më 18 prill 2000, nga ankuesi u morën disa fije floku dhe u dërguan për ekzaminim biologjik. Ankuesi pretendon se fijet e flokëve janë marrë me forcë.

20. Më 19 prill 2000, ankuesi u akuzua sipas nenit 78 të Kodit Penal për disa akuza të vrasjes me paramendim në bashkëpunim me të tjerët, përveç mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit, në lidhje me krimin e datës 11 janar 2000. Dokumenti shprehte se, mbi bazën e një hetimi paraprak, kishte informacione të mjaftueshme për të konstatuar se ankuesi i dytë kishte kryer veprën penale të vrasjes me paramendim në bashkëpunim me të tjerët sipas neneve 78 dhe 25 të KP-së. Ankuesi i dytë u akuzua, gjithashtu, për mbajtje pa leje të armëve të zjarrit sipas nenit 278 § 2 të KP-së.

Në të njëjtën ditë, ankuesi i dytë u pyet nëse dëshironte të përfaqësohej. Ai u përgjigj se do të jepte shpjegime në prani të avokatit mbrojtës të tij, K.S. Ai i nënshkroi të dyja dokumentet.

21. Më 19 prill 2000, prokurori kërkoi vlefshmërinë e arrestimit të ankuesit të dytë. Në të njëjtën ditë, raporti biologjik i ekspertit konfirmoi se flokët e ankuesit të dytë kishin të njëjtat karakteristika morfologjike (makro- dhe mikroskopike) si katër fijet e flokut të gjetura në një nga kapuçat e ekzaminuar më 22 janar 2000.

22. Më 20 prill 2000, u konfirmuar ligjshmëria e arrestimit të ankuesit të dytë nga Gjykata e Rrethit, e cila deklaroi se ankuesi i dytë është akuzuar për veprën penale të vrasjes me paramendim të kryer në

bashkëpunim me të tjerë sipas neneve 78 dhe 25 të KP-së dhe për mbajtje të paligjshme të armëve të zjarrit sipas nenit 278 § 8 i KP-së. Asnjë afat nuk u caktua mbi kohëzgjatjen e ndalimit të tij. Ai u përfaqësua nga një avokat mbrojtës i zgjedhur prej tij. Në të njëjtën seancë gjyqësore, avokati mbrojtës i ankuesit të dytë deklaroi se krahu i klientit të tij ishte mavijosur dhe se ai ishte lënë pa ujë dhe ushqim. Ankuesi i dytë deklaroi se disa fije floku ishin marrë nga koka dhe krahu i tij.

23. Më 6 maj 2000, u morën në mënyrë të ligjshme 6 fije floku nga ankuesi i dytë në praninë e avokatit mbrojtës të tij, A.R., për testin e ADN-së. Meqenëse teste të tilla nuk mund të kryheshin në Shqipëri për shkak të mungesës së teknologjisë përkatëse, u vendos që ekzaminimi i fijeve të flokut të bëhej në Romë, Itali.

24. Më 23 tetor 2000, konstatimet e raportit të ADN-së që ishte kryer në Itali konfirmuan se ADN-ja e flokëve të ankuesit të dytë përputhej me atë të një prej fijeve të flokut të gjetura në një nga kapuçat.

25. Më 20 dhjetor 2000, prokurori shtoi akuzat kundër ankuesit të dytë duke e akuzuar atë për vrasje me paramendim të pesë personave, kryer në vitin 1999, sipas neneve 78 dhe 25 të KP-së. Akuza e fundit u rrëzua për mungesë provash.

26. Më 5 janar 2001, prokurori njoftoi ankuesin e dytë mbi vendimin e tij për të shtuar akuzat kundër tij. Procesverbali i marrjes në pyetje deklaronte se avokati mbrojtës i ankuesit të dytë kërkoi të njihej me provat kundër ankuesit. Atij iu treguan procesverbalet e lartpërmendura të ekspertit të datës 19 prill dhe 23 tetor 2000. Ai u njoftua se do të siguroheshin prova të tjera në kohën e duhur, menjëherë pas përfundimit të hetimit.

### **D. Procedimet penale**

27. Më 12 dhe 19 janar 2001, ankuesit u paraqitën për gjykim: Ankuesi i parë me akuzën për moskallëzim të krimit sipas nenit 300 të Kodit Penal dhe ankuesi i dytë për disa akuza të vrasjes me paramendim dhe vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim me të tjerë, si dhe për mbajtje pa leje të armëve luftarake, sipas neneve 78 dhe 25 dhe 278 § 2 i KP-së. Akuza e mbajtjes pa leje të municionit në lidhje me ankuesin e parë u rrëzua.

28. Në seancat gjyqësore më 26 mars dhe 4 tetor 2001, ankuesi i parë konfirmoi se ai ishte nënshtruar dhunës nga policia gjatë marrjes në pyetje më 19 prill 2000 dhe, si rezultat, kishte bërë deklarata vetinkriminuese duke inkriminuar, gjithashtu, ankuesin e dytë. Ai, gjithashtu, deklaroi se ishte mohuar e drejta e avokatit mbrojtës gjatë dy javëve të para të ndalimit.

Procesverbali i datës 26 mars 2001, në pjesët përkatëse deklaronte:

[Avokati mbrojtës i ankuesit të dytë tha]: [ankuesi i parë] është masakruar dhe rrahur nga policia e Durrësit dhe është detyruar të nënshkruante procesverbalet.

Procesverbali i datës 4 tetor 2001, në pjesët përkatëse, deklaronte:

*"[ankuesi i parë tha]: ato [policia] më çuan në Durrës duke më rrahur e duke më pyetur për Elidonin [ankuesi i dytë]. Për vrasjen nuk di asgjë. Ata filluan të më rrihnin e më thonë se do të lirojmë, po thuaj se [atë] e ka vrarë Elidon Kotorri. Ato mbushën shumë fletë e më thoshin hidh firma. Për vrasjen që ka ndodhur nuk di asgjë.*

*Shpjegimet e para janë marrë me dhunë që s'ka ndodhur asnjëherë. Janë të dokumentuara me shkrim të gjitha. Nuk e pranoj akuzën dhe jam trajtuar keq.*

...

*Nuk jam dakord me ato që tha prokurori...kam kërkuar dhe ato më rrahën edhe më keq. Kam qenë dy javë pa avokat mbrojtës.*

29. Në parashtrimin e tij të fundit të datës 25 tetor 2001, ankuesi i parë nuk e pranoi fajin, duke u bazuar në të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten.

30. Më 1 nëntor 2001, Gjykata e Rrethit shpalli fajtor ankuesin e parë për moskallëzim të krimit dhe e dënoi atë me 3 vjet burgim. Ankuesi i dytë u shpall, gjithashtu, fajtor sipas akuzës dhe u dënua me burgim të përjetshëm.

31. Të dy ankuesit apeluan. Ankuesi i parë u ankua për shkelje të së drejtës së tij për të mos inkriminuar veten si rezultat i deklaratave të nxjerra nën ndikimin e forcës. Ankuesi i dytë u ankua për parregullsi në përgatitjen e procesverbalit të vendit të krimit dhe procesverbaleve të ADN-së. Gjithashtu, ai u ankua se marrja në pyetje e ankuesit të parë më 19 prill 2000 mbi bazën e deklaratave të së cilës ai ishte shpallur fajtor, kishte qenë në shkelje të nenit 167 § 4 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP").

32. Më 29 prill 2002, ekspertin N.C., i cili kishte përgatitur raportin e ADN-së, paraqiti prova para gjykatës, për kryerjen e testit të ADN-së të fijeve të flokut të gjetura në kapuçë dhe të atyre të marrë nga ankuesi i dytë. Ankuesit nuk morën pjesë në seancën gjyqësore, por u përfaqësuan nga avokatët e tyre mbrojtës, të cilët e pyetën ekspertin.

33. Më 10 qershor 2002, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Të dy ankuesit apeluan në Gjykatën e Lartë, duke u bazuar mbi të njëjtat argumente si më parë në Gjykatën e Apelit. Ankuesi i parë u përfaqësua nga avokati mbrojtës N.F. dhe ankuesi i dytë nga avokati mbrojtës G.G.

34. Më 15 janar 2003, Gjykata e Lartë pushoi të dyja vendimet e gjykatave më të ulëta për shkak të parregullsive në procesin e hetimit penal, sidomos në mbledhjen e kapuçave dhe dorezave dhe ekzaminimin e flokëve. Në lidhje me këtë, Gjykata e Lartë deklaroi se procesverbali i vendit të krimit nuk kishte të dhëna në lidhje se me çfarë u gjet në kapuçë, ndërkohë që kishte theksuar fijet e flokut të gjetura në një palë doreza. Meqenëse nuk ishte përgatitur asnjë raport i veçantë, kjo gjë ngrinte pyetje për sa i përket lidhjes së vërtetë ndërmjet fijeve të flokut të gjetura në një nga kapuçat

dhe fijeve të flokut të marra nga ankuesi dhe të dërguara për ekzaminim biologjik më 6 maj 2000. Përveç kësaj, dispozita e përcaktuar në nenin 509 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës, letër-porositë drejtuar autoriteteve të huaja duhet të kanalizohen nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, nuk është respektuar. Gjithashtu, gjykatat më të ulëta nuk kishin marrë në konsideratë disa prova të tjera po aq të rëndësishme, të tilla si informacionet e marra nga bisedat telefonike në lidhje me telefonin celular të ankuesit të dytë, si dhe analizën e shenjave të gishtave, të gjetura në vendin e krimit. Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar shkelje për sa i përket marrjes në pyetje të ankuesit të parë më 19 prill 2000, përderisa ai kishte vendosur të përfaqësonte veten në atë fazë.

#### *1. Seria e parë e procedurave të rigjyimit*

35. Më 28 maj 2003, gjatë procedurës së rigjyimit, oficeri i policisë A.M., i cili kishte qenë në krye të hetimit të vendit të krimit, dëshmoi para gjykatës. Ai u pyet nga të dy ankuesit në lidhje me mbledhjen e provave materiale në vendin e krimit, veçanërisht në lidhje me procedurën për mbledhjen e fijeve të flokut të gjetura në kapuçë. A.M. deklaroi se, ndërsa fijet e flokut mund të dalloheshin me sy të lirë mbi një palë doreza, gjë që u shënua në procesverbalin e vendit të krimit, kapuçat u morën për ekzaminim biologjik për të përcaktuar praninë e fijeve të flokut në mungesë të fijeve të flokut të dallueshme me sy të lirë.

36. N.C. u ripyet, gjithashtu, në një datë të pacaktuar, siç edhe dy dëshmitarët e tjerë.

37. Më 18 korrik 2003, Gjykata e Rrethit e shpalli fajtor ankuesin e parë me akuzën për moskallëzim të krimit duke u bazuar në deklaratën e tij të datës 19 prill 2000. Ai u dënua me dy vjet burgim. Ankuesi i dytë u shpall fajtor për tri akuza të vrasjes sipas neneve 78 dhe 25 të KP-së. Dënimi i tij u bazua në pohimin e fajit nga ankuesi i parë, raportet e ADN-së në lidhje me fijet e flokut dhe raporte të tjera të hetimit penal. Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

38. Të dy ankuesit apeluan. Ata argumentuan se Gjykata e Rrethit nuk kishte vepruar në përputhje të plotë me udhëzimet e vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15 janar 2003 në lidhje me ligjshmërinë e mbledhjes së provave materiale dhe vlerësimin e tyre. Ata, gjithashtu, u ankuan për shkelje të së drejtës së tyre për të mos inkriminuar veten nën ndikimin e forcës.

39. Më 30 shtator 2003, Gjykata e Apelit pushoi vendimin e Gjykatës së Rrethit dhe e ktheu çështjen për rigjykim, duke konstatuar se Gjykata e Rrethit nuk kishte respektuar masat procedurale që duhet të ishin marrë në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 janar 2003. Ajo theksoi, *inter alia*, se gjykatat më të ulëta nuk kishin shqyrtuar ligjshmërinë e administrimit të provave materiale. Prokurori apeloj.

40. Më 10 dhjetor 2003, Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ktheu çështjen për rigjykim së njëjtës gjykatë. Ajo konstatoi se Gjykata e Rrethit kishte vepruar pjesërisht në përputhje me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 janar 2003. Për shembull, ajo kishte thirrur dhe pyetur oficerin e policisë A.M. dhe ekspertin N.C., të cilët kishin dhënë shpjegime të hollësishme për sa i përket procedurës për mbledhjen e provave, identifikimin e fijeve të flokut dhe kryerjen e ekzaminimit biologjik. Dëshmitë e tyre mundësuan Gjykatën të bënte vlerësimin e duhur të vërtetësisë së provave pas paraqitjes së tyre për shqyrtim gjyqësor së bashku me provat e tjera. Megjithatë, Gjykata e Rrethit nuk kishte marrë të dhënat e bisedave telefonike në lidhje me telefonin celular të ankuesit të dytë. Për rrjedhojë, Gjykata e Lartë vendosi se Gjykata e Apelit duhet të kishte gjykuar çështjen mbi pikat e faktit dhe të së drejtës në përputhje me nenin 427 të KPP-së. Nga pesë gjyqtarët, të cilët vendosën apelinin, dy gjyqtarë (K.N. dhe S.S.) kishin qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 15 janar 2003.

#### 2. *Seria e dytë e procedurave penale*

41. Më 23 shtator 2004, kryetari i Gjykatës së Apelit i kërkoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organit përgjegjës për thirrjen, transferimin dhe promovimin e gjyqtarëve, si dhe përfundimin e shërbimit të tyre për të emëruar tre gjyqtarë që të dëgjojnë çështjen kundër ankuesve. Sipas shkresës së tij, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit kishin qenë më parë pjesëtarë të trupit gjykues që kishin dëgjuar çështjen kundër ankuesve.

42. Më 15 tetor 2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi, sipas nenit 28 të aktit të sistemit gjyqësor, të transferojë tre gjyqtarët e Gjykatës Ushtarake të Apelit në Gjykatën e Apelit për të dëgjuar çështjen e ankuesve.

43. Në seancën gjyqësore të datës 2 dhjetor 2004 para Gjykatës së Apelit, ankuesi i dytë, i cili u përfaqësua nga avokati mbrojtës S.G., kërkoi paraqitjen e tre dëshmitarëve N.C., A.M. dhe A.V. Gjykata e Apelit vërejti se dy nga këta dëshmitarë, N.C. dhe A.M. kishin dëshmuar para gjykatave. Ajo e konsideroi të panevojshme thirrjen e dëshmitarit të tretë, A.V., meqenëse dokumentet që gjendeshin në dosjen e çështjes ishin të mjaftueshme për të proceduar dhe për të vendosur mbi çështjen. Avokati mbrojtës argumentoi se provat materiale, domethënë grumbullimi i fijeve të flokut dhe raportet e ADN-së, nuk ishin kryer në përputhje me ligjin dhe nuk kishte pasur asnjë analizë të shenjave të gishtërinjve. Avokatit mbrojtës i është dhënë një orë kohë më shumë, sipas kërkesës, për fjalën e tij përfundimtare.

44. Në parashtrimet e tij përfundimtare, avokati mbrojtës i ankuesit të dytë argumentoi se ankuesi i parë kishte bërë deklaratatë inkriminuese si pasojë e rrahjes.

Avokati mbrojtës kërkoi kohë shtesë prej katër ditësh, me qëllim që të kishte akses në të dhënat e bisedave telefonike dhe të sillte në vëmendje të gjykatës faktet në lidhje me karakterin e pretenduar të turpshëm të një prej viktimave. Gjykata e informoi atë se ajo i kishte trajtuar tashmë këto kërkesa në një vendim të përkohshëm në një seancë gjyqësore të mëparshme. Për sa u përket të dhënave të bisedave telefonike, mbi bazën e një shkresë të ofruesit të shërbimit telefonik, gjykata vendosi se ishte e pamundur marrja e të dhënave të tilla.

45. Përfaqësuesi i ankuesit të parë nuk ishte i pranishëm në të njëjtën seancë gjyqësore. Sipas procesverbalit, ankuesi i parë deklaroi se nuk do të shprehte asgjë dhe se ai ishte dakord me mbrojtjen e avokatit të tij.

46. Në të njëjtën ditë, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit të datës 18 korrik 2003. Ajo konstatoi se të gjitha provat, përkatësisht raportet e ADN-së, deklaratatë inkriminuese e ankuesit të parë dhe prova të tjera mjekoligjore, ishin marrë në mënyrë të ligjshme në përputhje me KPP-në dhe vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 15 janar 2003. Gjykata, duke u bazuar në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 10 dhjetor 2003 (shih paragrafin 40 më lart), deklaroi se rezultatet e testeve të ADN-së konfirmuan se fijet e flokut i përkisnin ankuesit të dytë. Përfundimisht, Gjykata vendosi që ankuesi i dytë të vuajë dënimin e tij në një burg të sigurisë së lartë. Ekstraktet përkatëse të vendimit të Gjykatës së Apelit përcaktojnë si më poshtë:

“Për sa u përket argumenteve të pandehurit në lidhje me shtrirjen e hetimit, duke marrë në pyetje dëshmitarë të tjerë dhe prova shtesë, trupi gjykues vlerëson se, në rigjykimin e çështjes, Gjykata mori parasysh dhe arriti në përfundimin se provat materiale janë marrë në përputhje të plotë me kërkesat e KPP-së dhe, rrjedhimisht, të gjitha çështjet janë zgjidhur ligjërisht. Gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe gjatë ridëgjimit, Gjykata kreu veprime të nevojshme, të cilat në mënyrë të bindshme dhe të plotë konfirmuan vërtetësinë e vlerës provuese të ekzaminimit biologjik të fijeve të flokut, të cilat ishin konfirmuar se i përkasin Elidon Kotorrit [ankuesi i dytë].

...  
Veprimet procedurale, të kryera gjatë hetimit, ishin në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, kjo vlen edhe për përdorimin e provave materiale dhe, mbi këtë bazë, vendimi i gjykatës më të ulët është i bazuar dhe i drejtë. Grumbullimi i fijeve të flokut ishte në përputhje me kërkesat procedurale dhe urdhrat e autoritetit përgjegjës dhe u ekzaminua në laborator. Gjykata, në mënyrë korrekte konstaton se këto prova janë të ligjshme, në lidhje me prova të tjera, sepse... u administruan në përputhje me kërkesat e nenit 508 të KPP-së.

Në shqyrtimin e çështjes, rezulton se nuk ka pasur shkelje të dispozitave kushtetuese të së drejtës së të pandehurit (Elidon Kotorrit). Gjykimi ka qenë i drejtë, i barabartë dhe i ligjshëm. Rezulton se dispozitat procedurale në lidhje me hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin janë zbatuar siç duhet...”

47. Ankuesit apelian.

48. Më 16 shtator 2005, Gjykata e Lartë deklaroi apelinin e tyre të papranueshëm, meqenëse argumentet

e tyre binin jashtë objektit të nenit 432 të KPP-së. Nga pesë gjyqtarë, të cilët vendosën për çështjen më 16 shtator 2005, tre gjyqtarë (K.N., S.S. dhe Y.M.) kishin qenë anëtarë të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 10 dhjetor 2003. Gjyqtarët K.N. dhe S.S. kishin dëgjuar, gjithashtu, apelimet e ankuesve më 15 janar 2003.

49. Të dy ankuesit apeluan para Gjykatës Kushtetuese. Ankuesi i parë argumentoi se ishte shkelur e drejta e tij për të mos inkriminuar veten. Ai ishte detyruar të bënte deklaratat vetinkriminuese në mungesë të avokatit mbrojtës. Ai kishte tërhequr pranimin e fajit nga ana e tij, por, megjithatë ishte dënuar pa prova të tjera bindëse të paraqitura kundër tij. Ai, gjithashtu, u ankua se në seancën gjyqësore të datës 2 dhjetor 2004, Gjykata e Apelit nuk i kishte caktuar atij avokat të caktuar nga gjykata. Ankuesi i dytë u ankua se procedurat gjyqësore kishin qenë të padrejta, meqenëse ishin pranuar deklaratat e pohimeve të ankuesit të parë dhe prova të tjera të marra në mënyrë të paligjshme, përkatësisht provat e fijeve të flokut dhe kryerjen e testeve të ADN-së. Ai pretendoi se nuk ishte njoftuar menjëherë për natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij kur ai ishte arrestuar, meqenëse akuza ishte ricilësuar nga vrasje sipas nenit 76 në vrasje me paramendim sipas nenit 78 të KP-së. Ai deklaroi se nuk kishte pasur mundësi të pyeste disa dëshmitarë. Ai, gjithashtu, argumentoi se Gjykata e Apelit, e cila u mblodh më 2 dhjetor 2004 nuk ishte një “gjykatë e krijuar me ligj”, duke pasur parasysh se në të ishin transferuar tre gjyqtarë nga Gjykata Ushtarake e Apelit.

50. Më 6 shkurt 2007, Gjykata Kushtetuese, e përbërë prej tre gjyqtarësh, i deklaroi ankimet të papranueshme. Ajo arsyetoi se ankimet e ankuesve nuk kanë ngritur asnjë çështje të gjykimit të drejtë, por lidheshin kryesisht me vlerësimin e provave, gjë që është kompetencë e gjykatave më të ulëta.

#### **E. Kohëzgjatja e paraburgimit të ankuesit të dytë**

51. Në një datë të pacaktuar në vitin 2003, ankuesi i dytë kërkoi lirimin e tij, meqenëse kishin skaduar afatet e paraburgimit.

52. Më 31 korrik 2003, Gjykata e Rrethit deklaroi se nuk kishte kompetenca meqenëse meritat e çështjes së ankuesit të dytë ishin vendosur sipas vendimit të saj të datës 18 korrik 2003. Ajo ia kaloi çështjen Gjykatës së Apelit. Ankuesi i dytë apeloj.

53. Më 17 shkurt 2004, Gjykata e Apelit deklaroi se nuk kishte juridiksion dhe e kaloi çështjen në Gjykatën Penale të Apelit në Tiranë (“Gjykata Penale e Apelit”) në përputhje me ligjin e gjykatave penale (*ligji për organizimin dhe funksionimin e gjykatave të krimeve të rënda*). Ankuesi i dytë apeloj.

54. Më 21 prill 2004, Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe ia ktheu çështjen së njëjtës gjykatë. Ajo konstatoi se çështja nuk binte në juridiksionin e gjykatave penale dhe se Gjykata e Apelit

ishte kompetente për të shqyrtuar kërkesën e ankuesit të dytë.

55. Më 28 qershor 2004, Gjykata e Apelit vendosi të shqyrtojë kërkesën në të njëjtën kohë me meritat e çështjes penale. Ankuesi i dytë apeloj.

56. Më 27 korrik, Gjykata e Lartë konstatoi se vendimi i Gjykatës së Apelit ishte në kundërshtim me ligjin dhe e pushoi atë.

57. Më 6 shtator 2004, Gjykata e Apelit rrëzoi kërkesën e ankuesit të dytë dhe konstatoi se nuk ka pasur shkelje të afateve të zbatueshme. Ankuesi i dytë apeloj.

58. Më 8 nëntor 2004, Gjykata e Lartë pushoi vendimin e Gjykatës së Apelit dhe konstatoi shkelje në lidhje me kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit. Ajo e liroi ankuesin e dytë nga paraburgimi dhe e vendosi atë në arrest shtëpie.

#### **F. Pasqyrimi mediatik i gjykimit të ankuesit të dytë**

59. Sipas ankuesit të dytë, media ndërtoi një fushatë të ashpër kundër tij. Ajo krijoi artikuj të shumtë shtypi në mbështetje të parashtrimeve të tij.

60. Dy artikuj të muajit prill 2000 raportuan mbi arrestimin e ankuesit të dytë. Një tjetër artikull i muajit prill 2004 pasqyroj kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit të dytë.

61. Lirimi i ankuesit të dytë nga paraburgimi është përshkruar në gjashtë gazeta në nëntor 2004, me hollësi të barrës financiare të shtetit për mbajtjen e ankuesit të dytë në arrest shtëpie.

62. Detaje të dënimit të ankuesit të dytë dhe dënimit me burgim të përjetshëm nga Gjykata e Apelit, më 2 dhjetor 2004, u raportuan nga gjashtë gazeta në muajin dhjetor 2004.

63. Dy artikuj në muajin prill 2005 e përshkruan shkarkimin e gjyqtarit D.B. nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Sipas artikujve, gjyqtari D.B. kishte qenë anëtar i trupit gjykues të Gjykatës së Apelit, i cili më 30 shtator 2003, kishte vendosur t’ia kalonte çështjen Gjykatës së Rrethit. Ky vendim, i cili, sipas gazetave, kishte ndikuar në shkarkimin e tij, kishte kontribuar në kohëzgjatjen e paraburgimit të ankuesit të dytë.

#### **G. Vendimi i Gjykatës Penale të Apelit në një tjetër set procedimesh gjyqësore**

64. Në një seri më vete procedimesh gjyqësore, në vendimin e saj nr. 33, të datës 10 maj 2006, Gjykata Penale e Apelit e liroi të pandehurin A.L. nga akuza e vrasjes me paramendim në lidhje me krimin e datës 11 janar 2000 (shih paragrafin 7 më lart) për mungesë provash. Dënimi i të pandehurit nga gjykata penale e rrethit ishte bazuar në deklaratën e ankuesit të parë të datës 19 prill 2000, bërë gjatë procedimeve gjyqësore kundër ankuesit të parë (shih paragrafin 12 më lart) dhe mbi raportin e ekspertit për gjurmët e gishtërinjve.

65. Gjykata Penale e Apelit vendosi se deklaratat e ankuesit të parë, bërë gjatë një serie tjetër procedimesh

gjyqësore kundër tij, nuk përbënte prova për qëllimet e procedimeve gjyqësore kundër A.L. në kuptim të nenit 193 § 1 të KPP-së (shih paragrafin 70 më poshtë), që do të shqyrtohej dhe përdorej në lidhje me provat e tjera. Megjithatë, ajo nuk vendosi në lidhje me faktin nëse deklaratat e ankuesit të parë ishte marrë në mënyrë të paligjshme.

## II. E DREJTA PËRKATËSE E BRENDSHME DHE NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

### A. Dispozitat e së drejtës së brendshme

#### 1. Kushtetuta e Shqipërisë

66. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës së Shqipërisë janë përshkruar në vendimin e Gjykatës në çështjen *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, § 28, 10 maj 2011.

#### 2. Kodi i Procedurës Penale

67. Neni 36 parashikon se deklaratat e bëra nga i akuzuari gjatë periudhës së paraburgimit nuk mund të përdoren si prova. Sipas nenit 39, gjatë marrjes në pyetje në periudhën e paraburgimit, i akuzuari informohet mbi akuzën kundër tij dhe provat mbështetëse. I akuzuari ftohet për të dhënë shpjegimet e tij në favor të mbrojtjes së tij dhe, më pas, merret në pyetje. Nëse i akuzuari refuzon të përgjigjet, kjo shënohet në procesverbal.

68. Neni 48 përcakton se i akuzuari ka të drejtë të zgjedhë dy avokatë mbrojtës. Sipas nenit 50, avokati mbrojtës ka të drejtë, *inter alia*, të komunikojë lirshëm dhe privatisht me të akuzuarin, të njoftohet paraprakisht mbi kryerjen e të gjitha veprimeve hetimore, ku i akuzuari është i pranishëm dhe të marrë pjesë në to. Sipas nenit 53 § 2, i akuzuari, i cili është në paraburgim ka të drejtë të komunikojë me avokatin e tij menjëherë pasi është zbatuar masa e sigurisë.

69. Neni 167 § 1 parashikon për personat që ndiqen më vete, por që konsiderohen të pandehur në procedime penale të përbashkëta, të merren në pyetje me kërkesën e palës tjetër apo me të drejtë. Neni 167 § 3 parashikon për personat e përmendur në nenin 167 § 1 që të mbrohen nga një avokat mbrojtës i zgjedhur prej tyre dhe, në mungesë të tij, nga një avokat i caktuar nga Gjykata. Sipas nenit 167 § 4, para fillimit të marrjes në pyetje, Gjykata duhet të informojë personat e përmendur në paragrafin 1 mbi të drejtën e tyre për të mos folur.

70. Neni 193 § 1 lejon pranimin e transkripteve të një grupi tjetër procedimesh gjyqësore në masën që transkriptet lidhen me provat e marra para gjykatës në fazën e hetimit paraprak ose me provat që pranohen në gjykim.

71. Kodi i Procedurës Penale përcakton se një hetim penal mund të fillohet nga një hetues (policia gjyqësore) ose një prokuror me zgjedhjen e tyre, mbi një ankesë të bërë nga një individ, ose duke marrë informacione për veprën e kryer nga burime të tjera (nenet 277 dhe 280-283). Autorizimi për të proceduar duhet të merret në

përputhje me nenin 288 nga Gjykata e Rrethit. Në mungesë të autorizimit, nuk lejohet asnjë masë tjetër procedurale (neni 289). Pas marrjes së autorizimit, prokurori vendos për të filluar procedimin penal, në qoftë se ekzistojnë arsye për të besuar se është kryer një krim, ose për të refuzuar fillimin e procedimit penal sipas nenit 290. Ankuesit duhet t'i dërgohet një vendim i arsyetuar që shpjegon refuzimin për të filluar procedimin penal. Refuzimi për të filluar procedimin penal mund të apelohej në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm (neni 291).

72. Neni 425 përcakton objektin e shqyrtimit të apelimit nga Gjykata e Apelit. Ky nen parashikon se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Apelit nuk kufizohet vetëm me shkaqet e apelimit, por shtrihet në të gjithë çështjen. Sipas nenit 427, me kërkesën e palës, Gjykata e Apelit është e autorizuar të rishqyrtojë provat e mëparshme dhe materiale të reja shtesë nëse ajo e konsideron të nevojshme. Neni 428 përshkruan llojin e vendimeve që Gjykata e Apelit mund të marrë: ajo mund të vendosë pushimin e apelimit dhe lënien në fuqi të vendimit, ndryshimin e vendimit, pushimin e vendimit dhe nuk lejon fillimin e procedimit, ose pushimin e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

73. Apelimet kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit mund të depozitohen në Gjykatën e Lartë në secilën nga rrethanat e mëposhtme, të parashikuara në nenin 432: a) e drejta penale nuk është respektuar ose është zbatuar në mënyrë të gabuar; b) ka pasur shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë e vendimit të Gjykatës në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi; c) ka pasur shkelje procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit. Neni 434 parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton apelimin brenda kufijve të shkaqeve të ngritura.

74. Sipas nenit 509, letër-porositë e gjykatave të brendshme drejtuar një autoriteti të huaj, i dërgohen Ministrisë së Drejtësisë, e cila është përgjegjëse për t'i nisur ato. Në rastet e ngutshme, autoriteti vendas përgjegjës mund të nisë letër-porositë direkt duke informuar Ministrinë e Drejtësisë.

3. *Sistemi gjyqësor (organizimi) akti (ligji nr. 8436, datë 28 dhjetor 1998 – ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë)*

75. Seksioni 8 parashikon se gjykatat ushtarake funksionojnë dhe organizohen brenda sistemit gjyqësor në përputhje me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj. Seksioni 9 shton se gjykatat ushtarake përbëhen nga gjykatat ushtarake të shkallës së parë dhe gjykatat ushtarake të apelit. Gjykata Ushtarake e Apelit shqyrton apelimet kundër Gjykatës Ushtarake të Shkallës së Parë. Ajo përbëhet nga një panel prej tre gjyqtarësh.

76. Gjyqtarët, pavarësisht nëse ata shërbejnë në gjykatat e shkallës së parë ose gjykatat ushtarake, ose civile të apelit, janë të detyruar t'i nënshtrohen formimit

të njëjtë arsimor dhe profesional. Emërimi i tyre, i cili nuk ka afat (seksioni 25), kryhet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë (seksioni 22). Ata janë të pavarur në ushtrimin e detyrave të tyre. Ata mund të largohen nga detyra në rrethana të përcaktuara në mënyrë strikte, përkatësisht kur: i) japin dorëheqjen; ii) arrijnë moshën e pensionit; iii) janë dënuar për një krim me anë të një vendimi të formës së prerë; iv) janë fizikisht ose mendërisht të paafte për kryerjen e detyrave të tyre; v) janë marrë masa disiplinore kundër tyre; vi) dhe, veprimet ose funksionet e tyre janë në kundërshtim me kushtet e përcaktuara në seksionet 29 deri 35 të aktit (seksioni 27).

77. Seksioni 28 përcakton se: “në qoftë se një gjykatë nuk funksionon normalisht për shkak të mungesës së përkohshme të gjyqtarëve ose çështjeve të grumbulluara, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e ministrit të Drejtësisë i transferon gjyqtarët nga një gjykatë në një tjetër për një periudhë prej jo më pak se tre muajsh në vit, madje edhe pa pëlqimin e gjyqtarëve. Në mbarim të periudhës së caktuar, gjyqtari kthehet në punën e tij të mëparshme. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozimin e ministrit të Drejtësisë mund të emërojë një gjyqtar për të dëgjuar çështjet në një gjykatë tjetër të të njëjtit nivel nëse ekziston mungesë gjyqtarësh në këtë Gjykatë.”

#### **B. Dispozitat e së drejtës ndërkombëtare publike**

78. Konventa kundër Torturës dhe Trajtimit Mizor, Çnjerëzor ose Degradues të Dënimit, e cila është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 10 dhjetor 1984 (rezoluta 39/46) dhe e cila ka hyrë në fuqi më 26 qershor 1987, në pjesët përkatëse që lidhen me këtë çështje parashikon:

##### **Neni 1**

“1. Për qëllimet e kësaj Konvente, termi “torturë” nënkupton çdo veprim nëpërmjet të cilit është shkaktuar qëllimisht dhimbje e rëndë ose vuajtje fizike ose mendore mbi një person për qëllime të tilla, siç është marrja prej tij ose prej një personi të tretë e informacioneve ose e një pohimi, duke e dënuar atë për një veprim që ai ose një person i tretë ka kryer ose dyshohet se ka kryer, ose duke e frikësuar apo shtrënguar atë ose një person të tretë, apo për çdo arsye tjetër të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji, kur dhimbje ose vuajtje të tilla janë shkaktuar ose nxitur me pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në një cilësi zyrtare. Ky term nuk përfshin dhimbje ose vuajtje që lindin vetëm nga sanksione të ligjshme, të genësishme apo të rastësishme.

##### **Neni 15**

“Çdo palë shtetërore duhet të garantojë se çdo deklaratë që është siguruar si pasojë e torturës nuk duhet të pranohet si provë në asnjë procedim gjyqësor, me përjashtim të rastit kundër një personi që akuzohet për torturë si provë që vërteton marrjen e deklaratës.”

##### **Neni 16**

“1. Çdo palë shtetërore duhet të ndërmarrë parandalimin në çdo territor të juridiksionit të saj të veprimeve të tjera të trajtimit

mizor, çnjerëzor ose degradues apo ndëshkimit, të cilat nuk përbëjnë torturë siç përcaktohet në nenin 1, kur veprime të tilla kryhen ose nxiten me pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në cilësinë zyrtare. Në veçanti, detyrimet e përfshira në nenet 10, 11, 12 dhe 13 do të zbatohen me zëvendësimin për referencat ndaj torturës me referencat ndaj formave të tjera të trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues apo dënimit.”

79. Konventa hyri në fuqi në lidhje me Shqipërinë më 11 maj 1994.

#### **E DREJTA**

##### **I. BASHKIMI I ANKIMEVE**

80. Duke pasur parasysh se dy ankimet lidhen me të njëjtat fakte dhe procedime të gjykatave të brendshme, Gjykata vendos se ato duhet të bashkohen sipas rregullit 42 § 1 të rregullores së Gjykatës.

##### **II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS**

81. Ankuesi i parë u ankua sipas nenit 3 se ai ishte keqtrajtuar nga oficerët e policisë gjatë paraburgimit të tij dhe se nuk kishte pasur hetim efektiv lidhur me pretendimet e tij. Neni 3 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose degraduese.”

##### **A. Pranueshmëria**

82. Qeveria argumentoi se ankuesi i parë nuk kishte ezauruar mjetet ligjore të brendshme, sepse nuk u ankua formalisht para prokurorit dhe se ankimi ishte depozituar më shumë se gjashtë muaj pas keqtrajtimit të pretenduar. Ankuesi i parë argumentoi se kishte frikë të ankohej te prokurori nga frika se mund të keqtrajtohej përsëri.

83. Gjykata vlerëson se kundërshtimet e Qeverisë lidhen me meritat e ankimit të ankuesit të parë dhe, rrjedhimisht, vendos t’i bashkojë ato me meritat.

84. Meqenëse ky ankim nuk është i papranueshëm për asnjë arsye tjetër, rrjedhimisht, duhet të deklarohet i pranueshëm.

##### **B. Meritat**

###### **1. Parashtrimet e palëve**

85. Ankuesi i parë pretendoi se më 19 prill 2000, ai është rrahur nga oficerët e policisë. Meqenëse ai nuk ishte në gjendje të ecte apo të qëndronte në këmbë, më 20 prill 2000, ai duhej të mbahej nga oficerët e policisë në seancën e tij të parë. Publiku nuk u lejua të merrte pjesë në seancë. Avokati i tij mbrojtës, i caktuar nga Gjykata, parashitroi në seancë se ai ishte rrahur, me qëllim që të nxirrin prej tij pranimin e fajit dhe se ai kishte shenja të dukshme rrahjeje. Megjithatë, autoritetet nuk morën asnjë masë.

86. Qeveria parashitroi se ankuesi i parë nuk kishte paraqitur asnjë detaj për keqtrajtimin e pretenduar. Ai nuk kishte kërkuar asnjëherë të takohej me një mjek. Përfaqësuesi i tij nuk ka bërë kërkesë të tillë me shkrim. Gabimet gramatikore në tekstin e procesverbalit të datës



19 prill 2000, të cilin ai e kishte nënshkruar, ishin për shkak të nivelit të tij të ulët të arsimimit, dhe jo rezultat i keqtrajtimit. Ankuesi nuk ngrii asnjë pretendim keqtrajtimi në apelimet e tij për ligjshmërinë e arrestimit të tij.

## 2. Vlerësimi i Gjykatës

### a) Parime të përgjithshme

87. Neni 3 parashikon një prej vlerave themelore të qeverisë demokratike. Edhe në rrethanat më të vështira, të tilla si: lufta kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, Konventa ndalon në mënyrë absolute torturën ose trajtimin çnjerëzor ose degradues të dënimit, pavarësisht nga sjellja e viktimës. Neni 3 nuk bën asnjë parashikim për përjashtime dhe nuk është i lejueshëm asnjë derogim i tij sipas nenit 15 § 2 edhe në rastin e një emergjence publike, që kërcënon jetën e vendit (*shih Labit kundër Italisë* [GC], nr. 26772/95, § 119, ECHR 2000-IV, dhe *Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 15 nëntor 1996, § 79, raporte të gjykimeve dhe vendimeve 1996-V).

88. Me qëllim që keqtrajtimi të bie brenda objektit të nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij niveli varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si: kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës (*shih Ireland kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 162, seria A nr. 25, dhe *Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, § 67, ECHR 2006-IX).

89. Gjykata ka vlerësuar trajtimin si çnjerëzor, sepse, *inter alia*, ishte i paramenduar, është aplikuar për orë pa ndërprerje dhe ka shkaktuar ose dëmtime të dukshme trupore ose vuajtje të mëdha fizike dhe mendore. Trajtimi është pranuar si degradues kur ishte i tillë që shkaktonte te viktimat ndjenjën e frikës, ankthit dhe inferioritetit që mund të shkaktonte poshtërimin dhe përluljen e tyre dhe mundësisht thyerjen e qëndrueshmërisë së tyre fizike ose morale, ose kur ishte i tillë që e nxiste viktimën të vepronte kundër vullnetit ose vetëdijes së tij (shih, ndërmjet të tjerash, *Keenan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 27229/95, § 110, ECHR 2001-III; *Labita*, cituar më lart, § 120; *Ramirez Sanchez kundër Francës* [GC], nr. 59450/00, § 118, ECHR 2006-IX; dhe *Jalloh*, cituar më lart, § 68).

90. Në përcaktimin nëse një formë e veçantë e keqtrajtimit duhet të konsiderohet si torturë, duhet marrë në konsideratë dallimi, parashikuar në nenin 3, ndërmjet këtij nocioni dhe atij të trajtimit çnjerëzor ose degradues. Siç Gjykata ka konstatuar paraprakisht, duket se ishte synimi që Konventa duhet, nëpërmjet një dallimi të tillë t'i bashkëngjisë një vulë të veçantë trajtimit të qëllimshëm çnjerëzor që shkaktonte vuajtje shumë të rënda dhe mizore (shih vendimi i *Irandës kundër the Mbretërisë së Bashkuar*, cituar më lart, §

167; *Aksoy kundër Turqisë*, 18 dhjetor 1996, § 63, raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1996-VI dhe *Selmouni kundër Francës* [GC], nr. 25803/94, § 96, ECHR 1999-V). Përveç ashpërsisë së trajtimit ekziston një element i qëllimshëm i torturës, i njohur, gjithashtu, në Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimit tjetër Mizor, Çnjerëzor ose Degradues ose Dënimit, i cili në nenin 1 e përcakton torturën në aspektin e shkaktimit të qëllimshëm të dhimbjes ose vuajtjes së rëndë për qëllime, të tilla si: marrja e informacionit ose pohimit, dënimi, frikësimi, shtrëngimi, ose për çdo arsye të bazuar në diskriminimin e çfarëdo lloji, kur dhimbje ose vuajtje e tillë shkaktohet nga ose me nxitjen apo pëlqimin ose pranimin e një zyrtari publik apo personi tjetër që vepron në cilësinë zyrtare (shih *Dikme kundër Turqisë*, nr. 20869/92, § 94, ECHR 2000-VIII; *Mikheyev kundër Rusisë*, nr. 77617/01, § 149, 26 janar 2006; dhe *Savitsky kundër Ukrainës* nr. 38773/05, § 127, 26 korrik 2012).

91. Pretendimet për keqtrajtimit duhet të mbështeten me prova përkatëse. Në vlerësimin e provave të keqtrajtimit, Gjykata në përgjithësi ka pranuar standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm.” Prova të tilla mund të rezultojnë nga bashkëzistenca e konkluzioneve mjaftueshmërisht të forta, të qarta dhe përkuese ose nga supozime të ngjashme të pakundërshtueshme të faktit (*Gök dhe Güler kundër Turqisë*, nr. 74307/01, § 33, 28 korrik 2009).

92. Kur ngjarjet në çështje shtrihen tërësisht ose në pjesën më të madhe në dijeninë ekskluzive të autoriteteve, si në rastin e personave brenda kontrollit të tyre në paraburgim, do të lindin supozime të forta të faktit në lidhje me dëmtimet e shkaktuara gjatë paraburgimit. Në të vërtetë, barra e provës mund të konsiderohet se u përket autoriteteve për të siguruar një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës (shih *Salman kundër Turqisë* [GC], nr. 21986/93, § 100, ECHR 2000-VII). Në veçanti, kur një individ, pasi merret në paraburgim, gëzon shëndet të mirë, por konstatohet se është dëmtuar në kohën e lirit, çdo dëmtim i tillë do të çojë në një supozim të fortë se personi i është nënshtruar keqtrajtimit (shih *Bursuc kundër Rumanisë*, nr. 42066/98, § 80, 12 tetor 2004). Është detyrë e shtetit të sigurojë një shpjegim të arsyeshëm se si janë shkaktuar dëmtimet, dështimi i të cilit lind një çështje të qartë sipas nenit 3 të Konventës (shih *Selmouni*, cituar më lart, § 87).

93. Për më tepër, kur një individ bën një pretendim të argumentueshëm se ai ka vuajtur trajtimin në shkëlqje të nenit 3 në duart e Policisë apo agentëve të tjerë të shtetit, kjo dispozitë parashikon në lidhje me detyrimin e përgjithshëm të shtetit sipas nenit 1 të Konventës “Garantimin e secilit brenda juridiksionit mbi të drejtat dhe liritë e përcaktuara në ... Konventë”, kërkon sipas nënkuptimit se duhet të ketë një hetim zyrtar efektiv.

Një hetim i tillë duhet të ketë aftësinë të çojë në krijimin e fakteve të çështjes dhe, në qoftë se akuzat vërtetojnë se është e vërtetë, në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës (shih, ndërmjet autoriteteve të tjera, *Labita*, cituar më lart, § 131; *Boicenco kundër Moldavisë*, nr. 41088/05, § 120, 11 korrik 2006; dhe *Lopata kundër Rusisë*, nr. 72250/01, § 109, 13 korrik 2010).

**b) Aplikimi i parimeve përkatëse në çështjen në fjalë**

94. Ankuesi i parë u mbajt në paraburgim më 19 prill 2000. Gjatë periudhës së paraburgimit, ai pretendoi se ishte rrahur nga oficerët e policisë gjatë marrjes në pyetje, me qëllim që të detyrohej të nënshkruante pranimin e fajit. Ai vazhdimisht i bëri të njëjtat parashtrime autoriteteve gjyqësore, në publik dhe në prani të prokurorit, në paraqitjen e tij të parë më 20 prill 2000 (kur ai u përfaqësua nga një avokat mbrojtës i caktuar nga gjykata, i cili tërhoqi vëmendjen e gjykatës ndaj shenjave të dukshme të ankuesit që ishte rrahur), para gjykimit më 26 mars dhe 4 tetor 2001 dhe gjatë apelimeve të tij të mëvonshme. Më tej, ai deklaroi se ai ishte detyruar të mbahej në seancën e parë me ndihmën e oficerëve të policisë.

95. Gjykata vëren se me gjithë mungesën e çfarëdo përkrahimi të plagëve të shkaktuara, ankuesi ngriti me shumë se një “pretendim të argumentuar” para autoriteteve vendase se ai ishte rrahur rëndë gjatë periudhës së qëndrimit të tij në paraburgim. Pretendimi i tij krijoi prezumimin e faktit se ankuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit të parashikuar nga neni 3 në duart e agjentëve të shtetit dhe i kërkonte Qeverisë të jepte një shpjegim të arsyeshëm se si mund të ishte shkaktuar rrahja e pretenduar.

96. Qeveria, nga ana e saj, nuk ka paraqitur asnjë shpjegim të arsyeshëm për rrahjen e pretenduar. Për shembull, nuk u argumentua asnjëherë se rrahja ishte rezultat i veprimeve të paligjshme nga ana e bashkëvuajtësve apo se ankuesi i kishte pasur shenjat e rrahjes para arrestimit të tij. As nuk ishte kundërshtuar se ankuesi duhej të mbahej nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit për shkak të gjendjes së tij të dobët shëndetësore, si rezultat i rrahjeve të rënda që kishte pësuar. Në lidhje më këtë, Gjykata rithekson se ekzaminimet përkatëse mjekësore përbëjnë garanci thelbësore kundër keqtrajtimit (shih *Akkoç kundër Turqisë*, nr. 22947/93 dhe 22948/93, §§ 55 dhe 118, ECHR 2000-X; *Parnov kundër Moldavisë*, nr. 35208/06, § 30, 13 korrik 2010) para, gjatë dhe me lirim nga paraburgimi.

97. Ndërkohë, ankuesi vazhdimisht dhe fuqimisht argumentoi gjatë gjithë procedimeve të brendshme se ai ishte rrahur brutalisht. Megjithëse autoritetet u vunë në dijeni të rrahjes së ankuesit, prokurori nuk urdhëroi

ekzaminimin mjekësor, nuk kërkoi prova të tjera, nuk hapi hetim penal ose, në të vërtetë nuk ndërmori asnjë hap për të hetuar pretendimet serioze dhe të përsëritura të ankuesit. Gjithashtu, gjyqtari nuk kërkoi në seancën fillestare hetimin e shqetësimit të qartë fizik të ankuesit. Prandaj, ishte e arsyeshme për ankuesin të vlerësonte se, përveç mbrojtjes së tij ndaj akuzave penale, mjetet e tjera ligjore të brendshme ishin joefektive (shih *Göçmen kundër Turqisë* nr. 72000/01, § 49, 17 tetor 2006; *Veznedaroğlu kundër Turqisë*, nr. 32357/96, § 34, 11 prill 2000; dhe *Aksoy kundër Turqisë*, 18 dhjetor 1996, §§ 54-57, *raportet e vendimeve dhe gjykimeve* 1996-VI). Mbi këtë bazë, duhet të rrëzohet kundërshtimi paraprak i Qeverisë bazuar në mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore. Meqenëse pretendimet e ankuesit ishin ngritur si pjesë e mbrojtjes së tij në të gjitha fazat e procedimit penal, paraqitja e kësaj ankese, brenda gjashtë muajve të përfundimit të këtyre procedimeve penale (vendimi i Gjykatës Kushtetuese, datë 6 shkurt 2007), ishte brenda afateve të përfshira në nenin 35 § 1.

98. Gjykata më tej pranon se rrahja e ankuesit ishte e një shkalle të tillë që ai duhej të mbahej për në sallën e gjyqit nga oficerët e policisë. Konkluzione mund të nxirren në masën që një trajtim i tillë, i cili kishte lënë gjurmë të dukshme në ankuesin, siç u provua në seancën e datës 20 prill 2000, është ushtruar qëllimisht nga oficerët e policisë gjatë marrjes së tij në pyetje. Rrahja e shkaktuar ndaj ankuesit mund të lindte tek ai ndjenjën e frikës dhe të ankthit që mund ta poshtëronte dhe përulte atë, si dhe thyente qëndrueshmërinë e tij fizike ose morale, me qëllim që ta detyronin të pranonte fajin.

99. Në fakt, sekuenca e ngjarjeve dëshmon se ankuesi i është nënshtruar sjelljes së dënueshme të oficerëve të policisë, me shumë gjasa për një periudhë të konsiderueshme kohe si pasojë e së cilës ai bëri deklarata ku inkriminonte veten dhe ankuesin e dytë me shpresën se do t'i jepte fund dhimbjes së rëndë fizike dhe mendore të shkaktuar ndaj tij. Trajtimi për të cilin ankohej ishte i një shkalle të tillë që përbënte torturë në kuptim të nenit 3 të Konventës.

100. Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës, si për sa i përket anës thelbësore ashtu edhe procedurale.

**III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 5 §§ 1 DHE 3 E KONVENTËS**

101. Të dy ankuesit u ankuan se paraburgimi i tyre nuk bazohej në dyshimin e arsyeshëm të kryerjes së veprës penale, në shkelje të nenit 5 § 1 të Konventës. Ankuesi i dytë u ankua, gjithashtu, për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij sipas nenit 5 § 3 të Konventës. Neni 5, në masën që lidhet me çështjen, parashikon si më poshtë.

“1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj: ...

c) Arrestimi i ligjshëm ose ndalimi i një personi, zbatuar me qëllimin e dërgimit të tij para autoritetit ligjor kompetent me dyshimin e arsyeshëm se ka kryer një shkelje ose kur vlerësohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen nga ana e tij, të një shkeljeje ose arratisjen pas kryerjes së shkeljes; ...

3. Çdo person që arrestohet ose burgoset në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 (c) të këtij neni, duhet të silltet menjëherë para një gjyqtari apo oficeri tjetër të autorizuar me ligj për të ushtruar funksionin gjyqësor dhe i njihet e drejta të gjykohe brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimin. Lirimi mund të kushhtëzohet me garancitë për t'u paraqitur për”

102. Ankuesi i parë kundërshtoi vlefshmërinë e arrestimit të tij para gjykatave të brendshme dhe vendimi i Gjykatës së Lartë, i datës 14 korrik 2000, ishte vendimi përfundimtar në këtë drejtim. Meqenëse ankuesi i parë depozitoi ankimin e tij sipas nenit 5 § 1 në këtë Gjykatë, më 13 korrik 2007, ky ankim është paraqitur jashtë afatit gjashtëmuor dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës. Ankuesi i dytë u arrestua më 18 prill 2000. Arrestimi i tij u konfirmua sipas vendimit të Gjykatës së Rrethit të datës 20 prill 2000 dhe ai nuk apeloj kundër këtij vendimi. Për rrjedhojë, Gjykata rrëzon ankimin e tij sipas nenit 5 § 1 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

103. Për sa i përket ankimit të ankuesit të dytë, sipas nenit 5 § 3, për kohëzgjatjen e paraburgimit të tij, Gjykata thekson se paraburgimi përfundon për qëllimet e Konventës me shpalljen e fajësisë dhe caktimin e dënimit në shkallë të parë (*Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 68, 8 dhjetor 2009). Megjithëse, paraburgimi i ankuesit të dytë përfundoi më 2 dhjetor 2004 kur Gjykata e Apelit dha vendimin e saj duke e dënuar atë, ai nuk paraqiti këtë ankim deri në korrik 2007. Rezulton se ky ankim duhet të rrëzohet si i parashkruar jashtë afatit në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

#### IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

104. Ankuesi i parë u ankua sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (c) se i është mohuar e drejta e avokatit mbrojtës gjatë dy javëve të para të paraburgimit të tij, përfshirë periudhën gjatë paraburgimit kur ai bëri deklaratat inkriminuese.

105. Sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) të Konventës, ankuesi i dytë u ankua se procedimet kishin qenë të parregullta në masën që lidheshin me pranueshmërinë dhe vlerësimin e provave, dhe në masën që atij nuk i ishte dhënë koha e mjaftueshme dhe lehtësitë për të përgatitur mbrojtjen e tij, për të pasur përfaqësim ligjor dhe për të pyetur dëshmitarët. Ai më tej pretendoi se trupi gjykues i Gjykatës së Lartë, i datës 16 shtator 2005 dhe 10 dhjetor 2003, nuk ka shfaqur paanshmëri dhe se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 6 shkurt 2007, nuk është arsyetuar siç duhet.

106. Sipas nenit 6 § 1 të Konventës të dy ankuesit argumentuan se trupi gjykues i Gjykatës së Apelit, i datës 2 dhjetor 2004, nuk përbënte “një gjykatë të krijuar me ligj” dhe se kohëzgjatja e procedimeve ishte e tepërt.

107. Sipas nenit 6 § 2, ata u ankuan se e drejta e tyre për t'u prezumuar të pafajshëm ishte shkelur si pasojë e fushatës së medias të bërë kundër ankuesit të dytë.

Pjesët përkatëse të nenit 6 të Konventës parashikojnë si më poshtë.

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht... nga një gjykatë... e pavarur ..., e cila do të vendosë...”

2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale presupozohet i pafajshëm deri kur vërtetohet fajtor sipas ligjit.

3. Çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet menjëherë, në një gjuhë që ai kupton dhe në mënyrë të hollësishme mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij;

b) të ketë kohën e mjaftueshme dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas nga një avokat i caktuar kryesisht kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

...”

#### A. Ankimi i ankuesit për shkeljen e nenit 6 §§ 1 dhe 3 të Konventës

##### 1. Pranueshmëria

108. Qeveria nuk ka ngritur asnjë bazë të papranueshmërisë në lidhje me këtë ankim.

109. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Ajo më tej konstaton se nuk është i papranueshëm për asnjë arsye tjetër. Për rrjedhojë, ky ankim duhet të deklarohej i pranueshëm.

##### 2. Meritat

##### a) parashtrimet e palëve

110. Ankuesi i parë parashitroi se ishte keqtrajtuar dhe detyruar për të bërë deklaratat vetinkriminuese. Familja e tij kishte caktuar një avokat mbrojtës menjëherë pas arrestimit të tij, por ai nuk ishte lejuar të konsultohet me të për dy javë me rezultatin se avokati mbrojtës nuk ishte i pranishëm kur ai bëri këto deklaratat, dhe as nuk ishte i pranishëm gjatë paraqitjes së tij fillestare në gjyq më 20 prill 2000.

111. Ankuesi i dytë kundërshtoi përdorimin e deklaratës së ankuesit të parë që inkriminonte atë, meqenëse ishte marrë nga keqtrajtimi në kundërshtim me nenin 3 të Konventës.

112. Qeveria e kundërshtoi pretendimin e ankuesit të parë, duke argumentuar se ai e kishte nënshkruar pranimin e fajit me vullnetin e tij të lirë. Sipas Kodit të Procedurës

Penale hetuesit kishin të drejtë të mblidhnin prova në mungesë të avokatit mbrojtës të të akuzuarit. Ankuesi i parë ose familja e tij mund të kishin caktuar një avokat të zgjedhur prej tij ose prej tyre në çdo fazë të procedimit, dhe ata nuk ishin penguar për të vepruar në këtë mënyrë.

113. Për sa i përket ankuesit të dytë, Qeveria parashtroi se deklarata e ankuesit të parë ishte vërtetuar nga prova të tjera dhe nuk kishte shërbyer për të dënuar ankuesin e dytë.

#### **b) Vlerësimi i Gjykatës**

##### *i) Parime të përgjithshme*

114. Gjykata rithekson se, si rregull aksesi për avokatin mbrojtës duhet të sigurohet që në radhën e parë të marrjes në pyetje të një të dyshuari nga policia, përveç nëse dëshkohet në dritën e rrethanave të veçanta të çdo çështjeje, se ekzistojnë arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë. Të drejtat e mbrojtjes, në parim do të cenohen në mënyrë të pandreqshme kur përdoren për dënim deklaratat inkriminuese, të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa aksesin për avokat mbrojtës. (*Salduz kundër Turqisë* [GC], nr. 36391/02, § 55, 27 nëntor 2008).

115. Nuk është detyrë e Gjykatës të merret me gabimet e faktit ose të së drejtës, të kryera nga një gjykatë e brendshme, përveçse në masën kur ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa. Ndërsa neni 6 garanton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave si të tilla, gjë që kryesisht është çështje rregullimi sipas të drejtës së brendshme (shih *Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, § 94, ECHR 2006-IX; *Schenk kundër Zvicrës*, 12 korrik 1988, §§ 45-46, seria A, nr. 140; dhe *Teixeira de Castro kundër Portugalisë*, 9 qershor 1998, § 34, raportet 1998-IV).

116. Gjithashtu, nuk është roli i Gjykatës për të përcaktuar, si parim i përgjithshëm, nëse lloje të veçanta provash – për shembull, të dhënat e marra në mënyrë të paligjshme në aspektin e të drejtës së brendshme – mund të jenë të pranueshme ose, në të vërtetë, nëse ankuesi ishte fajtor ose jo. Pyetja që kërkon përgjigje është nëse ishte e drejtë procedura në tërësi, duke përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat. Kjo përfshin shqyrtimin e paligjshmërisë në fjalë dhe, kur ka të bëjë me shkeljen e një të drejte tjetër të Konventës, llojin e shkeljes së konstatuar (shih *Jalloh*, cituar më lart, § 95; *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, § 34, ECHR 2000-V; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 76, ECHR 2001-IX; dhe *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48539/99, § 42, ECHR 2002-IX).

117. Vlerësime të veçanta zbatohen në lidhje me përdorimin në procedimet penale të provave të marra në shkelje të nenit 3. Kështu, pranimi i deklaratave të

marra si rezultat i torturës ose keqtrajtimit tjetër në shkelje të nenit 3 si dëshmi për të vendosur faktet përkatëse në procedimet penale e bën procedimin në tërësi të padrejtë, pavarësisht nga vlera provuese e deklaratave, dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre është vendimtar për të siguruar dënimin e të pandehurit (shih *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, §§ 165-166, ECHR 2010).

*ii) Zbatimi i parimeve përkatëse në çështjen e ankuesit të parë*

118. Gjykata ka konstatuar në çështjen në fjalë se deklaratat e ankuesit të parë, të cilat inkriminonin si atë vetë ashtu edhe ankuesin e dytë ishin marrë si rezultat i torturës. Ajo vëren se gjykatat e brendshme i pranuan këto deklarata në prova. Në dritën e parimit të përcaktuar në *Gäfgen*, cituar më lart, Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për këtë arsye.

119. Për më tepër, deklaratat inkriminuese të ankuesit përcaktonin se ai kishte vendosur të fliste në mungesë të avokatit mbrojtës. Gjykata vëren se Qeveria nuk iu përgjigj pretendimit të ankuesit se atij i është refuzuar aksesi për avokatin e tij mbrojtës dhe nuk argumentoi se atij i është kujtuar e drejta e tij për të mos folur në mungesë të avokatit mbrojtës dhe për pasojat që rridhnin nga deklarata të bëra pa u konsultuar me një avokat mbrojtës. Gjykata më tej vlerëson se duke pasur parasysh torturën së cilës i është nënshtruar ankuesi i parë, si rezultat i së cilës ai mund të ketë dashur t'i japë fund vuajtjeve të tij, nuk mund të thuhet se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij e aksesit për avokat mbrojtës në mënyrë të prerë, pa presion.

120. Nëse, siç pretendon Qeveria, ankuesi kishte nivel të ulët arsimimi (shih paragrafin 86 më lart), ky fakt duhet të kishte kërkuar kujdes të mëtejshëm nga ana e autoriteteve (shih *Plonka kundër Polonisë*, nr. 20310/02, § 38, 31 mars 2009). Gjykata vëren se Qeveria nuk ka kërkuar, e aq më pak dëshmuar, se ekzistonte një arsye bindëse për të kufizuar aksesin e ankuesit të parë për avokat mbrojtës para dhënies së deklaratave të tij (shih paragrafin 112 më lart). Deklaratat e paditura janë përdorur në gjyq dhe, në fakt, kanë shërbyer si baza e vetme për dënimin e ankuesit (shih paragrafët 37 dhe 46 më lart). As ndihma e dhënë më vonë nga avokatët mbrojtës dhe as natyra kundërshtuese e procedimeve në vijim nuk mund të ndreqnin këtë defekt (shih *Salduz*, cituar më lart, § 58).

121. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me nenin 6 § 3 (c) për sa i përket ankuesit të parë.

*iii) Zbatimi i parimeve në çështjen e ankuesit të dytë*

122. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se ankuesi i dytë është dënuar, *inter alia*, mbi bazën e deklaratave inkriminuese, të bëra nga ankuesi i parë. Këto deklarata

ishin marrë si pasojë e shkeljes së nenit 3. Në rastin konkret, Gjykata, për rrjedhojë, duhet të vendosë peshën që duhet t'i jepet deklaratave inkriminuese të një pale të tretë, të cilat janë marrë si rezultat i torturës dhe të cilat janë përdorur më pas në gjyq për dënimin e të akuzuarit.

123. Në këtë drejtim, Gjykata duhet të shqyrtojë tendencat në praktikat e saj ligjore në lidhje me përdorimin e deklaratave inkriminuese të marra në shkelje të nenit 3.

a) *Në lidhje me përdorimin në gjyq të deklaratave vetinkriminuese të të vetakuzuarit të marra në shkelje të nenit 3*

124. Gjykata ka përcaktuar se deklaratat vetinkriminuese të ankuesit, të marra në shkelje të nenit 3, pavarësisht nga klasifikimi i keqtrajtimit dhe, të cilat janë përdorur në gjyqin e tij, pavarësisht nga vlera e tyre provuese, e bënë gjykimin në tërësi të padrejtë (shih, për shembull, *Levința kundër Moldavisë*, nr. 17332/03, 16 dhjetor 2008; *Stanimirović kundër Serbisë*, nr. 26088/06, 18 tetor 2011; *Iordan Petrov kundër Bullgarisë*, nr. 22926/04, 24 janar 2012; *Grigoryev kundër Ukrainës*, nr. 51671/07, 15 maj 2012; *Hajnal kundër Serbisë*, nr. 36937/06, 19 qershor 2012).

125. I vetmi përjashtim i praktikës së mësipërme ligjore është vendimi në rastin e *Alchagin kundër Rusisë* (nr. 20212/05, 17 janar 2012), nëpërmjet të cilit deklarata e pranimit të fajit që ishte marrë si pasojë e trajtimit çnjerëzor dhe degradues në kundërshtim me nenin 3, nuk çonte në shkelje automatike të gjykimit të përgjithshëm të ankuesit, për shkak të faktit se deklarata e pohimit të fajit ishte bërë fillimisht në prani të një avokati mbrojtës, se ishte mbrojtur në gjykim dhe se të drejtat e ankuesit për mbrojtje ishin garantuar në gjykim.

β) *Në lidhje me përdorimin në gjykimin e të akuzuarit të deklaratave inkriminuese të një pale të tretë, të marra si rezultat i torturës në shkelje të nenit 3*

126. Gjykata rithekson se në çështjen e *Harutyunyan kundër Armenisë* (nr. 36549/03, ECHR 2007-III), ajo konstatoi, *inter alia*, se përdorimi i deklaratave të dëshmitarëve që ishin marrë nga tortura, siç përcaktohej nga gjykatat e brendshme, dhe të cilat ishin përdorur në gjykimin e ankuesit për të siguruar dënimin e tij, e bënë gjykimin në tërësi të padrejtë.

127. Në çështjen e *Othman (Abu Qatada) kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 8139/09, 17 janar 2012), në lidhje me mohimin e pretenduar flagrant të drejtësisë për sa i përket ankuesit që përballet me deportim në Jordani për të dalë në gjyq, Gjykata vendosi se pranimi i deklaratave të bashkëpandehurit, të cilat ishin marrë nga tortura dhe inkriminonin ankuesin, përbënin shkelje të nenit 6 të Konventës në rastin e deportimit të ankuesit dhe gjykimit në Jordani.

128. Për rrjedhojë, Gjykata konkludon se pranimi në prova i deklaratave inkriminuese të marra nga një palë e

tretë si rezultat i torturës e bën procedimin në tërësi të padrejtë, pavarësisht nëse prova të tilla ishin vendimtare për të siguruar dënimin e ankuesit. Prova të tilla nuk duhet të marrin petkun e ligjshmërisë dhe të përdoren në gjyq për dënimin e të akuzuarit, meqenëse mund të dëmtojnë në mënyrë të pandreqshme drejtësinë e gjykimit (shih, *mutatis mutandis*, *Gäfgen*, cituar më lart § 167; dhe, *Salduz*, cituar më lart, § 55).

γ) *Konkluzion*

129. Për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se gjykimi i ankuesit të dytë në tërësi ishte i padrejtë për shkak të pranimit dhe përdorimit të deklaratave inkriminuese të ankuesit të parë, të marra nga tortura.

130. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë.

**B. Në lidhje me pjesën e mbetur të ankimeve të ankuesit sipas nenit 6 § 1 të Konventës**

*1. Mungesa e pretenduar e paanshmërisë së Gjykatës së Lartë*

131. Ankuesi i dytë u ankua për mungesë paanshmërie të trupit gjykues të Gjykatës së Lartë më 10 dhjetor 2003 dhe 16 shtator 2005.

132. Qeveria parashtroi se ankuesi i dytë nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore.

133. Gjykata vëren se ankuesi i dytë nuk arriti të ngrejë këtë ankesë para Gjykatës Kushtetuese, e cila është kompetente për të shqyrtuar të gjitha çështjet e drejtësisë sipas nenit 6. Rrjedhimisht, Gjykata çmon se ky ankim duhet të pushohet për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore dhe të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

*2. Mungesa e pretenduar e arsyeve në vendimin e Gjykatës Kushtetuese*

134. Ankuesi i dytë u ankua se vendimi i Gjykatës Kushtetuese i datës 7 shkurt 2007 nuk është arsyetuar siç duhet.

135. Gjykata vëren se kur Gjykata Kushtetuese nuk pranon apelin kushtetues me argumentin se nuk është plotësuar baza ligjore për çështjen, kërkesat e nenit 6 të Konventës mund të plotësohen nga një arsyetim shumë i kufizuar (shih, ndër të tjera, *Jakupi kundër Shqipërisë* (dec.), nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009). Për më tepër, Gjykata thekson konstatimet e saj në paragrafin 129 më lart lidhur me padrejtësinë e pretenduar të procedimeve.

136. Për arsyet e mësipërme, Gjykata çmon se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

*3. Ankimi se Gjykata e Apelit e datës 2 dhjetor 2004 nuk ishte "gjykatë e krijuar me ligj"*

137. Ankuesit parashtroan se përbërja e Gjykatës së Apelit, e datës 2 dhjetor 2004, ishte e paligjshme, pasi gjyqtarët ishin gjyqtarë ushtarakë. Ankuesit gjyquan se procedura e ndjekur ishte në shkelje të së drejtës dhe kontestuan vendimin e marrë nga Këshilli i Lartë i

Drejtësisë. Sipas tyre, Këshilli i Lartë i Drejtësisë duhet t'i kishte transferuar gjyqtarët nga gjykata të tjera të zakonshme të apelit në vend që t'i transferonte nga gjykata ushtarake e apelit.

138. Qeveria parashtroi se tre gjyqtarët e Gjykatës Ushtarake të Apelit ishin transferuar për të dëgjuar çështjen pasi të gjithë gjashtëmbëdhjetë gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, në një fazë të caktuar të procedimeve, ishin përfshirë në dëgjimin e ankimeve të paraqitura nga ankuesit. Transferimi ishte bërë për të garantuar paanshmërinë e trupit gjykues dhe ishte në përputhje me të drejtën e brendshme.

139. Sipas nenit 6 § 1 të Konventës, një "gjykatë" gjithmonë duhet "të krijohet me ligj". Kjo frazë pasqyron parimin e shtetit ligjor që është i natyrshëm në të gjithë sistemin e Konventës dhe protokollat e tij. Frazja "i krijuar me ligj" pasqyron jo vetëm legjislacionin lidhur me krijimin dhe juridiksionin e një gjykate (shih *Lavents kundër Latvia*, nr. 58442/00, § 114, 28 nëntor 2002), por, gjithashtu, edhe përbërjen e trupit gjykues në çdo rast (shih *Buscarini kundër San Marino* (dec.), nr. 31657/96, 4 maj 2000, dhe *Posokhov kundër Rusisë*, nr. 63486/00, § 39, ECHR 2003 IV). Një "gjykatë" sipas nenit 6 § 1 të Konventës duhet të plotësojë, gjithashtu, një sërë kushtesh të tjera, që përfshijnë pavarësinë e anëtarëve të saj dhe kohëzgjatjen e mandatit të tyre, paanshmërinë dhe ekzistencën e garancive procedurale (shih *Cowme dhe të tjerë kundër Belgjikës*, nr. 32492/96, 32547/96, 32548/96, 33209/96 dhe 33210/96, § 99, ECHR 2000-VII).

140. Gjykata vëren se sipas dispozitave të ligjit të sistemit gjyqësor ka qenë dhe mbetet i mundur transferimi i gjyqtarëve në trupin gjykues të gjykatave të tjera, përveç gjykatave të tyre. Dispozita të caktuara ligjore duhet të përbushen për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit dhe për të parandaluar në çdo mënyrë manipulimin e trupit gjykues, si dhe për të garantuar gjykim të drejtë. Për shembull, Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka autoritetin të vendosë mbi transferimet. Për më tepër, dispozitat e zbatueshme të ligjit të sistemit gjyqësor kufizojnë periudhën për të cilën një detyrë e tillë mund të bëhet për tre muaj në vit.

141. Në rastin konkret, Gjykata vëren se më 23 shtator 2004, kryetari i Gjykatës së Apelit i kërkoi Këshillit të Lartë të Drejtësisë të emëronte tre gjyqtarë për të dëgjuar çështjen e ankuesve, meqenëse të gjithë gjyqtarët e kësaj gjykate ishin përfshirë më parë në gjykimin e çështjes së ankuesve. Në përgjigje të kësaj, më 25 tetor 2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë vendosi t'i transferonte tre gjyqtarët nga Gjykata Ushtarake e Apelit për të gjykuar ankuesit. Vendimi i Këshillit të Lartë të Drejtësisë u bazua në nenin 28 të ligjit të sistemit gjyqësor.

142. Gjykata e çmon të ligjshme arsyen e transferimit të gjyqtarëve, pikërisht për të siguruar paanshmërinë dhe

pavarësinë e trupit gjykues. Nuk është detyrë e Gjykatës të shqyrtojë nëse autoritetet duhet t'i kishin transferuar gjyqtarët nga gjykata të tjera të zakonshme të apelit, çështje që mbetet në diskrecionin e Qeverisë së paditur, por të verifikojë nëse mënyra në të cilën është kryer transferimi dhe garancitë që e rrethojnë janë në përputhje me nenin 6 (shih, *mutatis mutandis*, *Incal kundër Turqisë*, 9 qershor 1998, § 70, *raportet* 1998-IV).

143. Ankuesit nuk kanë kundërshtuar faktin se gjyqtarët e gjykatës ushtarake gëzojnë të gjitha garancitë ligjore të pavarësisë të njëjta me ato të gjyqtarëve civilë. Për shembull, ata kryejnë të njëjtin trajnim arsimor dhe profesional që u jep atyre statusin e anëtarëve të karrierës së gjyqësorit. Ata emërohen nga KLD-ja dhe janë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre. Mandati i tyre nuk kufizohet në kohë dhe nuk mund të largohen nga detyra apo të dalin në pension para kohe, nëse nuk plotësohen kushtet e kërkuara me ligj. Ata mbeten subjekt i të njëjtit proces disiplinor dhe vlerësimi të zbatueshëm për gjyqtarët civilë (shih paragrafin 76 më lart). Në rastin konkret, Gjykata vëren se ankuesit nuk kanë arritur të paraqesin asnjë element që sjell mungesën e pavarësisë së gjyqtarëve të gjykatës ushtarake.

144. Për sa i përket kushtit të "paanshmërisë", ankuesit nuk treguan asnjë rrethanë që të dëshmonte mungesën e paanshmërisë objektive apo subjektive (shih *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, §§ 75-76, ECHR 2007-V (ekstrakte)) nga ana e gjyqtarëve të gjykatës ushtarake, të cilët dëgjuan çështjen dhe dënuan ankuesit. Gjithashtu, nuk është përdorur Kodi Penal Ushtarak. Së fundi, as para Gjykatës dhe as para gjykatave të brendshme, nuk është argumentuar e aq më pak parashtuar se gjyqtarët e gjykatës ushtarake, kanë punuar përtej afatit statutor tremujor.

145. Rrjedhimisht, Gjykata nuk dallon asnjë shkelje të legjislacionit të brendshëm. Gjykata e Apelit, e datës 2 dhjetor 2004 ishte, për rrjedhojë, "gjykatë e krijuar me ligj" në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës. Nga kjo rrjedh se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

#### **4. Kohëzgjatja e pretenduar e procedimeve** **a) Pranueshmëria**

146. Qeveria nuk ngriti asnjë argument të pranueshmërisë në lidhje me ankimin.

147. Gjykata çmon se ky ankim është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 të Konventës. Ajo më tej konstaton se ankimi nuk është i papranueshëm për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht, duhet të deklarohet i pranueshëm.

#### **b) Meritat**

148. Ankuesit argumentuan se procedimet penale kishin zgjatur për një periudhë të paarsyeshme kohore. Çështjet kundër tyre nuk ishin komplekse. Vonesat konsistonin në rikthime të çështjes nga gjykatat më të

larta në gjykatat më të ulëta. Autoritetet nuk arritën të marrin masa, të cilat do të kishin shmangur rikthime të tilla dhe do të kishin garantuar një përfundim të shpejtë të procedimeve.

149. Qeveria parashtroi se faktet e çështjes ishin komplekse duke pasur parasysh veprat penale që ishin kryer dhe numrin e veprimeve hetuese që duhej të kryeshin. Rrjedhimisht, kjo kërkonte zgjatjen e afateve për kryerjen e hetimit penal. Për sa u përket procedimeve të gjykimit, Qeveria deklaroi se ishin marrë në pyetje një numër i konsiderueshëm i dëshmitarëve. Ajo më tej ia atribuoi ankuesve kohëzgjatjen e procedimeve, të cilët kishin apeluar kundër çdo veprimi të një gjykatë më të ulët ndaj një gjykatë më të lartë. Sipas mendimit të saj, procedimet ishin kryer brenda një afati kohor të arsyeshëm.

150. Gjykata vëren se procedimet filluan më 18 prill 2000 kur u arrestuan ankuesit dhe përfunduan më 6 shkurt 2007 me vendim të Gjykatës Kushtetuese. Kështu periudha që duhet të konsiderohet është afërsisht 6 vjet dhe 11 muaj.

151. Gjykata përsërit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kriterëve në vijim: kompleksiteti i çështjes, sjellja e ankuesit dhe autoriteteve përkatëse, si dhe çfarë ishte në rrezik për ankuesin në fjalë (shih *Sürmeli kundër Gjermanisë* [GC], nr. 75529/01, § 140, ECHR 2006-VII).

152. Gjykata pranon se çështja kundër ankuesve lidhet me vrasjen që përfshinte një shkallë të caktuar kompleksiteti, duke përfshirë sigurimin e provave nga jashtë.

153. Gjykata nuk konstaton se ankuesit ishin përgjegjës për kohëzgjatjen e procedimeve, veçanërisht duke pasur parasysh rezultatit e suksesshëm të apeliave të tyre.

154. Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilën Gjykata e ka shqyrtuar në një rast të mëparshëm kundër shtetit të paditur përbëhet nga rikthime të shumta të çështjes nga gjykatat më të lartë në gjykatat më të ulëta (shih *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, §§ 141-146, ECHR 2007-XIV (ekstrakte)). Gjykata vëren, në veçanti, se pasi çështja ishte dëgjuar nga Gjykata e Lartë, më 15 janar 2003, ajo u dërgua në Gjykatën e Rrethit për rishqyrtim. Në procedimet e reja, Gjykata nuk veproi në përputhje me udhëzimet e Gjykatës së Lartë dhe se ky mosveprim rezultoi në një seri tjetër procedimesh, të cilat zgjatën dy vjet deri në miratimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 15 tetor 2004, i cili la në fuqi dënimet e ankuesve. Gjykata vlerëson se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të brendshme.

155. Rrjedhimisht, ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës.

### C. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të prezumimit të pafajësisë

156. Të dy ankuesit u ankuan se fushata mediatike kundër tyre shkeli të drejtën e tyre që të konsiderohen të pafajshëm.

157. Gjykata vëren se ekziston njohje e përgjithshme e faktit se gjykatat nuk mund të funksionojnë në boshllëk. Ndërkohë që gjykatat janë forumi për përcaktimin e fajësisë ose të pafajësisë së personit për një veprë penale, kjo nuk do të thotë se nuk mund të ketë asnjë diskutim paraprak ose të njëkohshëm të objektit të gjykimeve penale diku tjetër, qoftë ky në gazeta të specializuara, në shtypin e përgjithshëm në mesin e publikut të gjerë (shih *Craxi kundër Italisë*, nr. 34896/97, § 99, 5 dhjetor 2012; dhe *Pulicino kundër Maltës* (dhjetor), nr. 45441/99, 15 qershor 2000). Jo vetëm që mediet e kanë për detyrë dhënien e informacioneve dhe ideve në lidhje me çështjet që dalin para gjykatave, ashtu si në fusha të tjera të interesit publik; publiku, gjithashtu, ka të drejtë t'i marrë ato (shih, ndërmjet të tjerash, *The Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 1), 26 prill 1979, § 65, seria A, nr. 30; dhe *Worm kundër Austrisë*, 29 gusht 1997, § 50, *raportet e gjykimeve dhe vendimeve* 1997-V). Me kusht që media të mos kapërcejë kufijtë e caktuar në interes të administrimit të duhur të drejtësisë, raportimi, duke përfshirë komentet, mbi procedimet e Gjykatës kontribuon në publicitetin e tyre dhe kështu është tërësisht në pajtim me kërkesat sipas nenit 6 § 1 të Konventës që seancat të jenë publike (shih *Pulicino*, cituar më lart). Rrjedhimisht, neni 6 § 2 nuk mund të pengojë autoritetet që të informojnë publikun për hetimet penale në vazhdimësi, por kërkon që ato të veprojnë kështu me të gjithë diskrecionin dhe maturinë e nevojshme nëse duhet të respektohet prezumimi i pafajësisë (shih, ndër të tjera, *Peša kundër Kroacisë*, nr. 40523/08, § 139, 8 prill 2010).

158. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se artikujt e shtypit nuk përmbanin asnjë deklaratë nga zyrtarët publikë, që cenonte prezumimin e pafajësisë së ankuesve. Ata thjesht paraqitën një transmetim kronologjik të gjykimit dhe apeliave të ankuesve, më së shumti të ndjekur nga citime dhe intervista, kryesisht me avokatin mbrojtës të ankuesit të dytë. Ankuesit nuk janë shprehur se një fushatë mediatike ishte zhvilluar kundër tyre me rrezikshmëri të tillë sa të ndikonte ose kishte të ngjarë të ndikonte në rezultatit e procedimeve. Ata nuk kanë paraqitur asnjë provë konkrete të tillë, duke përfshirë dëshmi se autoritetet në ndonjë mënyrë i kishin zbuluar informacionet shtypit, ose kishin nxitur raportime paragjyquese në media (shih *Beggs kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dhjetor), nr. 15499/10, 16 tetor 2012).

159. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ky ankim është haptazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

## V. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 7 TË KONVENTËS

160. Ankuesi i dytë u ankua se ka pasur shkelje të nenit 7 § 1 të Konventës në faktin se gjykatat e brendshme e kishin dënuar atë në mënyrë prapavepruese mbi bazën e nenit 78 § 2 të KP-së, që ishte paraqitur pas kryerjes së veprave të pretenduara.

Neni 7 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte vepër penale, sipas të drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.

2. Ky nen nuk cenon gjykimin dhe dënimin e çdo personi për një veprim ose një mosveprim që, në momentin kur është kryer ishte penal sipas parimeve të përgjithshme të së drejtës të njohur nga vendet e civilizuara.”

161. Qeveria parashtrroi se ankuesi i dytë nuk e ngriti këtë ankim as para Gjykatës së Lartë dhe as para Gjykatës Kushtetuese.

162. Gjykata konstaton se ankuesi i dytë në të vërtetë nuk arriti të ngriejë këtë ankim para Gjykatës Kushtetuese. Edhe nëse Gjykata Kushtetuese nuk duhej të konsiderohej si mjet ligjor i brendshëm për qëllimin e nenit 7 të Konventës, vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 shtator 2005 është dhënë më shumë se gjashtë muaj nga data e paraqitjes së këtij ankimi para Gjykatës më 13 korrik 2007.

163. Nga kjo rrjedh se ky ankim duhet të deklarohet i papranueshëm dhe të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

## VI. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

164. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës apo të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

### A. Dëmi

165. Ankuesit e lanë në diskrecionin e Gjykatës përcaktimin e shumës së dëmit jomaterial të cilën ata kishin të drejtë duke pasur parasysh praktikën e saj ligjore në raste të ngjashme.

166. Qeveria deklaroi se konstatimi i shkeljes përbënte shpërblim të drejtë të mjaftueshëm për ankuesit në çdo rast, ata nuk kishin vërtetuar pretendimet e tyre për dëmet. Nëse Gjykata vendosi një shpërblim, Qeveria kërkoi që shpërblimi i drejtë duhet të marrë parasysh faktet e çështjes, kompleksitetin e saj dhe sjelljen e ankuesve.

167. Gjykata thekson se, në lidhje me ankuesin e parë, ajo konstatoi shkelje reale dhe procedurale të nenit 3 të Konventës dhe shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c) të Konventës. Gjykata, gjithashtu, konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë për shkak të pranimit në prova të

deklaratave inkriminuese të ankuesit të parë, të marra nga tortura. Ajo më tej konstatoi shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës lidhur me të drejtën e të dy ankuesve për një gjykim brenda një kohe të arsyeshme. Në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata shpërblen ankuesin e parë me 15,600 euro në lidhje me dëmin jomaterial dhe vlerëson se konstatimi i shkeljeve përbën shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me ankuesin e dytë.

168. Megjithatë, për sa i përket kompensimit për shkelje të nenit 6 të Konventës në lidhje me të dy ankuesit, Gjykata përsërit se forma më e përshtatshme e kompensimit do të ishte vendosja e të dy ankuesve sa më shumë që të jetë e mundur në pozitën në të cilën ata do të kishin qenë nëse do të respektohej kjo dispozitë. Forma më e përshtatshme e kompensimit, në parim, do të ishte gjykimi *de novo* ose rihapja e procedimeve nëse kërkohet (shih *Caka kundër Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009; *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, nr. 12315/04 dhe 17605/04, §§ 74-76, 20 prill 2010; *Berhani kundër Shqipërisë*, nr. 847/05, § 91, 27 maj 2010; dhe, *Shkalla kundër Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 maj 2011).

### B. Kostot dhe shpenzimet

169. Ankuesit parashtruan se nuk kishin asnjë faturë për të paraqitur në Gjykatë. Sipas një marrëveshjeje verbale që ata kishin me avokatin e tyre dhënia e kostove dhe shpenzimeve kushtëzohej nga rezultati i çështjes para Gjykatës.

170. Qeveria kundërshtoi pretendimet e ankuesve për kostot dhe shpenzimet meqenëse ato nuk ishin të provuara. Ajo i kërkoi Gjykatës pushimin e tyre.

171. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, ankuesi ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm në masën që është provuar se ato janë shkaktuar në të vërtetë dhe domosdoshmërisht dhe ishin të arsyeshme në masë. Në çështjen në fjalë, duke marrë parasysh mungesën e faturave dhe dokumenteve mbështetëse, nuk është bërë asnjë akordim sipas këtij kreu.

### C. Interesi i mospagimit

172. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, të cilit duhet t'i shtohen 3 për qind.

## PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *Vendos* të bashkojë ankimet.

2. *Bashkon* meritat e kundërshtimeve paraprake të Qeverisë në lidhje me ankimin e ankuesit të parë, sipas nenit 3 të Konventës.

3. *Deklaron* ankimet e ankuesit të parë sipas nenit 3 dhe nenit 6 § 1 në lidhje me nenin 6 § 3 (c) të Konventës të pranueshme; ankimin e ankuesit të dytë sipas nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me padrejtësinë e procedimeve, si dhe ankimin e të dy ankuesve në



lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve dhe pjesën e mbetur të ankimeve të dy ankuesve të papranueshme.

4. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 3 të Konventës sipas pjesëve të saj reale dhe procedurale në lidhje me ankuesin e parë dhe rrjedhimisht *rrëzon* kundërshtimet paraprake të Qeverisë.

5. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë për sa i përket pranimit dhe përdorimit të deklaratave të marra në shkelje të nenit 3.

6. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (c) në lidhje me ankuesin e parë lidhur me mohimin e aksesit për avokat mbrojtës gjatë mbikëqyrjes policore.

7. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e dytë për sa i përket pranimit dhe përdorimit të deklaratave të marra nga ankuesi i parë në shkelje të nenit 3.

8. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën e të dy ankuesve për gjykim brenda një periudhe të arsyeshme.

9. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t'i paguajë ankuesit të parë, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 15,600 euro (pesëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind euro) për dëme jomateriale, plus çdo taksë që mund të vihet, të konvertuara në monedhën e brendshme në kursin e këmbimit në datën e pagesës;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh, të përmendur më lart, deri në pagim, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huas të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 për qind.

10. *Vendos* se konstataimi i shkeljeve përbën një shpërblim të drejtë të mjaftueshëm në lidhje me ankuesin e dytë.

11. *Rrëzon* pjesën tjetër të mbetur të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 25 qershor 2013, në përputhje me nenin 77 § 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Françoise Elens-Passos David Thór Björgvinsson**  
SEKRETAR KRYETAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe nenin 74 § 2 të rregullores së Gjykatës, bashkëngjitur këtij vendimi, opinionioni më vete i gjyqtarit Bianku.

D.T.B.

F.E.P.

#### OPINION UNANIM I GJYQTARIT BIANKU

Pajtohëm me konkluzionet e Dhomës se ka pasur shkelje të nenit 3, si në aspektin real ashtu edhe procedural, për sa i përket ankuesit të parë dhe shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës për sa i përket ankuesit të 18

parë dhe të dytë (pikat 4, 5 dhe 7 të dispozitave vepruese të vendimit). Megjithatë, më vjen keq, unë nuk jam në gjendje të bie dakord me arsyetimin e kolegëve të mi të ditur mbi dy çështjet e lidhura në këtë rast.

#### **A. A është përdorur torturë ndaj ankuesit të parë?**

Ankuesi i parë, z. Kaçi, u arrestua më 18 prill 2000. Ai pretendoi se një ditë më vonë, më 19 prill 2000, ai është marrë në pyetje nga një prokuror dhe ka dhënë shpjegime që inkriminojnë ankuesin e dytë për shkak të dhunës së përdorur ndaj tij nga oficerët e policisë në të njëjtën ditë. Më 20 prill 2000, ai pretendohet se është shoqëruar nga oficerët e policisë në sallën e gjyqit. Pretendimi se ndaj tij është përdorur forcë është konfirmuar nga procesverbali i seancës së njëjtës datë (paragrafët 11-14 të vendimit). Është për të ardhur keq, për të thënë më të paktën, nuk duket se këto pretendime janë shqyrtuar nga autoritetet shqiptare, pavarësisht nga kërkesa e avokatit mbrojtës të ankuesit të parë të caktuar nga Gjykata. Duke pasur parasysh këto elemente, nuk ka dyshim se ka pasur shkelje procedurale të nenit 3 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë dhe pajtohëm me konkluzionet e Dhomës në këtë drejtim.

A ka pasur, gjithashtu, shkelje reale të nenit 3? Qeveria nuk reagoi ndaj pretendimeve të ankuesit dhe avokatit të tij mbrojtës për përdorimin e forcës nga oficerët e policisë më 19 prill 2000, dhe as nuk dha asnjë shpjegim të çfarëdo lloji për shenjat në trupin e ankuesit të parë dhe gjendjen e tij shëndetësore në sallën e gjyqit më 20 prill 2000.

Në përcaktimin nëse një formë e veçantë trajtimi arrin kufirin e përgjithshëm të nenit 3, Gjykata ka miratuar standardin e provës “përtej dyshimit të arsyeshëm”, duke shtuar se “një provë e tillë mund të vijojë nga bashkëzistenca e konkluzioneve mjaft të forta, të qarta dhe pajtuese ose të prezumimeve të pakundërshtueshme të ngjashme të faktit” (shih *Ireland kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 167, seria A, nr. 25). Që prej këtij vendimi, Gjykata ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur se “me qëllim që keqtrajtimi të bjerë në objektin e nenit 3, ai duhet të arrijë një nivel minimal ashpërsie. Vlerësimi i këtij minimumi varet nga të gjitha rrethanat e çështjes, të tilla si: kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike ose mendore dhe, në disa raste, gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës”. Gjykata ka shtuar se “faktorë të mëtëjshëm” përfshijnë qëllimin për të cilin është shkaktuar trajtimi së bashku me qëllimin apo motivimin pas tij..., si dhe kontekstin e tij, të tillë si atmosfera e emocioneve dhe tensioneve të shtuara” (shih *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GC], nr. 22978/05, § 88, ECHR 2010). Të gjitha këto parime së bashku me elementin e qëllimshëm që karakterizon torturën, janë theksuar qartë në paragrafët 87-93 të vendimit të Dhomës në çështjen në fjalë.

Sipas mendimit tim, problemi qëndron në mënyrën se si Dhoma aplikoi këto parime të përgjithshme në çështjen në fjalë. Para së gjithash, vendimi pranon “mungesën e çdo lloj përshkrimi të dëmtimeve të pësuar” nga ankuesi i parë (paragrafi 95 i vendimit). Më tej në të njëjtin paragraf, sugjerohet që pretendimet e ankuesit të parë “krijuan prezumimin e faktit se ankuesi i ishte nënshtruar keqtrajtimit ndaluar sipas nenit 3, në duart e agjentëve të shtetit”. Duke pasur parasysh se këto pretendime nuk janë hetuar nga autoritetet, me të drejtë Dhoma konstaton shkelje të pjesës procedurale të nenit 3. Fakti se nuk është paraqitur asnjë provë mjekësore apo prova të tjera çoi në konkluzionin se këto pretendime mbetën vetëm një prezumim i faktit. Rrjedhimisht, konstatohen në vendim shprehjet “mund të nxirren konkluzione” se trajtimi ishte i qëllimshëm (paragrafi 98 i vendimit), ose “me shumë gjasa” për vlerësimin e kohëzgjatjes së keqtrajtimit, natyrës së tij dhe, madje edhe elementin e qëllimshëm. Nuk jam i bindur se kjo analizë është në përputhje me kërkesën e “provës përtej dyshimit të arsyeshëm”. Në një situatë në të cilën ankuesi i parë nuk është ankuar në mënyrë specifike për torturë dhe një gjë e tillë nuk përcaktohet në nivel të brendshëm ose nga ndonjë burim tjetër (paragrafi 91 i vendimit); për gjykatën tonë të hidhet dhe të konkludojë se ankuesi ishte torturuar krijon, sipas mendimit tim, një konkluzion jashtëzakonisht të gjerë dhe të pasigurt. Standardi i provës, domethënë “përtej dyshimit të arsyeshëm” dhe konsideratat në lidhje me to të provave përcaktuar më lart, sipas mendimit tim, duhet të zbatohen me shumë kujdes kur është fjala për akuzat e torturës – forma më e rëndë e trajtimit ndaluar sipas nenit 3 – dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përcaktohet nga prezumimi, konkluzioni dhe as nga probaliteti (krahaso me *Selmouni kundër Francës* [GC], nr. 25803/94, §§ 91-106, ECHR 1999-V; *Gäfgen*, cituar më lart, § 94; *Dedovskiy dhe të tjerë v. Rusisë*, nr. 7178/03, §§ 39-50, 59-61 dhe 80-86, ECHR 2008 (ekstrakte); *Savitsky kundër Ukrainës*, nr. 38773/05, §§ 15-18 dhe 129-139, 26 korrik 2012; *Virabyan kundër Armenisë*, nr. 40094/05, §§ 17-29 dhe 31, 2 tetor 2012; dhe *Lenev kundër Bullgarisë*, nr. 41452/07, §§ 111-18, 4 dhjetor 2012).

Unë, gjithashtu, pyes veten nëse gjykimi në këtë rast përçon mesazh të gabuar, domethënë se pretendimet e thjeshta nga ankuesit për keqtrajtim në masën që nuk janë hetuar në nivel të brendshëm – automatikisht çojnë në shkeljen reale të nenit 3 për shkak të torturës?! Leximi im i praktikës ligjore të kësaj Gjykatë është se, në raste të tilla mos sigurimi nga ana e autoriteteve të shpjegimeve bindëse për dëmtime të shkaktuara nga një person nën kontrollin e tyre çon në konkluzionin se ka pasur, gjithashtu, shkelje reale të nenit 3 (shih, ndër të

tjera, *Tomasi kundër Francës*, 27 gusht 1992, §§ 108-11, seria A, nr. 241-A; *Ribitsch kundër Austrisë*, 4 dhjetor 1995, § 34, seria A, nr. 336; dhe *Selmouni*, cituar më lart, § 87). Megjithatë, me qëllim që të provohet nëse është përdorur torturë, duhet të plotësohen, gjithashtu, kërkesat dhe standardet e tjera të provave, të shpjeguara më lart. Nga pikëpamja e praktikës sonë ligjore të gjykatës dhe rrethanave faktike të kësaj çështjeje, unë nuk jam në gjendje të arrij në përfundimin se ankuesi është torturuar, megjithëse jam plotësisht dakord se pa pasur shkelje reale të nenit 3 të Konventës<sup>1</sup>.

### **B. A ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me ankuesin e parë dhe të dytë për shkak të përdorimit të veprimeve në kundërshtim me nenin 3 ndaj ankuesit të parë?**

Sipas pikës sime të parë, se tortura nuk është përcaktuar në rastin e ankuesit të parë, por një shkelje e pacaktuar e pjesës reale të nenit 3, kthehem tani në pikën e dytë: Nëse ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 në lidhje me ankuesin e parë dhe të dytë për shkak të përdorimit të forcës, që nuk cilësohet si torturë ndaj ankuesit të parë.

Çështja e përdorimit të provave të marra në rrethana në kundërshtim me nenin 3 ka qenë objekt i disa vendimeve të kësaj Gjykate. Duke cituar *Gäfgen* (cituar më lart, §§ 165-66), vendimi i Dhomës përsërit se “konsiderata të veçanta zbatohen në lidhje me përdorimin në procedimet penale të provave të marra në shkelje të nenit 3. Prandaj, pranimi i deklaratave të marra si pasojë e torturës ose keqtrajtimit në shkelje të nenit 3 si provë për të përcaktuar faktet përkatëse në procedimet penale i bën procedimet si një e padrejtë e tërë, pavarësisht nga vlera vërtetuese e deklaratave dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre është vendimtar në sigurimin e dënimit të të pandehurit” (paragrafi 117 i vendimit).

Por a duhet të cilësohet trajtimi si torturë para se një shkeljeje e nenit 3, gjithashtu, të mund të çojë në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës? Dy vendimet e Dhomës së Madhe ose kanë lënë të hapur çështjen nëse përdorimi i provave reale të marra nga një veprim, të klasifikuar si trajtim çnjerëzor dhe degradues, por që nuk përbën torturë, e bën gjithmonë gjykimin të padrejtë (*Jalloh kundër Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, §§ 106-07, ECHR 2006-IX), ose kanë shmangur përgjigjen direkte të pyetjes në terma të përgjithshëm për shkak të rrethanave të veçanta të çështjes dhe mungesës së një lidhjeje shkakësore ndërmjet metodave të ndaluara të hetimit dhe dënimit të ankuesit (*Gäfgen*, cituar më lart,

<sup>1</sup> Gjykata ka konstatuar vazhdimisht shkelje të përgjithshme të pjesëve thelbësore të nenit 3 në disa raste pa specifikuar formën e keqtrajtimit të pësuar (shih, ndër të tjera, *Taraburca kundër Moldovisë*, nr. 18919/10, §§ 48-53, 6 dhjetor 2011; dhe *Yusuf Gezer kundër Turqisë*, nr. 21790/04, §§ 31-33, 1 dhjetor 2009).

§ 180). Ashtu si në opinionin e përbashkët kundërshtues në gjykimin e *Gäfgen* nga disa gjyqtarë në përbërje të kësaj Dhome të Madhe, unë do të përsëris se “Gjykata mund t’i ishte përgjigjur kësaj pyetje duke pohuar kategorikisht, në mënyrë të qartë, se pavarësisht nga sjellja e të akuzuarit, drejtësia, për qëllimin e nenit 6, presupozon respektin e shtetit ligjor dhe kërkon, si një propozim vetevident, përjashtimin e çdo prove që është marrë në shkelje të nenit 3. Një gjykim penal që pranon dhe bazohet, në çdo masë, në prova të marra si pasojë e shkeljes së një dispozite të tillë absolute të Konventës nuk mund të jetë *a fortiori* i drejtë. Shpreh keqardhjen për ngurrimin e Gjykatës për të kaluar këtë kufi përfundimtar dhe për të krijuar një rregull të qartë ose “të përcaktuar qartë” në këtë zonë kryesore të të drejtave themelore të njeriut<sup>2</sup>.”

Sipas mendimit tim, pavarësisht nga cilësimi i trajtimit të ndaluar, duke konstatuar shkelje reale të nenit 3 të Konventës, një shkelje e nenit 6 § 1 të Konventës duhet të ishte konstatuar në këtë rast për sa i përket ankuesit të parë dhe të dytë. Kjo edhe më shumë sepse, ndryshe nga rasti *Gäfgen* (cituat më lart, §§ 32 dhe 147), nuk janë bërë deklarata të mëvonshme nga ankuesi i parë që të konfirmonte në Gjykatë deklarata inkriminuese të bëra më parë nga ai gjatë kujdestarisë. Në të kundërt, ankuesi i parë këmbënguli se këto deklarata janë marrë prej tij si pasojë e përdorimit të forcës (paragrafët 28, 31, 33 dhe 49 i vendimit aktual). Kjo është e gjitha aq më tepër në një situatë ku pretendimet e ankuesit të parë se i është nënshtruar trajtimit në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, ndeshën në heshtjen totale dhe pasivitetin e autoriteteve shqiptare, pavarësisht nga detyrimet e tyre procedurale sipas nenit 3 dhe dijenisë së tyre mbi pretendimet e përfshira në periudhën e procedimeve penale ndaj dy ankuesve. Sipas mendimit tim, veçanërisht në një rast të tillë kur ankuesi i parë bëri deklarata që inkriminonin ankuesin e dytë, ne duhet të kishim pyetur veten nëse, duke lënë mënjanë çështjen e torturës, mund të jetë e mjaftueshme një formë më e lehtë keqtrajtimi ndaluar nga neni 3 kundër ankuesit të parë për të marrë këto deklarata për të konkluduar se drejtësia e gjykimin të ankuesit të dytë ishte rrezikuar për shkak të këtij përdorimi. Sipas mendimit tim, Dhoma duhet të kishte zgjedhur për një zbatim më të gjerë të objektit të rregullit përjashtues, në lidhje me provat e marra si pasojë e shkeljes së nenit 3. Kjo, gjithashtu, do të kishte çuar në sqarimin e praktikës sonë ligjore mbi këtë

çështje<sup>3</sup> dhe do të kishte forcuar qëndrueshmërinë e zbatimit të saj. Zgjedhja e shumicës e parë nga perspektiva e fakteve të çështjes në fjalë, nxjerr në pah një problem tjetër. Siç është theksuar tashmë në opinionin pjesërisht kundërshtues përmendur më lart në vendimin e *Gäfgen* do të ishte e vështirë për një Gjykatë që ka pranuar se mungesa e një avokati mbrojtës në fazat fillestare të një hetimi e bën tërë gjykimin të padrejtë (*Salduz kundër Turqisë* [GC], nr. 36391/02, 27 nëntor 2008), të kufizojë objektin e rregullit përjashtues vetëm për provat e marra nga tortura. Ose, e thënë ndryshe, të mos kishte kurajën për të zgjeruar objektin e rregullit përjashtues, në mënyrë që të pasqyronte të gjitha provat e marra në shkelje të nenit 3. Faktet e çështjes në fjalë i ofruan Gjykatës avantazhin, ose në të vërtetë disavantazhin që të kishte si elementin *Salduz* ashtu edhe *Gäfgen*. Ndërsa Dhoma në paragrafin 120 të vendimit pranon se mungesa e avokatit mbrojtës në fazat fillestare të procedimeve kundër ankuesit të parë e nxori tërë gjykimin të padrejtë, sipas parimit të *Salduz*, duket se kërkon veprime të paditura që të cilësohen si torturë, me qëllim që të konkludojë se ka pasur shkelje të garancisë për gjykim të drejtë. A do të thotë kjo se parimi *Salduz* është më bindës se parimi *Jalloh* ose *Gäfgen*? Një gjë e tillë do të jetë e vështirë, nëse jo e pamundur, për t’u mbrojtur duke pasur parasysh natyrën e neneve në lojë, nenin 6 që nga njëra anë garanton të drejta joabsolute dhe, nga ana tjetër nenin 3 dhe karakterin absolut të tij.

Për arsytet e mësipërme, unë besoj se Dhoma duhet të ketë konstatuar shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës pa pasur nevojë për të arritur, si një çështje paraprake, në përfundimin se ankuesi i parë i ishte nënshtruar torturës, të cilin unë e vlerësoj si konkluzion të pasigurt mbi faktet e çështjes. Fakti që ankuesi i parë është keqtrajtuar në kundërshtim me nenin 3, do të kishte qenë i mjaftueshëm në vetvete për të bazuar një shkelje të nenit 6 në lidhje me të dy ankuesit. Kjo zgjidhje nuk do të ndryshonte asgjë për ankuesit, por do të kishte çuar në një rezultat, i cili do të kishte qenë më i qartë dhe më në përputhje me praktikën tonë ligjore sipas neneve 3 dhe 6.

<sup>2</sup> Shih paragrafin 2 të Opinionit të Përbashkët Pjesërisht Kundërshtues të gjyqtarëve Rozakis, Tulkens, Jebens, Ziemele, Bianku dhe Power në vendimin e *Gäfgen*. Shih, gjithashtu, paragrafin 3.2 të Opinionit Kundërshtues të gjyqtarit Cabral Barreto në vendimin e Dhomës së Madhe në çështjen *Bykov kundër Rusisë* [GC], nr. 4378/02, 10 mars 2009).

<sup>3</sup> Për vendimin që pranon rregullin përjashtues në rastet kur shkelja e nenit 3 nuk është cilësuar si torturë, shih *Hulki Güneş kundër Turqisë*, nr. 28490/95, ECHR 2003-VII (ekstrakte); *Söyler kundër Turqisë*, nr. 46661/99, 21 shtator 2006; dhe *Göçmen kundër Turqisë*, nr. 72000/01, 17 tetor 2006.

SEKSIONI I KATËRT  
**ÇËSHTJA HYSEN SPATA KUNDËR SHQIPËRISË**  
*Ankimi nr. 19985/13*

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur më 1 tetor si një Komitet i përbërë nga:

Päivi Hirvelä, *president*

Ledi Bianku,

Paul Mahoney, *gjyqtarë,*

dhe Fatoş Aracı, *zëvendëssekretar i Seksionit,*

në lidhje me ankimin e sipërpërmendur, të dorëzuar më 9 mars 2013, pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, vendos si më poshtë:

**FAKTET**

1. Ankuesi, z. Hysen Spata, është një shtetas shqiptar, i lindur në vitin 1942, me banim në Dibër. Ai përfaqësohet përpara Gjykatës nga z. Kamer Ylli, një avokat, i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

2. Faktet e çështjes, siç janë paraqitur nga ankuesi, mund të përmbledhen si më poshtë:

**A. Hetimi penal për vdekjen e motrës së ankuesit**

3. Më 22 tetor 2001, motra e ankuesit u godit për vdekje me armë në shtëpinë e saj.

4. Në dhjetor 2001, ankuesi dorëzon një ankesë penale në prokurori.

5. Më 22 dhjetor 2001, prokuroria e rrethit nisi një hetim penal për vdekjen e motrës së ankuesit.

6. Më 12 dhjetor 2002, prokurori i rrethit vendosi të pezullonte hetimet, me justifikimin se nuk mund të gjurmohet asnjë autor në lidhje me krimin. Ankuesi pretendon se deri në atë pikë, ai nuk ishte informuar për organizimin e hetimeve apo për pezullimin e tyre.

7. Më vonë ankuesi mëson për pezullimin e hetimeve. Kërkesa e tij në prokurorinë e rrethit për të marrë kopje të dokumenteve të gjetura gjatë hetimeve, dosja me nr. 161, mbeti pa përgjigje.

8. Më 26 shkurt 2004, 25 janar 2008 dhe 4 shtator 2009, Prokuroria e Përgjithshme informoi ankuesin se hetimet ishin ende të pezulluara, dhe se nuk ishte ndërmarrë asnjë veprim tjetër.

**B. Procedurat gjyqësore kundër pezullimit të hetimeve penale**

9. Në një datë të papërcaktuar, me shumë mundësi pas shtatorit 2009, ankuesi hapi procedura penale kundër pezullimit të hetimeve. Ai u ankua se nuk ishte informuar për përmbajtjen e dosjes së hetimeve dhe as për pezullimin e hetimeve, se prokurori nuk i kishte pyetur të gjithë dëshmitarët dhe se ai nuk kishte asnjë përfitim efikas për t'u ankuar kundër vendimit për pezullim të hetimeve penale.

10. Më 16 nëntor 2009 dhe 23 qershor 2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, dhe Gjykata e Apelit Tiranë vendosën se, përderisa hetimet ishin ende pezull

dhe përderisa ishte e drejta e prokurorisë të vendoste që hetimet të vazhdonin, ankuesi nuk kishte *locus standi*. U rikonfirmua se nuk ekzistonte asnjë e drejtë për të apeluar kundër vendimit për pezullim të hetimeve sipas ligjit të procedurës penale.

11. Më 22 dhjetor 2011 dhe 18 janar 2013, Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese i refuzuan apelimet e ankuesit. Ky i fundit pohoi, *inter alia*, se edhe pse ligji i procedurës penale nuk e parashikonte të drejtën për të apeluar, fakti se ankuesi kishte pasur akses në gjykatat vendase, tregonte se ai kishte një të drejtë efektive të apelonte në gjykatë.

**C. Ligji përkatës vendas**

*Kodi i Procedurës Penale ("KPP")*

12. Neni 24 § 4 pohon se vendimet dhe udhëzimet e një prokurori të nivelit të lartë lidhen me një prokuror të një niveli më të ulët.

13. Neni 58 i KPP-së parashikon se viktima apo trashëgimtarët e tij/saj kanë të drejtën për të kërkuar hapjen e një hetimi penal për autorin e krimit dhe të kërkojë dëmet.

14. Neni 105 i KPP-së parashikon se çdo palë e interesuar ka të drejtën të kërkojë kopje dhe ekstrakte, ose akte të veçanta të dosjes së hetimeve penale, në kurriz të asaj pale.

15. Neni 326 i KPP-së, i cili parashikon të drejtën e prokurorit të pezullojë hetimin penal, shpjegon si më poshtë:

"1. Kur autori i krimit është i panjohur (...), prokurori mund të vendosë të pezullojë hetimet.

2. Pezullimi i hetimeve miratohet pasi janë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme.

3. Hetimet e pezulluara mund të rihapen me një vendim të prokurorit."

Nuk ka një parashikim specifik në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me të drejtën për të apeluar kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar një hetim.

**ANKESAT**

16. Ankuesi u referohet neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës, për t'u ankuar se nuk ishte informuar për përmbajtjen e dosjes së hetimeve, se nuk ishte informuar për vendimin për të pezulluar hetimet dhe se nuk ka asnjë rezultat të efektshëm kundër vendimit të prokurorit për të pezulluar hetimet.

**LIGJI**

17. Pakënaqësitë e ankuesit nuk u shqyrtuan nga pikëpamja e detyrimit procedural të shtetit përgjegjës për të organizuar një hetim të efektshëm sipas nenit 2 të Konventës, i cili përfshin një kërkesë për të bërë të mundur pjesëmarrjen e një të afërmi. Megjithatë, kjo kërkesë nuk mund të shtrihet deri në atë pikë sa të nënkuptojë se ankuesi duhet të ketë akses në dosjet e policisë, apo në kopjet e të gjitha dokumenteve gjatë një hetimi në proces e sipër, apo që ankuesi të kontaktohet dhe të informohet për çdo hap (*Green kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr

28079/04, 19 maj 2005; *Hackett kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 34698/04, 10 maj 2005).

18. Më tej, Gjykata vëren se nuk kërkohet të merret një vendim nëse autoritetet pajtohen me atë kërkesë nëse ankesa është e papranueshme për arsyet e mëposhtme.

19. Neni 35 § 1 i Konventës parashikon se Gjykata mund të merret me një çështje kur ajo është prezantuar brenda gjashtë muajve nga data e vendimit final, në procesin e përvetësimit të kompensimeve vendase. Me rregull, periudha gjashtëmuajore fillon që nga data e vendimit final në procesin e përvetësimit të kompensimeve vendase. Megjithatë, kur është e qartë që në fillim se nuk ka asnjë kompensim efikas për ankuesin, periudha fillon që nga data e akteve ose masave për të cilat është bërë ankesa, ose që nga data kur akti apo efektet e tij i prezantohen ankuesit (*Dennis dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 76573/01, 2 korrik 2002). As neni 35 § 1 nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që t'i japë mundësinë ankuesit të paraqesë ankesën e tij përpara Gjykatës, përpara se ajo të zgjidhet në vendin e tij. Nëse ankuesi ia akordon vetë vetes një zhdëmtim, në dukje ekzistues, dhe më pas ndërjegjësohet për rrethanat, të cilat e bëjnë këtë zhdëmtim joefikas, për qëllimet e nenit 35 § 1, mund të jetë më e përshtatshme që periudha gjashtëmuajore të fillojë nga data kur ankuesi ndërjegjësohet ose duhet të ndërjegjësohet për ato rrethana (shiko *Paul and Aubrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.), nr. 46477/99, 4 qershor 2001).

20. Për pasojë, në rast se është shkaktuar një vdekje, pritet që të afërmit e ankuesit të ndërmarrin hapa për të ndjekur procesin e hetimeve dhe të dorëzojnë ankesat e tyre në mënyrën e duhur, sapo ata të jenë ndërjegjësuar apo të duhet të ndërjegjësohen për mungesën e një hetimi penal efektiv (shiko *Bulut dhe Yavuz kundër Turqisë* (vend.), nr. 73065/01, 28 maj 2002; gjithashtu, *Bayram dhe Yildirim kundër Turqisë* (vend.), nr. 38587/97, GJEDNJ 2002 III).

21. Duke iu rikthyer fakteve të çështjes aktuale, më 22 dhjetor 2001, u hap një hetim penal mbi vrasjen me armë të motrës së ankuesit. Më 12 dhjetor 2002, prokurori i rrethit vendosi ta pezullojë hetimin. Ankuesi e pranoi se u njoftua për atë vendim, por nuk specifikoi një datë konkrete. Megjithatë, letrat e autoriteteve tregojnë se midis 26 shkurtit 2004 dhe 4 shtatorit 2009, ankuesi u informua vazhdimisht rreth pezullimit të hetimeve. Ankuesi nuk i referohet asnjë mase investigative të ndërmarrë që prej 12 dhjetorit 2002.

22. Për këtë arsye, Gjykata mendon se ankuesi ishte i ndërjegjëgjshëm, më e shumta që prej 4 shtatorit 2009, se hetimet ishin pezulluar dhe asnjë akt tjetër investigativ nuk ishte ndërmarrë që prej pezullimit dhe se nuk kishte asnjë mundësi reale për ndërmarrjen e hapave të tjerë investigativë. Limiti kohor prej gjashtëmuajsh filloi që prej asaj dite.

23. Më tej, Gjykata nuk mendon se ngrihej një detyrim i ri investigativ si rezultat i procedurave ligjore të ndërmarrura nga ankuesi në vitin 2009, sepse këto procedura nuk mendohet se përbëjnë “deklarata, të dhëna apo informacione bindëse, apo të besueshme, të lidhura me identifikimin dhe ndalimin apo dënimin e autorit të krimit” (shiko *Brecknell kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 32457/04, § 71, 27 nëntor 2007). Në fakt, procedurat rikonfirmuan gjendjen tashmë ekzistuese sipas ligjit vendas, ku thuhet se nuk ekziston e drejta për apelim të vendimit të prokurorit për pezullim të hetimeve dhe përderisa nuk ka dalë asnjë e dhënë e re lidhur me çështjen, nuk ka asnjë detyrim procedural për të rihapur hetimin (shiko *McDermott dhe të tjerët kundër Irlandës dhe Keegan kundër Irlandës* (vend.), nr. 23213/09 dhe 62652/09, §§ 48-52, 25 shtator 2012). Ishte e qartë se nuk kishte asnjë arsye për të ndjekur procedurat e përmendura më sipër.

24. Kështu, duke e prezantuar ankimin e tij në vitin 2013, konkludohet se ankuesi nuk ka shfaqur kujdesin e duhur që të mund të zbatonte kërkesat që dëlnin nga Konventa dhe nga vendimet e saj sipas nenit 35 § 1 të Konventës. Për këtë arsye, ankesa kundërshtohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës, për arsye se nuk është dorëzuar brenda afatit kohor të duhur.

Për këto arsye, Gjykata në mënyrë unanime,  
*E deklaroi* ankimin të papranueshëm.

**Fatoş Aracı**                      **Päivi Hirvelä**  
ZËVENDËSSEKRETAR              PRESIDENT

SEKSIONI I KATËRT  
**ÇËSHTJA HAXHIA KUNDËR SHQIPËRISË**  
(Ankimi nr. 29861/03)

VENDIM  
STRASBURG  
8 tetor 2013

*Ky vendim bëhet i formës së prerë sipas rrethanave të përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet subjekt i redaktimeve.*

**Në çështjen Haxhia kundër Shqipërisë,**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur në një Dhomë të përbërë nga:

Ineta Ziemele, *presidente*

David Tór Björgvinsson,

George Nicolaou,

Zdravka Kalaydjieva,

Vincent A. De Gaetano,

Paul Mahoney, *gjyqtarë,*

Markelian Koca, *gjyqtar ad hoc,*

dhe Françoise Elens-Passos, *sekretare e Seksionit*

Pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, më 17 shtator 2013,

Lëshon vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë ditë:

## PROCEDURA

1. Çështja filloi me një ankim (nr. 29861/03) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (“Konventa”) nga një shtetas shqiptar, z. Ismet Haxhia (“ankuesi”), më 20 korrik 2003.

2. Ankuesi përfaqësohej nga z. K. Loloçi, avokat, i cili e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (“Qeveria”) përfaqësohej nga agjenti i saj, znj. L. Mandia e zyrës së Avokatit të Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, gjykatës i përzgjedhur për Shqipërinë, u tërhoq nga çështja (rregulli 28 i rregullores së Gjykatës). Për këtë arsye, Qeveria caktoi z. Markelian Koça në rolin e gjykatësit *ad hoc* në vend të tij (neni 27 § 2 i Konventës dhe rregulli 29 § 1, në fuqi në atë kohë).

4. Bazuar në nenet 5, 6 dhe 7 të Konventës, ankuesi pretendonte se kishte pasur një sërë shkeljesh.

5. Më 28 mars 2006, një Dhomë e Seksionit të Katërt, së cilës iu caktua çështja, vendosi të shqyrtonte ankimin për Qeverinë. Ajo, gjithashtu, vendosi të merrte një vendim mbi pranueshmërinë dhe cilësitë e ankimit në të njëjtën kohë (neni 29 § 1).

## FAKTET

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1954 dhe aktualisht po vuan dënimin me burgim, në burgun e Peqinit. Në kohën kur kanë ndodhur ngjarjet e përshkruara më poshtë, ankuesi ishte kreu i policisë së trafikut në Komisaratin e policisë së Bajram Currit, një qytet në verilindje të Shqipërisë.

#### A. Realiteti në vend

7. Në vitin 1997, vendi pësoi një shkatërrim total të strukturave institucionale qeveritare, si rezultat i përmbyesjes së një sërë skemash të ashtuquajtura “skema piramidale”. Armatimet u grabitën nga civilët, rendi publik u shkatërrua totalisht dhe vendi u zhyt në anarki dhe kaos për disa muaj.

8. Në vitin 1998, në njëfarë mënyre, rendi publik u rivendos, por problemet me sigurinë vazhduan, veçanërisht në pjesën verilindore të vendit, duke përfshirë Bajram Currit.

#### B. Vrasja e një deputeti

9. Më 12 shtator 1998, rreth orës 21:15, z. Azem Hajdari, deputet (“D”), dhe bodigardët e tij, B.C. dhe Z.N., u goditën ndërsa dilnin nga zyrat qendrore të Partisë Demokratike (“PD”) në Tiranë. Z. Hajdari dhe B.C. vdiqën në po të njëjtën ditë në spital. Bodigardi i dytë Z.N. ishte dëmtuar rëndë.

10. Z. Hajdari ishte një nga udhëheqësit e PD-së, e cila është një nga dy partitë kryesore politike në Shqipëri, dhe në atë kohë ishte në opozitë. Vrasja e tij shkaktoi një tension të menjëhershëm. Kështu, më 13

shtator 1998, protestuesit u dyndën drejt ndërtesës së Kryeministrit.

11. Protesta të mëtejshme shpërthyen në Tiranë, gjatë funeralit të të ndjerit, deputetit. Më tej, pasoi një revoltë e përgjithshme gjatë së cilës, individë të armatosur pushtuan me të shpejtë zyrat qendrore të televizionit shtetëror, Parlamentin dhe godina të tjera të rëndësishme.

12. Situata në Shqipëri ishte tema e rekomandimit nr. 1386 (1998) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, gjatë së cilit Asambleja dënoi rëndë dhunën politike, e cila erdhi pas vrasjes (shiko paragrafin 108 më poshtë).

### C. Hetimi penal për vrasjen

13. Pas vrasjes, u ndërmorën një sërë hapash investigativë.

14. U realizuan disa analiza mjekoligjore në skenën e krimit, si dhe u bënë ekzaminimet balistike të një arme automatike dhe një pistolete, të gjetura në vendngjarje. Nuk u bënë autopsi.

15. Në ditët pas vrasjes, policia mbledhi informacion nga pesë dëshmitarë. Rezultoi se një nga dëshmitarët, znj. A.R. pohoi se ajo e kishte parë mjaft mirë vrasësin dhe se mund ta njihnte atë. Një dëshmitar tjetër pohoi se kishte parë dy burra të dilnin nga një makinë policie (një Mercedes Benz 250, jeshil), duke qëlluar më pas deputetin dhe bodigardët e tij. Më tej, ai pohoi se një burrë tjetër në vendin e shoferit po priste në parking. Më pas, ai doli për të tërhequr nga vendngjarja deri në makinë, një nga agresorët, i cili ishte plagosur gjatë shkëmbimit të zjarrit.

16. Më 25 shtator 1998, prokurori morri në pyetje Z.N., bodigardin e plagosur, i cili i shpëtoi sulmit. Ai pohoi se kishte parë një person të panjohur, i cili kishte dalë nga sedilja e pasagjerit të një makine me sirenë policie në çatinë e saj, dhe kishte qëlluar me një armë automatike pa paralajmëruar. Nuk u përmend as emri i ankuesit dhe as përfshirja e tij në krim.

17. Në një datë të papërcaktuar, Z.N. u largua nga shteti i tij dhe shkoi në Belgjikë.

18. Më 15 dhjetor 1999, pas një deklaratë të publikuar nga z. Sali Berisha, udhëheqësi i PD-së, në të cilën u përmend emri i ankuesit si pjesëmarrës në vrasjen e deputetit, vetë ankuesi, me dëshirën e tij, vendosi të bënte një deklaratë përpara prokurorit. Ai pohoi, *inter alia*, se në ditën e krimit ishte duke ngrënë darkë, vetëm, në një restorant, i cili ndodhej pranë zyrave qendrore të PD-së. Sapo kishte dëgjuar të shtënë, i frikësuar për jetën e të vëllait, ankuesi ishte larguar nga restoranti dhe kishte bërë disa hulumtime. Më pas, ai u kthye përsëri në restorant dhe filloi të diskutonte ngjarjet me A.P. dhe H.A. (shiko paragrafin 72 më poshtë).

19. Në një datë të papërcaktuar në vitin 2000, M., i cili po vuante dënimin me burgim në burgun Regina Celli në Itali, u morr në pyetje nga prokuroria shqiptare. Më 18 shkurt 2000, u urdhërua arrestimi i M. për vrasje nga Gjykata e Rrethit Tiranë ("Gjykata e Rrethit"). Midis deklaratash shumë të paqarta, M. pohoi se ia kishte dhënë makinën e tij vrasësve.

20. Më 26 korrik 2000, M. u morr në pyetje për herë të dytë dhe ai akuzoi tre oficerë të lartë policie nga qyteti i Bajram Currit, se kishin kryer vrasjen. Oficerët ishin përkatësisht: F.M., i cili më herët kishte qenë shefi i Komisarariatit të Bajram Currit, J.M., i cili kishte qenë shefi i rendit publik në të njëjtin komisarariat policie dhe I.H., i cili kishte qenë bodigardi i mëparshëm i z. Berisha. J.M. dhe I.H. kanë depozituar ankime të veçanta në Gjykatë (*Mulosmani kundër Shqipërisë*, nr. 29864/03 dhe *Izet Haxhia kundër Shqipërisë*, nr. 34783/06). M. nuk e akuzoi ankuesin për përfshirje në vrasje.

21. Më 16 nëntor 2000, me kërkesë të prokurorit shqiptar, një gjykatës investigativ, nga Bruges, mori në pyetje Z.N. Në dëshminë e tij, ai pohoi se kishte parë një njeri të dilte nga pas një Mercedesi të zi. Ai mbante të veshur një jelek antiplumb mbi një uniformë ushtarake, të ngjashme me ato që mbajnë oficerët e policisë, dhe në duar kishte një automatik Kallashnikov, si edhe dy gëzhoja të ngjitura së bashku. Në kundërshtim me deklaratat e bëra në ditët pas vrasjes (shiko paragrafin 16 më sipër), ai aludoi se ai person ishte J.M. Ai pohoi se nuk e njohte ankuesin.

22. Më 20 janar 2001, një kriminel recidivist, i cili po vuante dënimin me burg në Shqipëri, bëri disa deponime përpara prokurorit. Ai kishte ndjekur ngjarjet që çuan në vrasjen e deputetit, nga veranda e katit të parë të një bari, i cili gjendej shumë pranë skenës së kriminit. Ai e kishte parë ankuesin në makinën e tij, një Fiat Tipo, përpara se të ndodhte vrasja. Sipas deponimeve të Ç., F.H., J.H. dhe N.C. hapën zjarr ndaj deputetit.

23. Më 6 mars 2001, pas arrestimit të ankuesit (shiko paragrafin 28 më poshtë), prokurori e mori atë në pyetje në prani të avokatit të tij. Ai deklaroi se natën e vrasjes, ai ishte në një hotel afër zyrave qendrore të PD-së. Në momentin e të shtënave, ai po hante darkë në restorantin e hotelit, i shoqëruar nga persona të tjerë. Makina e tij ishte parkuar afër hotelit dhe godinës së PD-së. Ai e mohoi të kishte pasur konflikte të mëparshme me deputetin e vrasë.

24. Më 10 mars 2001, në përputhje me nenin 316 § 1 (b) të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), prokurori i kërkoi Gjykatës së Rrethit të siguronte dëshminë e Ç., i cili pavarësisht se po vuante dënimin me burgim në Shqipëri, mendohej se rrezikohej të dhunohej. Avokati i ankuesit kërkoi kohë të përgatitej për mbrojtjen. Për këtë arsye, gjykata e shtyu seancën dëgjimore më 11 mars 2001.

25. Më 11 mars 2001, Gjykata e Rrethit përmbushi kërkesën e prokurorit. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore. Dëshmitari Ç. deponoi se nuk kishte marrë kërcënime, dhe se nuk i ishte bërë ndonjë premtim në shkëmbim për paraqitjen e tij në procesin gjyqësor. Fillimisht, ai kishte bërë deponime shumë të kufizuara përpara prokurorit në lidhje me vrasjen nga frika se personat e përfshirë në ngjarje ishin oficerë policie me rekorde kriminale të mëparshme. Në dëshminë e tij, Ç. pohoi se po errësohej dhe ai ishte në verandën e një bari që gjendej në anë të zyrave qendrore të PD-së. Ai pa makinën e ankuesit, por jo ankuesin personalisht. Kur deputeti doli nga zyrat qendrore të PD-së, ai takoi ankuesin dhe të dy patën një debat të nxehtë. Më pas, ai dëgjoi një të shtënë pistolette dhe automatiku. Pas vrasjes, ai pa ankuesin të mbërrinte me një makinë tjetër. Ankuesi pyeti për vrasjen dhe u largua nga skena.

26. Më 12 mars 2001, prokurori shkëputi procedurat penale kundër M. nga procedurat penale kundër ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë.

27. Më 31 maj 2002, prokurori i hoqi akuzat që rëndonin mbi M. për mungesë provash.

#### **D. Arrestimi i ankuesit**

28. Më 13 janar 2001, zyra e prokurorisë lëshoi pesë urdhra arrestesh për pesë oficerë të lartë policie, duke përfshirë edhe ankuesin, mbi dyshimin se mund të ishin përfshirë në vrasjen e deputetit, në vrasjen e bodigardit B.C., si edhe në vrasjen e mbetur në tentativë të bodigardit Z.N.

29. Më 22 janar 2001, ankuesi u arrestua. Ai u ngarkua me akuzën për dy vrasje, sipas neneve 79 (c) dhe 78 të Kodit Penal ("KP") dhe me akuzën e një vrasje të mbetur në tentativë, sipas nenit 78 të KP-së.

30. Më 23 janar 2001, ankuesi u morr në pyetje nga prokurori. Ai u bë me dije për akuzat që rëndonin mbi të dhe për mundësinë që kishte për të caktuar një avokat. Si rezultat, ai kërkoi të përfaqësohej nga një avokat i zgjedhur prej tij. Në po të njëjtën ditë, prokurori kërkoi zbatimin për arrestim të ankuesit.

31. Në seancën dëgjimore të datës 24 janar 2001, ankuesi u përfaqësua nga avokati i tij. Ai pohoi se kishte udhëtuar drejt Tiranës më 11 shtator 1998, për të blerë disa pjesë këmbimi për makinën e tij të biznesit. Në mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, ai po hante darkë në një restorant, i cili ndodhej pranë zyrave qendrore të PD-së. Makina e tij ishte parkuar aty afër. Më tej ai pohoi se prokurori nuk kishte dorëzuar asnjë provë që vërtetonte pjesëmarrjen e tij në vrasje. Duke qenë se ai kishte punuar për dy vitet e fundit, nuk kishte rrezik për arratisje. Prokurori parashtrij mendimin se, përderisa hetimi do të vazhdonte për disa kohë, ankuesi do të informohej për faktet kundër tij në kohën e duhur. Gjykata e Rrethit konfirmoi hyrjen në fuqi të vendimit

për arrestimin e ankuesit dhe aprovoi ndalimin e tij me burg përpara procesit për një periudhë të papërcaktuar, sepse kishte dyshime të arsyetueshme që ankuesi kishte qenë bashkëpunëtor në vrasjen e deputetit.

32. Më 31 janar 2001, ankuesi dorëzoi një apelim të drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë kundër arrestimit të tij, duke argumentuar se prokurori nuk kishte paraqitur prova të mjaftueshme dhe të detajuara.

33. Më 9 shkurt 2001, Gjykata e Lartë mori vendimin se, përderisa Gjykata e Rrethit nuk e kishte vërtetuar rrezikun e një arrestimi, ndalimi fillestar me burgim i ankuesit nuk ishte i ligjshëm. Megjithatë, Gjykata e Lartë mbështeti vendimin që ai të mbetej në gjendje arresti, duke pasur parasysh rrethanat e kryerjes së krimit, rrezikun që krimi paraqiste për rendin publik, si edhe dyshimin se ankuesi kishte bashkëpunuar në realizimin e krimit. Ajo theksoi se vlerësimi i fakteve ishte çështje e cilësive të çështjes.

#### **E. Procedurat e procesit gjyqësor**

34. Më 13 mars 2001, prokurori dorëzoi padinë në Gjykatën e Rrethit. Padisë iu bashkëngjiti edhe një listë e gjatë me dokumente shtesë. Ankuesi dhe katër të bashkëpunëtorët u paditën për pjesëmarrje ose për organizimin e vrasjes së deputetit, si edhe për tentativën për vrasje të civilëve, sipas neneve 78, 79 (c) dhe 25 të KP-së.

35. Më 16 mars 2001, përfaqësuesi i ankuesit mori në dorë dosjen e hetimit, e cila përbëhej nga 324 dokumente dhe 1,409 faqe.

##### *1. Kërkesa e ankuesit*

36. Ankuesi parashtrroi një sërë kërkesash në procesin gjyqësor.

37. Më 3 prill 2001, avokati i ankuesit kërkoi tridhjetë ditë në dispozicion për të shqyrtuar dokumentet e mbledhura gjatë hetimit penal, sepse prokurori nuk kishte dhënë asnjë informacion në lidhje me hetimin.

38. Më 3 prill 2001, Gjykata e Rrethit, në seancën e saj të parë dëgjimore, pranoi kërkesën e ankuesit për më shumë kohë, deri më 13 prill 2001.

39. Më 13 prill 2001, ankuesi kundërshtoi materialet e pranuar në cilësinë e provës, të cilat përbëheshin nga disa kasete audio dhe video, si edhe nga deklaratat e 29 dëshmitarëve, emrat e të cilëve nuk ishin paraqitur në listën e dorëzuar nga prokurori, duke qenë se ai nuk ishte informuar për përmbajtjen e tyre.

40. Më 9 shtator 2001, ai, gjithashtu, kërkoi të bëheshin një sërë ekzaminimesh nga ekspertët: inspektimi i dy makinave, të cilat pretendoheshin se kishin qenë në skenën e krimit, analiza e firmës me shkrim dore të dëshmitarit Ç., si edhe verifikimi se sa e mundur është të kesh një pamje të pastër të një rruge të errët nga një vend i mirëndriçuar, kjo në lidhje me dëshmitarin Ç.

41. Më 17 janar 2002, gjykata i hodhi poshtë kërkesat e ankuesit, pa dhënë ndonjë arsye.

#### *2. Dëshmitë e dëshmitarëve*

42. Një sërë dëshmitarësh u morën në pyetje nga gjykata në lidhje me vrasjen, duke përfshirë sa më poshtë:

##### **a) Dëshmitari K.G.**

43. Në kohën e vrasjes, dëshmitari K.G. ishte shefi i Komisarariatit të policisë së Bajram Currit. Më 23 maj 2001, ai dëshmoi se me t'u lajmëruar për vrasjen në mbrëmjen e 12 shtatorit 1998, ai kishte thirrur në një takim drejtuesit e njësive për të rritur nivelin e sigurisë. Ankuesi nuk ishte i pranishëm.

##### **b) Dëshmitari M.**

44. Sipas nenit 509 të KPP-së dhe Konventës Evropiane për Ndihmë të Ndërsjellë për Çështjet Penale ("Konventa e Ndihmës së Ndërsjellë"), më 23 maj 2001, prokurori kërkoi që M. të merrej në pyetje me anë të një lidhje me video nga Italia. Ankuesi e kundërshtoi këtë kërkesë për mungesë të bazës ligjore.

45. Më 1 qershor 2001, ankuesi kërkoi përjashtimin nga dosja e çështjes së deklaratave të bëra nga M. gjatë procedurave penale. Gjithashtu, ai kërkoi të ekstradohej nga Italia, në mënyrë që të ishte i pranishëm fizikisht në procesin gjyqësor. U dëgjuan edhe tre dëshmitarë të tjerë.

46. Më 21 shtator 2001, gjykata pranoi kërkesën e prokurorit për të marrë dëshminë e M. me anë të një lidhje me video, në përputhje me nenin 151 § 3 të KPP-së. Gjithashtu, gjykata pranoi që të fuste në dosjen e çështjes deklaratat e M.

47. Më 29 tetor 2001, gjykata dëgjoi M. me anë të një lidhje me video. Në një deklaratë të lëshuar në po të njëjtën ditë, ankuesi dhe një tjetër i bashkëpunëtor deklaruan qëllimin e tyre për të mos e ndjekur seancën dëgjimore, duke pasur parasysh mungesën e bazës ligjore për lidhjen me video. Ata nuk i autorizuan avokatët e tyre respektivë t'i përfaqësonin dhe rezervuan të drejtën për të ndjekur seancat e tjera dëgjimore.

48. Gjatë dëshmisë së tij M. nuk pohoi ta kishte parë ankuesin para apo pas vrasjes.

49. Më 3 dhjetor 2001, ankuesi i kërkoi gjykatës të mos e merrte parasysh dëshminë e M. dhe deklaratat e bëra gjatë hetimit penal, për arsye të mungesave teknike dhe kontradiktave në dëshminë e tij.

##### **c) Dëshmitari A.L.**

50. A.L. ishte shofer në stacionin policor të Bajram Currit dhe më 8 maj 2001, ai bëri një deponim përpara prokurorit. Sipas pohimeve, A.L. ishte larguar në një mision në Tiranë, vonë në mbrëmjen e 10 shtatorit 1998. Kërkesa ishte bërë nga J.M., i cili ishte shefi i rendit publik. Atij nuk i ishte dhënë asnjë detaj në lidhje me qëllimin e misionit. Ai u shoqërua nga F.H. dhe E.H. gjatë rrugës për në Tiranë, A.L. vuri re një Fiat Tipo pas tyre, edhe pse nuk mund të shihte shoferin e saj. Kur ndaluan në një bar për të pirë diçka, me ta u bashkua edhe N.C. Në atë moment, A.L. vuri re Fiatin t'u kalonte pranë dhe



dalloi shoferin e saj, i cili ishte ankuesi. Me të mbërritur në Tiranë, pas një gjumi të shkurtër në hotel, A.L. nuk pa më as Fiatin dhe as ankuesin në parkingun e hotelit. Ai nuk përmendi, as gjatë 11 shtatorit as në 12 shtator, të kishte parë ankuesin. A.L. u kthye në Bajram Curri në mbrëmjen e 12 shtatorit, i pashoqëruar nga asnjë makinë tjetër.

Deklarata iu paraqit të pandehurit dhe gjykatës në një datë të papërcaktuar në vitin 2001.

51. Më 25 korrik 2001, gjykata dëgjoi dëshminë e A.L. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore dhe i drejtuan pyetje A.L.-së.

52. Sipas dëshmisë së A.L., në mbrëmjen e 10 shtatorit 1998, ai kishte marrë një urdhër nga J.H. të përgatiste një furgon dhe të udhëtonte drejt Tiranës. Ndërsa largohej nga Bajram Curri, ai vuri re se një Fiat Tipo, e cila ishte makina e ankuesit, i ishte bashkuar autokolonës prej tre makinash. Rrugës për në Tiranë, një person i katërt, N.C, ishte bashkuar me ta ndërsa kishin ndaluar për të pirë diçka në një bar. Ankuesi nuk ndaloi. Me të mbërritur në Tiranë, ata shkuan në një hotel-bar, ku ai pa të parkuar makinën e ankuesit. Pasi pushuan për disa orë në një nga dhomat e hotelit, të gjithë vendosën të bënin një xhiro me makinë rreth qytetit, me përjashtim të ankuesit, makina e të cilit nuk dukej më. A.L nuk pohoi ta kishte parë ankuesin më 12 shtator 1998.

53. Më 26 korrik 2001, avokati i të pandehurit u ankua se prokurori nuk e kishte lejuar të përgatiste mbrojtjen e duhur, për pasojë deponimet e A.L. nuk mundën të paraqiteshin më 8 maj 2001. Prokurori u përgjigj se deponimet u paraqitën sapo ishin marrë. Gjithashtu, dëshmitari u thirr në gjyq për të dëshmuar përpara gjykatës dhe të pyetej nga përfaqësuesi i ankuesit. Sipas prokurorit, A.L. pohoi se nuk e kishte takuar ankuesin në asnjë moment midis 11 dhe 12 shtatorit, por e kishte parë makinën e tij gjatë pushimit, rrugës për në Tiranë, dhe në parkingun e bar-hotelit. Ai nuk e kishte parë makinën të parkuar pranë Sheshit të Ushtarit të Panjohur ditën e krimit. Gjykata kundërshtoi ankesën e të pandehurit.

#### **d) Dëshmitari J.M.**

54. Më 27 korrik 2001, J.M., i cili ishte njëri nga të bashkëpandehurit, dëshmoi në gjykatë. Sipas dëshmisë së tij, me kërkesë të F.H, të dy ata së bashku me E.H. u larguan nga Bajram Curri mbrëmjen e 10 shtatorit 1998, në një furgon policie, të drejtuar nga A.L. Duke dalë nga qyteti ata kishin vënë re ankuesin, i cili ngiste një makinë tjetër. Kur arritën në Tiranë, ankuesi mori një drejtim tjetër, për t'u marrë me disa çështje personale.

55. Më 30 korrik 2001, J.M u rimorr në pyetje nga të gjitha palët.

#### **e) Dëshmitarja P.G.**

56. P.G. dëshmoi më 20 shtator 2001. Edhe pse ishte dëshmitare okulare e vrasjeve, ajo nuk përmendi të kishte parë ankuesin në skenën e krimit.

#### **f) Dëshmitari Ç.**

57. Më 13 qershor 2001, ankuesi i kërkoi gjykatës të mos e pranonte dëshminë e Ç. të dhënë më 11 mars 2001. Duke qenë se nuk kishte asnjë pengesë ligjore që Ç. të paraqitej në procesin gjyqësor, dhe duke qenë se deponimet e tij implikonin drejtpërsëdrejti ankuesin dhe të bashkakuzuarit e tjerë, ai kërkoi që Ç. të thirrej për të dëshmuar në gjykatë. Më vonë u zbulua se nuk ishte marrë asnjë vendim nga gjykata.

58. Më 9 nëntor 2001 dhe 20 shkurt 2002, pas kërkesës së bërë, gjykata nuk i dha të drejtën të pandehurit të ndërmerre veprime investigative, duke përfshirë edhe një kontroll, nëse ka qenë e mundur që Ç. të shikonte në errësirë nga një vend i ndriçuar mirë, në një distancë prej 60/150 metrash.

59. Më 17 janar 2002, gjykata nuk e pranoi kërkesën e të pandehurit për realizimin e një ekspertize për të vërtetuar se sa i aftë ka qenë Ç. për të parë detajet në skenën e krimit.

60. Më 24 janar 2002, avokati i të pandehurit kërkoi të thërritej Ç. për të dëshmuar. Gjykata e kundërshtoi këtë kërkesë, duke qenë se dëshmia e tij ishte marrë më 11 mars 2001. Megjithatë, më 18 shkurt 2002, gjykata e rishikoi këtë vendim dhe thirri Ç. të paraqitej në gjykatë.

61. Më 20 shkurt 2002, Ç. dëshmoi. Ai pohoi se rreth orës 9:00 të mbrëmjes, të datës 12 shtator 1998, ai ishte ulur në verandën e një bar-kafeje, 60 metra larg skenës së krimit. Pavarësisht faktit se jashtë ishte tërësisht errësirë dhe po binte shi, ai pa të pandehurin dhe makinën e tij me disa persona të tjerë brenda. Ankuesi vuri në dyshim besueshmërinë e deponimeve të bëra nga Ç. deri në ato momente, për faktin se deponimet e tij përfshinin persona dhe makina, të cilat nuk ishin përshkruar nga dëshmitarët e tjerë në skenën e krimit. Kërkesa e ankuesit për të testuar se sa i aftë ishte Ç. të shikonte nga një verandë e ndriçuar mjaft mirë, në një rrugë të errët, u kundërshtua përsëri nga gjykata (shiko edhe paragrafët 41, 58 dhe 59 më sipër), e cila pohoi se kjo e dhënë do të shqyrtohej së bashku me provat e tjera.

62. Në një datë të papërcaktuar, u morr në pyetje pronari i kafenesë ku Ç. ishte ulur mbrëmjen e 12 shtatorit 1998. Ai pohoi se atë ditë, kafeneja u mbyll si zakonisht në orën 19:00. Veranda ndodhej rreth 200 metra larg nga skena e krimit.

#### **g) Dëshmitari Z.N.**

63. Në një datë të papërcaktuar, gjykata mori materialet e përgatitura me shkrim nga Z.N., i cili u plagos rëndë ditën e vrasjes. Ai nuk përmendte nëse ankuesi ishte i pranishëm në skenën e krimit.

#### **h) Dëshmitarët E.B., A.P. dhe H.A.**

64. Më 24 dhjetor 2001, dëshmitarët E.B, A.P. dhe H.A. dëshmuar se në kohën e të shtënave, ata po hanin darkë në një restorant afër skenës së krimit.

### i) Dëshmia e ankuesit

65. Më 5 mars 2002, ankuesi përgatiti disa materiale të detajuara në lidhje me lëvizjet e tij në datat 11 dhe 12 shtator 1998. Ai pohoi se, me kërkesë të eprorit të tij, ai u largua vetëm nga Bajram Curri herët në mëngjesin e 11 shtatorit 2001. Në kundërshtim me pohimet e A.L., ai nuk e dinte se J.M. ishte nisur për në Tiranë në po të njëjtën ditë. Ai nuk e pranoi se kishte qenë në hotel në mëngjesin e 11 shtatorit, siç kishte deklaruar A.L.

66. Më 8 mars 2002, ankuesi dëshmoi. Ai pohoi se më 10 shtator 1998, mori disa udhëzime me gojë, për të shkuar në një mision në Tiranë. Megjithatë, nuk u përgatit asnjë autorizim apo urdhër me shkrim. Ai u largua nga Bajram Curri në orën 2 të mëngjesit, të datës 11 shtator 1998, vetëm, me makinën e tij. Po ta kishte ditur se J.M dhe tre persona të tjerë po udhëtonin në një automjet tjetër, do të ishte bashkuar me ta, duke pasur parasysh situatën e paqëndrueshme në rajon në atë kohë. Ai nuk kishte qenë kurrë në një bar-hotel, siç pretendonte A.L. Ndërsa në lidhje me praninë e tij në funeralin e N.C., ai thjesht po shoqëronte F.H. dhe E.H. me kërkesë të F.H.

#### 3. Parshtrimet përfundimtare të palëve

67. Më 18 mars 2002, gjykata kërkoi parashtrimet përfundimtare të palëve. Në po të njëjtën ditë, prokurori bëri parashtrimet e tij përfundimtare në favor të dënimit të ankuesit, siç edhe ishte akuzuar ky i fundit.

68. Më 10 prill 2002, ankuesi bëri parashtrimet e tij të fundit.

#### 4. Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 29 prill 2002

69. Më 29 prill 2002, Gjykata e Rrethit shpalli vendimin. Ajo konstatoi se ankuesi kishte ndihmuar dhe mbështetur autorët e krimit, duke i shoqëruar natën e 10 shtatorit 1998 me makinën e tij të policisë. Makina e tij ishte parkuar pranë skenës së krimit natën e 12 shtatorit 1998, dhe ai ishte parë në skenën e krimit pas kryerjes së krimit. Edhe pse ishte në dijeni se F.H. kërkohet nga policia, ai vazhdoi të mbante kontakte me F.H. dhe vëllanë e tij, dhe më pas u pa edhe në funeralin e N.C., përfshirja e tij në organizimin e krimit u vërtetua nga dëshmitarët A.L., K.G dhe J.M. Dëshmitarët e ankuesit nuk kishin asnjë dyshim për ato përfundime. Vendimi interpretohet si më poshtë:

“Një tjetër person, i cili mori pjesë në realizimin e krimit, është i akuzuari Ismet Haxhia.

Një sërë veprimesh, të cilat nisën ... me shoqërimin e skuadrës nga Bajram Curri në Tiranë, dhe më tej në hotel “Murati”, ku skuadra u akomodua pasditen e 11 shtatorit 1998, praninë e tij në skenën e krimit ... së bashku me makinën e tij Fiat Tipo ..., si edhe me praninë e tij në familjen e N.C., 40 ditë pas vdekjes së tij, krijojnë bindjen për gjykatën se ai ka qenë bashkëpunëtor, ndihmës në kryerjen e krimit.

Pjesa e mësipërme provohet me anë të të dhënave të dëshmitarit A.L., i cili ishte i pranishëm në ato ngjarje; me dëshminë e K.G., i cili pohoi se Ismet Haxhia ... nuk kishte marrë leje të shkonte në Tiranë më 11 dhe 12 shtator.

Prania e tij në ngjarjet e mësipërme provohet edhe me anë të dëshmisë së të bashkëpunëtorit J.M.

Tërësia e këtyre veprimeve, si elemente të *actus reus* të krimit, e çuan gjykatën në përfundimin se i akuzuari Ismet Haxhia është bashkëpunëtor, ndihmës në realizimin e krimit.

Dëshmitarët e thirrur nga i akuzuari nuk e mohuan apo e vunë në dyshim praninë e tij në ato ngjarje, të cilat kishin lidhje me përgatitjen, realizimin dhe zhvillimet që ndodhën më pas.”

70. Gjithashtu, gjykata besonte se deputeti nuk u vra për arsye politike, por për hakmarrje, pasi mendohej se ai ishte përfshirë në vrasjen e vëllait të F.H. për pasojë, gjykata i riklasifikoi akuzat kundër ankuesit si vrasje e paramenduar e realizuar për hakmarrje, sipas nenit 78 § 2 të KP-së, i cili hyri në fuqi më 24 janar 2001. Vendimi interpretohet si më poshtë:

“Prokuroria e riklasifikoi vrasjen në përputhje me nenin 79 (c), duke e lidhur me faktin se gjatë një seance parlamentare, deputeti i vrarë kishte akuzuar F.H. për vrasjen (e një polici).

Në këto rrethana, (prokurori) përcaktoi se motivi për vrasjen e deputetit kishte qenë pozicioni i tij si deputet. Megjithatë, provat e sjella në procesin gjyqësor, rrethanat dhe ngjarjet që çuan në vrasjen e deputetit vërtetojnë se vrasja është kryer për motivet e dobëta të hakmarrjes.”

71. Në lidhje me vendimin për dy të bashkëpunëtorit, gjykata i kundërshtoi dëshmitë e dëshmitarëve Ç. dhe M. si kontradiktore dhe të pabesueshme. Gjithashtu, gjykata e shpalli J.M. të fajshëm, si edhe më herët.

72. Gjykata e Rrethit e shpalli ankuesin fajtor për ndihmën e ofruar dhe bashkëpunimin në vrasjen e deputetit, sipas neneve 78 § 2 dhe 25 të KP-së dhe e shfajësoi nga akuzat për vrasjen e B.C. dhe vrasjen e mbetur në tentativë të Z.N. ankuesi u dënua me 20 vjet burg. Vendimi interpretohet si më poshtë:

“Siç u përmbledh edhe nga prokurori, në këtë çështje ekziston vetëm një bashkëpunim i thjeshtë dhe jo një skemë me role, detyra, objektiva dhe plane (të përcaktuara). Në këtë bashkëpunim, mbështetësi dhe ndihmësi ... Ismet Haxhia ka kontribuar në mënyra të ndryshme, por gjithmonë për të vetmin qëllim për të vrarë Azem Hajdarin.

Nëse nuk provohet se ka ekzistuar një plan i detajuar midis bashkëpunëtorëve dhe individëve të tjerë, të cilët nuk jetojnë më, ose se ka ekzistuar një marrëveshje verbale, duke përcaktuar kështu rolin e gjithsecilit për përbushjen e qëllimit final ... i pandehuri Ismet Haxhia nuk mund dhe nuk duhet të bëhet përgjegjës për veprimet e autorit të krimit. Duke mos qenë i lidhur me (ekzistencën e) një skemë të përcaktuar dhe duke mos qenë autori i vrasjes së paramenduar, Ismet Haxhia duhet të jetë përgjegjës vetëm për (ndihmën dhe mbështetjen e ofruar në) vrasjen e paramenduar të Azem Hajdarit.”

#### 5. Procedurat kundër mungesës së paanshmërisë së Gjykatës së Rrethit

73. Më 29 tetor 2001, në orën 10:00 të mëngjesit, ankuesi dhe një tjetër bashkëpunëtor pohuan përpara Gjykatës së Apelit Tiranë (“Gjykata e Apelit”), se banka e Gjykatës së Rrethit nuk ishte e paanshme. Ata pretenduan se ky fakt ishte demonstruar me hedhjen poshtë të të gjitha mocioneve të tyre dhe me pranimin e fakteve të marra në mënyrë të paligjshme, si p.sh. dëshmia e M. (shiko paragrafin 47 më sipër).

74. Në po të njëjtën ditë, në mungesë të ankuesit dhe të përfaqësuesit të tij, por në prani të prokurorit, Gjykata e Apelit e hodhi poshtë kërkesën, me pretendimin se kjo e fundit kishte të bënte me vlerësimin e fakteve, të cilat do të shqyrtoheshin gjatë çdo apelimi të bërë kundër dënimit.

75. Më 9 nëntor 2001, ankuesi apeloj kundër vendimit në Gjykatën e Lartë. Dokumenti i dorëzuar i apelimit mban datën 13 nëntor 2001 dhe ka vulën e gjykatës, sipër në cepin e djathtë.

76. Më 14 janar 2002, ankuesi pyeti për apelimin e tij në Gjykatën e Lartë. Gjykata e Rrethit u përgjigj se Gjykata e Lartë nuk kishte bërë asnjë kërkesë për transferimin e dosjes së çështjes për shqyrtim.

77. Apelimi nuk u shqyrtua kurrë nga Gjykata e Lartë, por iu referua vendimit të tij të datës 14 shkurt 2003 (shiko paragrafin 87 më poshtë).

#### **F. Procedurat e Gjykatës së Apelit**

##### *1. Procedurat përpara Gjykatës së Apelit*

78. Më 7 maj 2002, ankuesi paraqiti një apelim kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit. Ai pohoi se prokurori kishte paraqitur padinë dhe e kishte transferuar dosjen e gjyqit pa treguar më parë asnjë nga dokumentet. Gjykata nuk i kishte dhënë kohë të mjaftueshme për të shqyrtuar dokumentet mbi të cilat prokurori mbështeste akuzat. Mosnxjerrja në kohë e deponimeve të A.L., të datës 8 maj 2001, e penguan atë të përgatiste mbrojtjen e duhur; në dëshminë e tij A.L. thjesht kishte pohuar se gjatë rrugës për në Tiranë kishte parë makinën e ankuesit ta parakalonte. Më tej, ai e kontestoi mënyrën në të cilën ishte marrë dëshmia e M., si edhe mungesën e M. në seancën dëgjimore.

Më tej, ankuesi shprehu pakënaqësinë se vendimi i Gjykatës së Apelit i datës 29 tetor 2001, ishte marrë në mungesën e tij dhe se ai shkëlqë parimin e procedurave kundërshtuese (shiko paragrafin 74 më sipër). Apelimi i tij kundër atij vendimi ishte ende i pazgjidhur në Gjykatën e Lartë. Sipas ankuesit, gjykata nuk i dha peshën e duhur dëshmimeve të dëshmitarëve, të cilat vërtetonin se ai po hante darkë në një restorant aty afër kur u vra deputeti (shiko paragrafin 64 më sipër). As dëshmitarët okularë P.G., Z.N. dhe S.L. nuk deklaruan se e kishin parë në skenën e krimit ose se kishin parë një makinë policie të parkuar aty pranë. Në kundërshtim me interpretimin e veprimeve të tij nga ana e gjykatës, nuk kishte asnjë element të dukshëm kriminal, në faktin se dy ditë përpara vrasjes, ai kishte udhëtuar me njerëzit, të cilët më vonë vranë deputetin, dhe as në faktin se kishte marrë pjesë në funeralin e N.C., dyzet ditë pas vrasjes; dhe as në faktin se pesëmbëdhjetë vjet më parë kishte njohur vëllanë e F.H. Vendimit të gjykatës i mungonin arsyet për të provuar rolin e tij si ndihmës, bazuar në nenin 26 të KP-së.

79. Në seancën dëgjimore të datës 8 korrik 2002, ankuesi dorëzoi një përmbledhje të plotë të fakteve dhe

bëri një listë të detajuar me kërkesa për Gjykatën e Apelit; specifikisht: pranimin e fakteve, ndërmarrjen e veprimeve të tjera hetuese dhe marrja në pyetje e disa dëshmitarëve të tjerë.

80. Më 9 korrik 2002, Gjykata e Apelit pranoi si fakte një sërë dokumentesh sipas kërkesës së ankuesit dhe kundërshtoi pjesën tjetër të kërkesave të tij. Në po të njëjtën datë, ajo mbështeti plotësisht vendimin e Gjykatës së Rrethit. Gjykata e Apelit theksoi veçanërisht vendimin se ankuesi kishte marrë pjesë si ndihmës në kryerjen e krimit. Për shembull, ai kishte shoqëruar autorët e krimit nga Bajram Curri në Tiranë dhe anasjellas, ishte parë në hotel, makina e tij ishte parkuar afër skenës së krimit, ishte shok i ngushtë i H.H., i cili ishte vëllai i F.H., dhe ishte parë të shkonte për vizitë në familjen e N.C., 40 ditë pas vdekjes së tij. Roli i tij u përcaktua bazuar në dëshmitë e të bashkëpandehurit J.M., të dëshmitarëve A.L. dhe L.G., si edhe të dëshmitarëve të tjerë. Dëshmitarët e ankuesit nuk ngritën dyshime për praninë e tij gjatë ngjarjeve të sipërpërmendura.

81. Gjykata e Apelit mbështeti edhe dënimin për J.M.

##### *2. Procedurat përpara Gjykatës së Lartë*

82. Më 31 korrik 2002, J.M., një nga të bashkëpandehurit, apeloj në Gjykatën e Lartë, duke argumentuar *inter alia* se gjykatat e shkallëve më të ulëta nuk kishin fuqinë të riklasifikonin akuzat kundër tij.

83. Më 5 gusht 2002, ankuesi paraqiti një apelim në Gjykatën e Lartë, duke mbështetur të njëjtin apelim të dorëzuar përpara Gjykatës së Apelit, dhe me shtesën se vendimi i Gjykatës së Apelit nuk ishte gjykuar drejtë. Dënimi i tij ishte bazuar në fakte rrethanore në vend të fakteve që të mund të vërtetonin veprime konkrete të jashtëligjshme të kryera nga ai.

84. Më 14 shkurt 2003, Gjykata e Lartë mbështeti vendimin e gjykatave të shkallëve më të ulëta.

85. Gjykata e Lartë konstatoi se, pavarësisht faktit se në dosjen e çështjes nuk kishte pasur një vendim formal për të mbyllur fazën hetuese dhe për të paraqitur dokumentet e mbledhura gjatë hetimit penal ndaj ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë, më 3 prill 2001, Gjykata e Rrethit e kishte pranuar kërkesën e ankuesit për më shumë kohë dhe i kishte dhënë kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

86. Gjykata e Lartë konstatoi se deponimet dhe dëshmia në video e M. ishin marrë në bazë të neneve 151 § 3 dhe 509 të KPP-së, si edhe në bazë të Konventës për Ndihmë të Ndërsjellë. Deklaratat e M. gjatë hetimit penal ishin bërë subjekt i një ekzaminimi ligjor me anë të një lidhje me video. Fakti se ankuesi ishte larguar nga seanca dëgjimore nuk e bënte nxjerrjen e fakteve të paligjshme, duke pasur parasysh praninë e të bashkëpandehurve të tjerë dhe të avokatëve të tyre, të

cilët kishin ushtruar të drejtën ta rimerrnin në pyetje M. Pasi Gjykata e Lartë dënoi sjelljen e ankuesit në seancën dëgjimore, ajo thirri trupën gjyqësore për t'u siguruar që në të ardhmen të siguroheshin avokatë të përcaktuar nga gjykata në mënyrë që të garantohej mbrojtja e të drejtave të palës mbrojtëse.

87. Gjykata e Lartë theksoi se dosja e çështjes përmbante një kopje të apelimit të ankuesit më 9 shtator 2001 (shiko paragrafin 75 më sipër), por ajo vendosi se apelimi nuk ishte dorëzuar në përputhje me kërkesat ligjore (në regjistrin e gjykatës nuk kishte asnjë shënim për datën e prezantimit të tij).

88. Fakti se ankuesi dhe bashkëtpandehurit nuk kishin marrë më herët një kopje të deklaratës së dëshmitarit A.L., nuk shkel të drejtat e tyre për mbrojtje: A.L. kishte dëshmuar në procesin gjyqësor me kërkesë të ankuesit dhe ankuesi nuk kishte pasur mundësi ta pyeste atë.

89. Në përgjigje të ankesës së ngritur nga i bashkëtpandehuri J.M., Gjykata e Lartë konstatoi se riklasifikimi i akuzave nga gjykata kundër ankuesit ishte në përputhje me ligjin, më konkretisht neni 375 i KPP-së, i cili ka hyrë në fuqi më 13 qershor 2002.

90. Gjykata e Lartë theksoi se, ndërsa ankuesi ka të drejtën të kërkojë rihapje të ekzaminimit ligjor, është e drejta e gjykatës të mbledhë fakte shtesë. Në këtë rast, Gjykata e Apelit kishte pranuar si fakte një sërë dokumentesh dhe kishte hedhur poshtë pjesën e mbetur të mocioneve të ankuesit me pretendimin se ato ishin të panevojshme për ekzaminimin e çështjes.

91. Në fund, Gjykata e Lartë hodhi poshtë pjesën e mbetur të ankesave të të pandehurit me pretendimin se ato kishin të bënin me vlerësimin e fakteve, çka është një funksion i kryer nga gjykatat e shkallëve më të ulëta.

### 3. Procedurat përpara Gjykatës Kushtetuese

92. Në një datë të paspecifikuar, ankuesi paraqiti një apelim kushtetues përpara Gjykatës Kushtetuese. Ai pretendonte se arrestimi i tij i parë nuk ishte bazuar në ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm dhe se ai nuk ishte informuar siç duhej për arsyet e atij arrestimi. Më tej ai pretendonte se nuk kishte pasur mjaftueshëm kohë për të studiuar informacionin voluminoz në dosjen e hetimit penal, e cila i ishte dorëzuar gjykatës. Sipas tij, disa nga faktet janë siguruar në mënyrë të paligjshme: dëshmia e M. nuk është marrë nga Ministria e Drejtësisë, siç parashikohet në nenin 509 të KPP-së, duke qenë se Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë kishte hyrë në fuqi në një datë të mëvonshme për Shqipërinë; dëshmia e M. ishte marrë në mungesë të ankuesit; dëshmia e Ç. ishte marrë me shumë nxitim në një ditë të diel, pa e informuar plotësisht ankuesin për arsyet; dhe deklaratat e J.M. dhe A.L. të datës 6 dhe 8 maj 2001 respektivisht, u morën pas konkluzionit të hetimit penal, në shkelje të ligjit vendas (neni 324 § 4 i KPP-së).

93. Ankuesi parashitri pakënaqësinë se të gjitha kërkesat e tij për raporte të përgatitura nga ekspertët apo për të thirrur dëshmitarë ishin kundërshtuar me pa të drejtë nga gjykata. Gjykata e Apelit nuk kishte mundur të jepte arsye për refuzimin e kërkesës së tij për të siguruar disa fakte. Ankuesi ishte i pakënaqur, duke pretenduar për mungesë paanshmërie nga ana e gjykatave vendase, duke iu referuar veçanërisht vendimit të Gjykatës së Apelit të datës 29 tetor 2001, i cili ishte marrë në një procedurë shumë të shpejtë, brenda dy orëve në mungesë të tij apo të përfaqësuesve përkatës. Fakti që Gjykata e Lartë nuk e shqyrtoi apelimin e tij përbën shkelje të nenit 2 të protokollit nr. 7 të Konventës. Dënimi i tij nuk u arsyetua dhe u bazua në fakte rrethanore (udhëtimi në Tiranë së bashku me autorët e krimit, të darkuarit 200 metër larg nga skena e krimit në ditën e krimit, prezenca në funeralin e N.C., dyzet ditë pas krimit dhe miqësia e tij me të vëllanë e autorit të krimit (H.H.) dhjetë vjet përpara se të ndodhte krimi).

94. Edhe J.M. apeloj në Gjykatën Kushtetuese duke argumentuar, *inter alia*, se gjykatat e shkallëve më të ulëta i kishin tejkualuar kompetencat e tyre kur kishin riklasifikuar akuzat penale kundër tij.

95. Më 9 korrik 2003, Gjykata Kushtetuese, e mbledhur në një formacion të plotë prej nëntë gjyqtarësh, e deklaroi apelimin të papranueshëm me pretendimin se apelimi nuk përbente shkelje të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë.

## II. LIGJET VENDASE DHE NDËRKOMBËTARE TË LIDHURA ME ÇËSHTJEN

### A. Kodi Penal

96. Neni 26 § 5 parashikon se ndihmësit janë persona, të cilët me anë të këshillave të tyre, udhëzimeve, mjeteve, ngritjes së pengesave, premtiveve për të fshehur bashkëfajtorët e tjerë, gjurmët ose objektet që janë të lidhura me aktin kriminal; ndihmojnë në realizimin e këtij akti.

97. Në kohën e realizimit të krimit, neni 78, i amenduar në vitin 1996, parashikonte se vrasja me paramendim kërkonte një dënim me burgim të përjetshëm. Neni 79 (c), i cili ka të bëjë me aktin kriminal të vrasjes me qëllim, për shkak të pozicionit të viktimës, parashikonte burgim të përjetshëm.

98. Sipas ligjit nr. 8733 të datës 24 janar 2004, nenet 78 dhe 79 (c) ndryshuan si më poshtë:

#### Neni 78 – Vrasje me paramendim

“1. Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet.

2. Vrasja e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.”

**Neni 79: Vrasje me dashje për shkak të pozicionit të viktimës**

“Vrasja me dashje e kryer ndaj: ....

c) një deputeti, gjyqtari, prokurori, avokati, polici, ushtaraku, funksionari tjetër publik, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;

dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm”.

### **B. Kodi i Procedurës Penale**

99. Neni 50 § 1 konstaton se një avokat i ushtron të drejtat pasi ka rënë dakord me të pandehurin ligjërisht, nëse ligji nuk ia ka rezervuar këtë të drejtë vetëm të pandehurit. Sipas nenit 51 § 1 një avokat, me pëlqimin e të pandehurit, mund të caktojë një zëvendësues për aq kohë sa atij i ndalohej të ndjekë procesin gjyqësor.

100. Neni 151 § 3 i jep të drejtën gjykatës të mbledh të dhëna për të cilat nuk ka ndonjë parashikim ligjor rregullator, nëse ato shërbejnë për të vërtetuar faktet dhe nëse ato nuk kufizojnë vullnetin e lirë të individit.

101. Nenet 316-322 përcaktojnë se institucioni duhet të sigurojë të dhëna gjatë fazës së hetimit penal. Palët mund të kërkojnë që të sigurohen të dhënat, p.sh.: deklaratat e një dëshmitari, procesi i identifikimit, raporti i një eksperti, kur ka arsye të besohet se në të ardhmen ato nuk do të lejohen të mbledhin këto të dhëna.

Kërkesa duhet t'i dorëzohet me shkrim zyrës së regjistrimit të gjykatës. Sigurimi i këtyre të dhënave ndodh në seancën dëgjimore në prani të palëve.

102. Neni 375, siç ishte në fuqi në kohën kur u miratua vendimi i Gjykatës së Rrethit, përcaktonte se gjykata informon palët për një riklasifikim të ri ligjor që mund t'u bëjë fakteve, ndryshe nga ai i dhënë nga prokurori, nëse akti kriminal është brenda kompetencave të saj. Neni 375, i amenduar më 13 qershor 2002, përcakton se “në vendimin e saj përfundimtar, gjykata mund t'i japë faktit një riklasifikim (të ri) ligjor, të ndryshëm nga ai i bërë nga prokurori ..., më i butë apo më i ashpër, nëse akti kriminal është brenda kompetencave të saj”.

103. Sipas nenit 324 § 4, aktet hetuese të ndërmarra pas përfundimit të afatit kohor për të nxjerrë konkluzionet e hetimit penal, nuk mund të jenë të besueshme në procesin gjyqësor.

104. Neni 407 § 5 përcakton se në rast se është dorëzuar një apelim në gjykatën e gabuar, kjo e fundit duhet ta dërgojë te gjykata kompetente. Neni 413 § 1 përcakton se një apelim duhet të dorëzohet në zyrën e regjistrimit të gjykatës, e cila ka dhënë vendimin. Sekretari i gjykatës shënon në apelim, *inter alia*, datën e marrjes së tij. Sipas nenit 415 § 1 afati kohor për dorëzimin e një apelimi është 10 ditë. Afati kohor fillon që nga dita pas shpalljes së vendimit.

105. Sipas nenit 427, Gjykata e Apelit mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Në rast se njëra nga palët kërkon rishqyrtimin e fakteve të administruara gjatë procedurave të gjykatës së shkallës së parë, ose kërkon mbledhjen e të dhënave të reja shtesë, Gjykata e

Apelit, kur ta shikojë të arsyeshme, mund të vendosë të rihapë procedurat gjyqësore pjesërisht ose plotësisht (neni 427 § 1). Për aq fakte sa dolën në dritë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë; apo për aq fakte sa dolën në dritë gjatë procedurave të apelit, Gjykata e Apelit vendos t'i pranojë ato veç e veç (neni 427 § 2). Rishqyrtimi i çështjes mund të vendoset *ex officio* kur të shikohet e nevojshme (neni 427 § 3). Gjykata e Apelit mund t'i rishikojë faktet duke qenë se ankuesi nuk ishte i pranishëm gjatë procedurave të shkallës së parë, ose sepse nuk ishte njoftuar, ose sepse nuk ishte në gjendje t'i ndiqte ato procedura në mënyrë të ligjshme (neni 427 § 4).

106. Neni 509-511 do të merret në konsideratë gjatë procedurës për dërgimin e letër-porosive dërguar me anë të Ministrisë së Drejtësisë.

### **C. Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (“Konventa e Ndihmës së Ndërsjellë”)**

107. Konventa për Ndihmë të Ndërsjellë hyri në fuqi për Shqipërinë më 3 korrik 2000. Ajo përcakton rregulla të përbashkëta në fushën e ndihmës së ndërsjellë për çështjet penale, si për shembull, marrja në pyetje e dëshmitarëve apo e ekspertëve. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë janë bërë me anë të letër-porosive, të cilat duhet të dërgohen nga Ministria e Drejtësisë e palës që bën lutjen për te Ministria e Drejtësisë e palës së kërkuar.

### **D. Rekomandimi 1386 (1998) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës**

108. Vendimi në lidhje me çështjen interpretohet si më poshtë:

“5. Asambleja dënon ashpër vrasjen e parlamentarit të Partisë Demokratike, Azem Hajdarit dhe bodigardit të tij. Autoritetet duhet t'i vërtetojnë komunitetit ndërkombëtar se po bëjnë çdo përpjekje të nevojshme t'i nxjerrin përgjegjësit përpara drejtësisë sa më shpejtë të jetë e mundur dhe të lejojnë kryerjen e një hetimi të pavarur ndërkombëtar.

6. Më tej, Asambleja dënon ashpër dhunën politike të të dyja anëve, e cila erdhi menjëherë pas këtyre vrasjeve. Sulmet në institucionet demokratike të shtetit nuk mund të justifikohen në asnjë këndvështrim politik. Çdo përpjekje për të marrë pushtetin me forcë është qartësisht e papranueshme (...).”

### **LIGJI**

#### **I. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENEVE 5 §§ 1 DHE 2 TË KONVENTËS**

109. Ankuesi shprehu pakënaqësitë e tij sipas nenit 5 §§ 1(c) dhe 2, duke pretenduar se ndalimi i tij me burgim nuk ishte bazuar në dyshime të arsyeshme dhe se ai nuk ishte informuar siç duhej dhe mjaftueshëm për arsyet e arrestimit të tij. Neni 5 §§ 1 (c) dhe 2 të Konventës përshkruajnë si më poshtë:

“1. Çdo njeri ka të drejtën për të qenë i lirë dhe i sigurt. Asnjë nuk duhet të privohet nga liria e tij, me përjashtim të çështjeve të mëposhtme dhe në përputhje me një procedurë të përshkruar nga ligji:

c) arrestimi i ligjshëm ose ndalimi me arrest i një personi me arsyen për ta nxjerrë përpara autoritetit ligjor kompetent bazuar

mbi një dyshim të arsyeshëm për kryerjen e një krimi ose kur konsiderohet si i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një krimi apo arratisjen pasi është kryer krimi.

2. Çdo individ që arrestohet duhet të informohet me përpikëri, në gjuhën që ai kupton, për arsyet e arrestimit të tij dhe për çdo akuzë kundër tij.”

110. Gjykata përsërit se ajo “mund të merret vetëm me (një) çështje ... brenda një periudhe gjashtëmuajore nga data në të cilën është marrë vendimi përfundimtar” (shiko, midis të tjerave, *Alimuçaj kundër Shqipërisë*, nr. 20134/05, § 139, 7 shkurt 2012; dhe *Paul dhe Audrey Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vend.) nr. 46477/99, 7 qershor 2001).

111. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, gjykata vëren se ankuesi e kundërshtoi ndalimin e tij fillestar me burgim përpara autoriteteve vendase. Vendimi përfundimtar vendas, në lidhje me ato procedura, ishte vendimi i Gjykatës së Lartë më 9 shkurt 2001. Ankuesi paraqiti pakënaqësinë e tij në këtë Gjykatë më 20 korrik 2003. Doli si konkluzion se ankesa e tij u paraqit jashtë limitit kohor prej gjashtëmuajsh dhe duhej të kundërshtohej në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

## II. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6 §§ 1 DHE 3 TË KONVENTËS

112. Sipas nenit 6 § 1 të Konventës, ankuesi paraqiti një sërë ankesash. Fillimisht, ai u ankua se vendimet e gjykatave vendase nuk kishin mjaftueshëm arsye. Së dyti, ato gjykata kishin pranuar fakte, të cilat ishin përvetësuar në mënyrë të paligjshme, si për shembull, dëshmia e M. me anë të një lidhje me video. Së treti, bankës së Gjykatës së Rrethit, ashtu si edhe bankës së Gjykatës së Lartë më datë 14 shkurt 2003, i mungonte paanshmëria. Ai theksoi faktin se apelimi i tij i datës 9 nëntor 2001 ndaj Gjykatës së Lartë nuk u shqyrtua kurrë.

113. Gjithashtu, ankuesi pretendonte për shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 6 § 3 (a) dhe (d). Ai u ankua se nuk ishte njoftuar siç duhet për akuzat kundër tij dhe se avokatit të tij nuk iu dha mjaftueshëm kohë për të studiuar dosjen e hetimit. Ai nuk kishte akses në të gjitha dokumentet në dosje dhe veçanërisht, në deklaratën e A.L. të datës 8 maj 2001. Nuk u caktua asnjë avokat *ex officio* për ta mbrojtur atë në seancën dëgjimore të datës 29 tetor 2001, kur M. dha dëshminë e tij në procesin gjyqësor. Gjykatat vendase e kishin ndryshuar riklasifikimin e akuzave pa i dhënë mundësinë të bënte komente mbi to. Gjykata e Apelit shqyrtoi dhe hodhi poshtë apelimin e tij të datës 29 tetor 2001 në mungesë të tij. Deklarata e dëshmitarit Ç. u sigurua me nxitim, pa i dhënë ankuesit kohën e nevojshme ta rishqyrtonte atë dëshmi dhe të dorëzonte komentet përkatëse. Kërkesat e tij për raporte shtesë nga ekspertët dhe dëshmitarë të tjerë në procesin gjyqësor u hodhën poshtë pa të drejtë.

114. Neni 6 §§ 1 dhe 3 (a) dhe (d) interpretohen si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundër tij, çdo njeri ka të drejtën për një seancë dëgjimore ... të drejtë ... nga (një) tribunali ...”

3. Çdo njeri i akuzuar për një krim ka të drejtat minimale të mëposhtme:

a) të informohet me përpikëri, në një gjuhë që ai e kupton dhe me detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzave kundër tij;

b) të ketë kohën dhe mjetet e nevojshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) ta mbrojë vetveten personalisht ose me anë të ndihmës ligjore të zgjedhur nga vetë ai, ose nëse nuk ka mjetet e nevojshme të paguajë për asistencë ligjore, kjo e fundit t'i ofrohet falas kur e kërkojnë interesat e drejtësisë;

d) të shqyrtojë apo të ketë shqyrtuar provat kundër tij, si edhe të ndjekë dhe shqyrtojë dëshmitë në interes të tij në të njëjtat kushte, si edhe dëshmitë kundër tij.”

### A. Pranueshmëria

115. Qeveria parashtroi se pakënaqësitë e ankuesit për riklasifikimin e akuzave penale duhej të hidhen poshtë ose për mungesë shfrytëzimi të kompensimeve vendase ose për faktin se janë të pabaza.

116. Gjykata përsërit se ankuesit janë të detyruar të shfrytëzojnë kompensimet vendase, të cilat janë të disponueshme në teori dhe në praktikë, në kohën përkatëse, të cilat ata mund t'i krijojnë vetë – që do të thotë, kompensimet, që janë të arritshme, mund të ndihmojnë për sa u përket ankesave të tyre, si edhe të ofrojnë perspektiva për sukses (shiko, për shembull, *Sejdovic kundër Italisë*, nr. 56581/00, § 46, 1 mars 2006).

117. Në këtë rast, Gjykata vëren se J.M., njëri nga të bashkëpaditurit, apeloj pa pasur sukses në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën Kushtetuese, për riklasifikimin, e pretenduar të ishte i paligjshëm, të akuzave penale (shiko paragrafët 82 dhe 94 më sipër). Në lidhje me fatin e apelimit të të bashkëpandehurit të tij, Gjykata mendon se e njëjta ankesë e shprehur nga ankuesi nuk do të kishte pasur perspektiva të arsyeshme për sukses (shiko, gjithashtu, *Laska dhe Lika kundër Shqipërisë*, nr.12351/04 dhe 17605/04, § 47, 20 prill 2010). Për këtë arsye, gjykata e rrëzon këtë kundërshtim. Ajo nuk mendon se kjo ankesë është e pabazë apo e pranueshme në çdo këndvështrim. Prandaj, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

118. Në lidhje me pjesën e mbetur të pretendimeve të ankuesit për padrejtësi, Gjykata mendon se ato nuk janë të pabaza, në bazë të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke qenë se nuk janë të papranueshme, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

### B. Cilësitë

#### 1. Bindjet e palëve

##### a) Ankuesi

119. Ankuesi pretendon se nuk është njoftuar me përpikëri për akuzat kundër tij. Ai nuk pati kohën e duhur të studionte dosjen voluminoze të çështjes, e cila i

ishte dorëzuar në procesin gjyqësor. Disa të dhëna, si për shembull, deklaratat e A.L. e datës 8 maj 2001, nuk iu dorëzua. Gjykata kishte pranuar fakte të paligjshme, si për shembull, deklaratat e dëshmitarëve Ç. dhe M. Ligji vendas përfshinte marrjen dhe pranimin e të dhënave nga lidhja me video e dëshmitarit M., të cilit i ishte bërë presion nga autoritetet të dëshmonte në shkëmbim të përjashtimit të tij nga përgjegjësitë penale. Disa nga kërkesat e tij për masa procedurale ishin kundërshtuar nga gjykata pa asnjë arsye. Duke mos mundur të caktonte një avokat *ex officio*, gjykata nuk i siguroi të drejtën e mbrojtjes në seancën dëgjimore të 29 tetorit 2001, në të cilën M. u dëgjua me anë të një lidhje me video. Edhe kjo ishte pranuar nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj të datës 14 shkurt 2003.

120. Asnjë nga dëshmitarët, të cilët dëshmuuan përpara gjykatës, nuk e kishte akuzuar për pjesëmarrje në krim. Gjatë gjithë procedurave, ankuesi pohoi pafajësinë e tij. Prokurori nuk pretendoi asnjëherë se ishte në dijeni të lëvizjeve të njerëzve të tjerë të përfshirë në realizimin e krimit. Gjykatat vendase nuk kishin dhënë arsye të përshtatshme për përfundimin e tyre se ankuesi kishte kërkuar hakmarrje kundër deputetit. Deri në arrestimin e tij, ankuesi vazhdoi të punonte si anëtar i stafit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke shërbyer në policinë e trafikut.

121. Ankuesi pohoi se kishte dorëzuar një apelim kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 29 tetor 2001, siç edhe konfirmohet nga data dhe vula në apelim. Zyra e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit ishte e detyruar ta transmetonte apelimin te zyra e regjistrimit të Gjykatës së Apelit, sipas nenit 407 § 5 të KPP-së. Nëse apelimi i tij do të ishte dorëzuar në shkelje me nenin 413 § 1 të KPP-së, Gjykata e Lartë do të duhej të kishte marrë një vendim në përputhje me nenet 112 § 1 dhe 433 § 2 të KPP-së.

#### b) Qeveria

122. Qeveria pretendon se ankuesi u informua me përpikëri dhe në mënyrën e duhur për akuzat që rëndonin mbi të. Kërkesa e avokatit të tij për më shumë kohë për të studiuar padinë, u përmbush nga gjykata. Ndërsa një nga disa kërkesat e tij u përmbushën nga gjykatat vendase, kërkesa për realizimin e raporteve eksperte u kundërshtua, sepse përfshirja e tij në krim as që nuk vihej në dyshim. Rrëfimet e dëshmitarëve Ç. dhe M. u përvetësuan në përputhje me ligjin vendas. Ankuesi u largua nga salla e seancës dëgjimore, më 29 tetor 2001, vullnetarisht dhe pohoi se “asnjë nuk guxon të marrë përsipër mbrojtjen time”. Si përgjigje të kërkesës së gjykatës për të siguruar një avokat *ex officio*, Shoqata Shqiptare e Avokatisë nuk e kishte të mundur ta përmbushte kërkesën, duke pasur parasysh kufizimet e parashtruara nga nenet 49 § 6 dhe 51 § 1 të KPP-së. I përballur me këto kufizime dhe detyrimin për

të realizuar një proces gjyqësor brenda një afati kohor të arsyeshëm, gjykata vendosi të procedonte me seancën dëgjimore.

123. Pakënaqësitë e ankuesit kishin të bënin me vlerësimin e të dhënave, çka i përkiste gjykatave vendase. Ai vlerësim nuk përmbante elemente të arbitraritetit apo të paarsyeshmërisë për sa ka të bëjë me dënimin e ankuesit. Gjykatat vendase kishin para tyre mjaftueshëm të dhëna, të cilat konfirmonin përfshirjen e ankuesit në realizimin e krimit.

124. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, apelimi i ankuesit në Gjykatën e Lartë nuk përputhej me kërkesat e nenit 413 § 1, sepse ai ishte dorëzuar në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit, në vend që të dorëzohej në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Apelit. Ndërsa gjykata e rrethit nuk kishte asnjë detyrim t’ia transmetonte apelimin Gjykatës së Apelit, në përputhje me nenin 415 § 1 të KPP-së, apelimi ishte dorëzuar jashtë afatit kohor të përcaktuar. Ky fakt shpjegon se përse nuk iu transmetua apelimi i ankuesit Gjykatës së Lartë.

#### 2. Vlerësimi i Gjykatës

125. Duke qenë se garancitë në paragrafin 3 të nenit 6 janë aspekte specifike të së drejtës për një proces gjyqësor të drejtë, siç parashikohet edhe në paragrafin 1, Gjykata do të shqyrtojë pakënaqësitë e ankuesit, në përputhje me të dy parashikimet të marra së bashku (shiko, *inter alia*, A.S. kundër Finlandës, nr. 40156/07, § 47, 28 shtator 2010).

126. Gjykata thekson se ndikimi i nenit 6 § 1 është, *inter alia*, për ta vendosur një “tribunal” përpara përgjegjësisë të realizojë shqyrtimin e duhur të materialeve, argumenteve dhe të dhënave të parashtruara, pa pasur paragjykime për vlerësimin e tyre, apo nëse ato janë të përshtatshme për vendimin e saj, duke pasur parasysh se Gjykata nuk mblidhet për të shqyrtuar nëse argumentet janë shqyrtuar në mënyrën e duhur (shiko *Perez kundër Francës*, nr. 47287/99, § 80, GJEDNJ 2004-I, dhe *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, § 63, 24 maj 2005). Megjithëse neni 6 § 1 kërkon nga gjykatat që ato të japin arsye për vendimet e tyre, kjo nuk do të thotë se duhet dhënë një përgjigje e detajuar për çdo argument (shiko *Van de Hurk kundër Holandës*, 19 prill 1994, § 59, seria A, nr. 288, dhe *Burg kundër Francës* (vend.), nr. 34763/02, GJEDNJ 2003-II). Shtrirja e kësaj përgjegjësie për të dhënë arsye mund të variojë sipas natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet sipas rrethanave të çështjes (shiko *Ruiz Torija kundër Spanjës*, 9 dhjetor 1994, § 29, seria A nr. 303-A, dhe *Helle kundër Finlandës*, 19 dhjetor 1997, § 55, raportet për gjykimet dhe vendimet 1997-VIII).

127. Parashikimet e paragrafit 3 (a) të nenit 6 përqendrohen te nevoja për vëmendje të veçantë ndaj njoftimit për “akuza” ndaj të pandehurit. Detajet e

krimit luajnë një rol të rëndësishëm në procesin penal, duke qenë se nga momenti i paraqitjes së tyre, i dyshuari njoftohet me shkrim për bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (shiko *Kamasinski kundër Austrisë*, vendim i datës 19 dhjetor 1989, seria A, nr. 168, p. 36-37, § 79). Neni 6 § 3 (a) i Konventës i jep të pandehurit të drejtën të informohet jo vetëm për shkakun e akuzave, që do të thotë për veprimet të cilat pretendohen të jenë kryer nga ai dhe mbi të cilat bazohet akuza, por edhe për cilësinë ligjore të atyre akteve. Ky informacion duhet të jetë i detajuar (shiko *Pélissier dhe Sassi kundër Francës*, [GJP], nr. 25444/94, § 51, GJEDNJ 1999-II). Gjithashtu, objekti dhe qëllimi i nenit 6 §§ 1 dhe 3 tregojnë se një person i akuzuar për një krim “ka të drejtën të marrë pjesë në një seancë dëgjimore dhe të dëgjohet” në praninë e tij nga një “tribunal” (shiko, midis të tjerave, *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, 6 dhjetor 1988, §§ 68 dhe 78, seria A nr. 146).

128. Ndërsa neni 6 garanton të drejtën për një seancë dëgjimore, ai nuk anashkalon ndonjë nga rregullat për pranueshmërinë e të dhënave si të tilla, çka kryesisht është një çështje për t'u marrë parasysh nga ligji vendas (shiko *Schenk kundër Zvicrës*, 12 korrik 1988, §§ 45-46, seria A, nr. 140; *Teixeira de Castro kundër Portugalisë*, 9 qershor 1998, § 34, raportet 1998-IV; dhe *Jalloh kundër Gjermanisë*, [GJP], nr. 54810/00, §§ 94-96, GJEDNJ 2006-IX). Për këtë arsye, nuk është roli i Gjykatës të përcaktojë, për çështje parimi, nëse lloje të caktuara faktesh, për shembull, marrja e fakteve në mënyrë të paligjshme – mund të jenë të pranueshme. Pyetja së cilës mund t'i përgjigjemi është nëse procedurat në total, duke përfshirë edhe mënyrën në të cilën janë siguruar faktet, ishin të drejta (shiko, midis autoriteteve të tjera, *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, § 34, GJEDNJ 2000-V; *P.G. dhe J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 76, GJEDNJ 2001-IX; *Bykov kundër Rusisë*, [GJP], nr. 4378/02, § 89, GJEDNJ 2009-...; dhe *Gäfgen kundër Gjermanisë* [GJP], nr. 22978/05, §163, GJEDNJ 2010-...).

129. Në përcaktimin nëse procedurat në tërësi ishin të drejta, duhej t'i ishte kushtuar vëmendje nëse ishin respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet shqyrtuar nëse ankuesit i është dhënë mundësia të kundërshtonte vërtetësinë e fakteve dhe përdorimin e tyre (shiko *Gäfgen*, të cituar më sipër, § 164). Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë cilësia e të dhënave, duke përfshirë nëse rrethanat në të cilat ato u morën hedhin dyshime mbi besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Ndërkohë që nuk ngrihet asnjë problem drejtësie nëse faktet e marra ishin të pambështetura nga materiale të tjera, mund të vihet re se aty ku të dhënat janë shumë të forta, nuk kanë rrezik të jenë të pabesueshme dhe nevojta për të dhëna mbështetëse është më e vogël

(shiko, *mutatis mutandis*, *Khan*, §§ 35 dhe 37, *Allan*, § 43, dhe *Bykov*, § 90, të gjithë të cituar më sipër).

130. Gjykata do të shqyrtojë me radhë arsyet për pakënaqësitë e ankuesit, sipas kërkesës së përgjithshme për drejtësi të nenit 6 të Konventës.

#### a) Shpallja e akuzës

131. Gjykata shpjegon se ankuesi u arrestua më 22 janar 2001. Urdhri i arrestit përcakton qartë akuzat penale që ngrihen kundër tij. Më 23 janar 2001, ankuesi u informua plotësisht për akuzat kur u pyet nga prokurori. Në seancën dëgjimore të datës 24 janar 2001, për miratimin e arrestimit të tij dhe në prani të avokatit të zgjedhur prej tij, ai bëri deklaratat në lidhje me akuzat dhe ngjarjet që u përmendën. Për këtë arsye, gjykata mendon se ankuesi është njoftuar në mënyrën e duhur për akuzat kundër tij. Ajo shpjegon se bërja me dije për akuzën nuk duhet të pasohet nga shpallja e të dhënave mbështetëse, në mënyrë që i pandehuri të përgatitet për procesin gjyqësor (shiko *Brozicek kundër Italisë*, 19 dhjetor 1989, § 42, seria A nr. 167). Ekzistenca e fakteve të tilla mund të varet nga rezultatet e hetimit në vijimësi.

#### b) Organizimi i procedurave gjyqësore

##### i) Parashikimi i kohës së duhur

132. Pas njohjes me padinë, më 13 mars 2001, avokati i ankuesit pati mundësinë për të përdorur dosjen voluminoze të hetimit deri më 16 mars 2001. Në seancën dëgjimore më 3 prill 2001, gjykata pranoi kërkesën e avokatit për të zgjatur kohën e nevojshme për të shqyrtuar dosjen e çështjes. Në dosjen e çështjes nuk ka asnjë tregues se ankuesi kërkonte kohë shtesë.

##### ii) Ndjekja e seancave dëgjimore në procesin gjyqësor

133. Gjykata kujton se as letra dhe as natyra e nenit 6 të Konventës nuk e pengon personin të heq dorë me vullnetin e tij të lirë, qoftë në formën e shprehur qartësisht me fjalë ose me nënkuptime, nga e drejta që i garanton një proces gjyqësor të drejtë. Megjithatë, nëse bëhet efektive për arsye të Konventës, një dorëheqje e tillë ndërmerret në mënyrë të padyshimtë dhe shoqërohet nga minimumi i rojeve të sigurisë në përpjesëtim me rëndësinë e saj (shiko *Hermi kundër Italisë* [GJP], nr. 18114/02, § 73, GJEDNJ 2006-XII). Në këto rrethana, Gjykata shpjegon se ankuesi në mënyrë të padyshimtë dhe të lirë hoqi dorë nga e drejta e tij për të ndjekur seancën dëgjimore të datës 29 tetor 2001 ose për t'u përfaqësuar nga një avokat *ex officio*, në kohën kur M. u dëgjua me anë të një lidhje me video; ndërkohë avokati i zgjedhur prej tij u ndalua të ndiqte atë seancë dëgjimore.

##### iii) Marrja në pyetje e dëshmitarëve

134. Për sa ka të bëjë me parregullsitë e pretenduara në lidhje me pranimin e dëshmisë së Ç. dhe M., Gjykata shpjegon se gjykatat vendase i hodhën poshtë ato dëshmi si kontradiktore dhe me mungesë në besueshmëri, dhe nuk u bazuan në to.



135. Rezulton se deklarata e A.L., e datës 8 maj 2001, fillimisht nuk u paraqit para mbrojtjes. Megjithatë, çdo padrejtësi e shkaktuar nga ky veprim u shlye nga gjykata, e cila u siguroi që A.L. të dëshmonte. Ankuesi dhe avokati i tij ndoqën seancën dëgjimore, e ripyetën A.L dhe kundërshtuan ta përdornin dëshminë e tij.

*iv) Përfaqësimi nga një avokat*

136. Në të gjitha fazat e procesit gjyqësor, ankuesi u përfaqësua nga një avokat, i zgjedhur prej tij, ndoqi pothuajse të gjitha seancat dëgjimore të lidhura me çështjen, pati mundësinë të dorëzonte fakte dhe të merrte në pyetje një sërë dëshmitarësh.

**c) Organizimi i procedurave të apelit**

*i) Riklasifikimi i krimit*

137. Gjatë vlerësimit të drejtësisë së ushtruar në tërësinë e procedurave penale, Gjykata pranoi se riklasifikimi i një krimi nuk shkelte të drejtat e mbrojtjes, nëse i pandehuri ka pasur mjaftueshëm mundësi të mbrojtë veten, gjatë procedurave të rishqyrtimit (shiko *Dallos kundër Hungarisë*, nr. 29082/95, §§ 47-53, 1 mars 2001; dhe *Sipavičius kundër Lithuanisë*, nr. 49093/99, § 30, 21 shkurt 2002). Në çështjen konkrete, ankuesi e kundërshtoi dënimin e tij dhe riklasifikimin, përpara Gjykatës së Apelit, gjykatë, e cila është kompetente për t'u marrë me këtë çështje. Edhe Gjykata e Lartë shqyrtoi apelin e ankuesit kundër dënimit të tij, me arsye për të riformuluar akuzën. Gjithashtu, ajo shqyrtoi edhe apelin e të bashkëpandehurve të tij në lidhje me riklasifikimin e krimit. Ajo gjykatë ishte në gjendje t'i ofronte lehtësim të ankuarit dhe bashkëpandehurit të tij (shiko paragrafin 89 më sipër), por mbi baza të arsyeshme, ajo i kundërshtoi kërkesat e paraqitura.

138. Prandaj, Gjykata mendon se duke pasur parasysh faktet e çështjes, veçanërisht materialet e paraqitura së fundmi nga prokurori në procesin gjyqësor, siç parashtrahet edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit (shiko paragrafin 70 më sipër), nuk mund të thuhet se ankuesi nuk mund ta studionte riklasifikimin e akuzës penale kundër tij. Ankuesi pati kohën dhe lehtësirat e duhura, për të përgatitur mbrojtjen e tij ndaj akuzës së riformuluar dhe, në fakt, ai e paraqiti përpara Gjykatës së Apelit mbrojtjen e tij për akuzën e riformuluar. Në këtë këndvështrim, kjo çështje dallon nga çështja *Pélissier dhe Sassi*, ku Gjykata e Kasacionit nuk e rishqyrtoi "maturinë" e Gjykatës së Apelit në riklasifikimin e akuzës.

*ii) Pamundësia e Gjykatës së Lartë për të shqyrtuar apleimin interlokutor të ankuesit, më 9 nëntor 2001, në lidhje me mungesën e paanshmërisë së Gjykatës së Rrethit*

139. Nga dokumentet në dosjen e çështjes rezulton se më 9 nëntor 2001, ankuesi dorëzoi një apelim interlokutor kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 29 tetor 2001. Apeli ishte dorëzuar në zyrën e regjistrimit të Gjykatës së Rrethit. Më 14 janar 2002, ankuesi i kërkoi Gjykatës së Rrethit të merrte informacion në lidhje me

fatin e këtij apeli. Ai u informua se Gjykata e Lartë nuk kishte kërkuar transferimin e dosjes së çështjes për shqyrtim.

140. Më 5 gusht 2002, ankuesi e ngriti këtë pakënaqësi në Gjykatën e Lartë në apelin kundër dënimit të tij. Më 14 shkurt 2003, Gjykata e Lartë pranoi se kishte një kopje të apelit të ankuesit, të datës 9 nëntor 2001, në dosjen e çështjes, por apeli nuk përputhej me kërkesat përkatëse ligjore.

141. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se mos shqyrtimi i apelit interlokutor të ankuesit, i datës 9 nëntor 2001, i ishte dorëzuar Gjykatës së Lartë më 5 gusht 2002, e cila, megjithëse me vonesë, e shqyrtoi atë dhe konstatoi se nuk plotësonte kërkesat e nevojshme ligjore. Për më tepër, nën dritën e të gjitha materialeve në zotërim, Gjykata konstaton se nuk ka asnjë shenjë të paanshmërisë nga ana e bankës së Gjykatës së Rrethit.

*iii) Parashikimi i arsyeve të duhura (adekuate)*

142. Dënimi i ankuesit u bazua në deponimet e dëshmitarëve A.L, K.G. dhe J.M., edhe pse asnjëri prej tyre nuk e akuzoi ankuesin drejtpërsëdrejti për goditjet me armë, gjykatat vendase arsyetuan se, në bazë të atyre deponimeve, por edhe bazuar në të dhënat e mbledhura nga rrethanat, provohet pjesëmarrja në krim e ankuesit në rolin e ndihmësit (shiko paragrafët 69, 72 dhe 80 më sipër). Gjykata kujton se përdorimi i të dhënave indirekte apo rrethanore nuk përjashtohet nga neni 6 (shiko, për shembull, *Cesky dhe Koti kundër Republikës Çeke* (vend.), nr. 76800/01, 76801/01, 7 prill 2009; *Alberti kundër Italisë*, nr. 12013/86, vendim i Komisionit i datës 10 mars 1989; dhe, *mutatis mutandis*, *Andandonskiy kundër Rusisë*, nr. 24015/02, § 52, 28 shtator 2006).

143. Gjykata e Apelit rihapi shqyrtimin gjyqësor dhe plotësoi disa nga kërkesat e ankuesit, por kundërshtoi pjesën e mbetur të tyre. Kështu, Gjykata vëren se gjykatat vendase e vlerësojnë maturinë për sa ka të bëjë me pranimin e të dhënave. Atyre nuk mund t'iu referohemi për kundërshtim të kërkesave të ankuesit, nëse ato kanë gjykuar se kanë pasur mjaftueshëm të dhëna për të gjykuar këtë çështje.

144. Mund të argumentohet se të tjera masa hetuese ishin të nevojshme për të provuar fajësinë e ankuesit. Megjithatë, Gjykata nuk mund të spekulonte për përfundimet e procesit gjyqësor në këtë aspekt. Është e sigurt se grupi i të dhënave kundër ankuesit u bë subjekt i procedurave kundërshtuese, të cilat garantonin respekt për të drejtat e mbrojtjes në çdo fazë të procedurave të apelit.

**d) Përfundim**

145. Duke pasur parasysh pikat e mësipërme, Gjykata mendon se procedurat vendase, të para në tërësi, nuk shfaqin ndonjë element të padrejtësisë procedurale. Për këtë arsye nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d) të Konventës.

### III. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 2 TË KONVENTËS

146. Ankuesi shprehu pakënaqësinë se dëshmia e ministrit të Drejtësisë së asaj kohe, i cili la të kuptohej se ankuesi ishte fajtor, theu mundësinë për pafajësi, siç garantohej nga neni 6 § 2 i Konventës. Për më tepër, gjykatat vendase e konsideruan atë fajtor bazuar në deponimet e dëshmitarëve M. dhe A.L., të cilat u konsideruan kontradiktore dhe të pabesueshme. Neni 6 § 2 i Konventës interpretohet si më poshtë:

“2. Çdo individ i akuzuar për një krim, presupozohet të jetë i pafajshëm deri sa të provohet që është fajtor sipas ligjit.”

147. Qeveria parashtroi idenë se kjo ankesë duhet të kundërshtohet për mospërdorim të kompensimeve vendase.

148. Gjykata i referohet parimit të përgjithshëm në paragrafin 116 më sipër, i cili ka të bëjë me kërkesën për përdorimin e lehtësirave vendase.

149. Pasi shqyrtoi apelimin e ankuesit, Gjykata vëren se ankuesi nuk e paraqiti ankesën e tij, të paktën në substancë, përpara gjykatave vendase. Për këtë arsye, ajo kundërshton pakënaqësinë e ankuesit për mos shfrytëzim të kompensimeve vendase në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

### IV. PRETENDIME PËR SHKELJE TË NENIT 7 TË KONVENTËS

150. Ankuesi shprehu pakënaqësinë, sipas nenit 7 të Konventës, se ai ishte dënuar në bazë të një parashikimi penal, i cili nuk ekzistonte në kohën kur u krye krimi. Neni 7 pohon si më poshtë:

“1. Asnjë nuk do të shpallet fajtor për kryerjen e një krimi, nëse ka të bëjë me një veprim apo përjashtim, të cilët nuk përbëjnë krim sipas ligjit vendas apo të huaj, në kohën kur ai është kryer. Gjithashtu, nuk do të jepen dënime më të rënda se sa ato që janë në fuqi në kohën kur ndodh krimi.

2. Ky nen nuk paragjykon as procesin gjyqësor dhe as dënimin e një personi për çdo akt, i cili në kohën kur është kryer ishte penal sipas parimeve të përgjithshme të ligjit të njohur nga kombet civile.”

151. Gjykata kërkoi që kjo ankesë të kundërshtohet për mosshfrytëzim të kompensimeve vendase.

152. Pasi shqyrtoi apelimet e ankuesit, Gjykata vëren se ankuesi nuk e ngriti pakënaqësinë e tij, të paktën në substancë, përpara gjykatave vendase. Prandaj ajo kundërshton ankesën e ankuesit për mosshfrytëzim të kompensimeve vendase në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. Në mënyrë unanime, i deklaron ankesat sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d), për sa ka të bëjë me pretendimin për padrejtësi procedurale të procedurave, të pranueshme dhe pjesën e mbetur të aplikimit të papranueshëm;

2. Vendos, me numër votash gjashtë me një, se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d) të Konventës.

E hartuar në anglisht dhe e mbajtur me shkrim, më 8 tetor 2013, sipas nenit 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Françoise Elens-Passos**  
SEKRETARE

**Ineta Ziemele**  
PRESIDENTE

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe rregulli 74 § 2 i rregullores së Gjykatës, opinioni i veçantë i gjykatësit De Gaetano, është aneksuar në këtë vendim.

I.Z.

F.E.P.

### VENDIMI HAXHIA KUNDËR SHQIPËRISË – OPINIONE TË VEÇANTA

#### OPINIONI PJESËRISHT KONTRADIKTOR I GJYKATËSIT DE GAETANO

1. Më vjen keq që në këtë çështje unë nuk ndaj opinionin e shumicës, e cila pretendon se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 § 1.

2. Çështja kundër ankuesit u mbështet tërësisht në të dhënat rrethanore. Është i rëndomtë fakti se të dhënat rrethanore nuk gënjejnë, por mund të mashtrjnë. Gjithashtu, në përgjithësi, dihet se të dhënat rrethanore funksionojnë ku janë të gjitha bashkë, në progresion gjeometrik, duke eliminuar mundësitë e tjera. Për këtë arsye, ato nuk duhet të interpretohen vetëm në mënyrë të ngushtë, por edhe të shqyrtohen imtësisht. Për më tepër, në çështjen në fjalë, ankuesi nuk është akuzuar si drejtuesi, por si ndihmësi ose bashkëpunëtori. Prandaj, pika kritike ishte nëse mund të tregohej se të dhënat rrethanore përcaktonin në mënyrë të përmbledhur ekzistencën e një plani të përbashkët – *idem placitum consensus* – midis ankuesit dhe drejtuesit apo drejtuesve.

3. Edhe pse kjo çështje ligjore e Gjykatës, në përputhje me nenin 6, ka përsëritur vazhdimisht se nuk është një gjykatë e shkallës së katërt për rishqyrtimin e fakteve të çështjes, ajo shprehet se edhe pse një vendim mund të mos jetë arbitrar për shkak të mungesës së plotë të arsyeve, përsëri, ajo mund të mos ketë mjaftueshëm arsye sipas rrethanave të caktuara të çështjes, dhe për pasojë mund të shkelë nenin 6 § 1. Kështu, kur një koncepti ligjor i mungon precizioni, çka përfshin një vlerësim të pyetjeve rreth fakteve; një gjykatë mund t'i kërkohej të japë më shumë arsye të detajuara, veçanërisht nëse përfundimi ka një natyrë vendimtare (shiko, midis të tjerëve, *Georgiadis kundër Greqisë*, nr. 21522/93, 29 maj 1997, në veçanti § 43). Po kështu, një gjykatë, edhe pse mund të japë arsye, mund t'i shmangë vështirësitë e çështjes (*Kuznetsov dhe të tjerët kundër Rusisë*, nr. 184/02, 11 janar 2007, § 84); ose gjykata vendase mund të injorojë një pikë “të caktuar”, të rëndësishme lidhur me çështjen (*Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, 18 korrik 2006), edhe nëse arsyet janë dhe në përputhje me të tjera çështje.

4. Unë nuk gjej asnjë gjë në vendimin madhor, që të tregojë, ose të paktën të sugjerojë, se u dhanë mjaftueshëm arsye nga Gjykata e Rrethit apo nga Gjykata e Apelit, për të mbështetur faktet e tyre për një plan të përbashkët, midis ankuesit dhe drejtuesit apo drejtuesve (Gjykata e Lartë nuk pranoi të shqyrtojë ankesën të lidhur me mungesën e arsyeve adekuate, duke qenë se nuk ishin në kompetencën e saj, shiko § 91). Përkundrazi, kjo çështje kritike për një plan të përbashkët nuk i përkiste këtyre dy gjykatave. Vetëm kjo, mund të mjaftojë si element që dhunon nenin 6 § 1.

5. Por ka edhe më shumë. Çështja e ankuesit ishte e një profili të lartë kundër një skene trazirash politike. Mendimi praktik do të donte që gjykatat që merren me procedurat juridike, në të tilla rrethana, do të bënin mjaft kujdes, për të mos krijuar asnjë hije dyshimi për procedurat përkatëse. Përkundrazi, në rastin tonë konkret, apelimi i ankuesit në Gjykatën e Lartë për vendimin e Gjykatës së Apelit, më 29 tetor 2001 (për pretendimin për mungesë paanshmërie nga ana e gjykatës së rrethit) nuk u shqyrta kurrë nga kjo Gjykatë e Lartë, duke krijuar në dukje një gabim administrativ (shiko §§ 75-77, 87, 121 dhe 124). Apelimi i ankuesit në Gjykatën e Apelit duket të jetë zgjidhur me zell të madh (shiko në veçanti §§ 79-80). Apelimi në Gjykatën Kushtetuese u deklarua i papranueshëm pa dhënë asnjë arsye. Kështu, mbetet ende dyshim.

4. Për të gjitha këto arsye, sipas këndvështrimit tim, ka pasur një shkelje të nenit 6 § 1.

**SEKSIONI I KATËRT**  
**ÇËSHTJA MULOSMANI KUNDËR SHQIPËRISË**  
(Ankimi nr. 29864/03)

**VENDIM**  
**STRASBURG**  
8 tetor 2013

*Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.*

**Në çështjen Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë,** Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt i Mëparshëm), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Ineta Zieme, *president*  
David Thór Björgvinsson,  
George Nicolaou,  
Zdravka Kalaydjieva,  
Vincent A. De Gaetano,  
Paul Mahoney, *gjykatës,*  
Markelian Koca, *gjykatës ad hoc,*  
dhe Françoise Elens-Passos, *regjistruer i Seksionit,*  
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 17 shtator 2013, shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:

**PROCEDURA**

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 29864/03) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga shtetasi shqiptar, z. Jaho Mulosmani ("ankuesi"), më 4 korrik 2003.

2. Ankuesi u përfaqësuan nga z. V. Meçi, avokat që ushtron profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua nga agentja e atëhershme e saj, znj. S. Mëneri e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri dhe, më pas, nga znj. L. Mandia nga zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, gjykatës i zgjedhur për Shqipërinë, u tërhoq nga gjykimi i çështjes (neni 28). Rrjedhimisht, Qeveria caktoi z. Markelian Koça si gjykatës *ad hoc* në vend të tij (neni 27 § 2 e Konventës dhe neni 29 § 1 në fuqi në atë kohë).

4. Ankuesi pretendoi disa shkelje sipas nenit 6 dhe 7 të Konventës.

5. Më 28 mars 2006, Dhoma e Seksionit të Katërt, së cilës i është caktuar çështja, vendosi të njoftonte Qeverinë mbi ankimin. Gjithashtu, u vendos të shqyrtohej pranueshmëria dhe meritat e ankimit në të njëjtën kohë (neni 29 § 1).

**FAKTET**

**I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1977 dhe aktualisht vuan dënimin me burgim të përjetshëm. Në kohën e ngjarjeve të përshkruara më poshtë, ankuesi ishte shefi i rendit në Komisaratin e policisë së Bajram Currit, një qytet në verilindje të Shqipërisë.

**A. Vrasja e anëtarit të Parlamentit**

7. Më 12 shtator 1998, rreth orës 21:15, z. Azem Hajdari, anëtar parlamenti ("AP"), dhe truprojat e tij, B.C. dhe Z. N. u qëlluan ndërkohë që po dilnin nga selia e Partisë Demokratike ("PD") në Tiranë. Zoti Hajdari dhe B.C. vdiqën në të njëjtën ditë në spital. Truproja e dytë, Z.N. u plagos rëndë.

8. Zoti Hajdari ishte anëtar drejtues i PD-së, e cila ishte një nga dy partitë kryesore politike në Shqipëri dhe, në kohë materiale, në opozitë.

9. Menjëherë pas vrasjes, z. Sali Berisha, kryetar i atëhershëm i PD-së dhe një personalitet i mirënjohur publik, u prononcua direkt duke akuzuar ankuesin si autorin e krimit. Dukej se deklarata zyrtare për shtyp lëshuar nga PD-ja, në orën 23:00 në të njëjtën ditë deklaronte se ankuesi ishte identifikuar si vrasësi. Gjykatës nuk i është paraqitur asnjë kopje e deklaratës për shtyp.

10. Vrasja e z. Hajdari shkaktoi një rritje të shpejtë tensionesh dhe më 13 shtator 1998, protestuesit sulmuan ndërtesën e Kryeministrit.

11. Dhunë e mëtejshme shpërtheu në Tiranë gjatë funeralit të të ndjerit. Më tej, vijoi revoltë e

përgjithshme, gjatë së cilës, njerëz të armatosur pushtuan menjëherë zyrat e televizionit shtetëror, parlamentit dhe ndërtesave të tjera të mëdha.

12. Situata në Shqipëri iu nënshtrua rekomandimit nr. 1386 (1998) të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, në të cilin Asambleja dënonte fuqishëm dhunën politike që vazhdoi pas vrasjes (shih paragrafin 109 më poshtë).

#### **B. Hetimi penal i vrasjes**

13. Më 13 shtator 1998, ankuesi pati një intervistë telefonike me ministrin e Brendshëm të atëhershëm për vrasjen. Ai deklaroi se nuk ishte përfshirë në vrasje dhe ishte në dispozicion të autoriteteve për çdo informacion të mëtejshëm. Biseda u regjistrua nga Televizioni Shqiptar ("TVSH"), por kasetja u zhduk gjatë ditëve në vijim. Në të njëjtën ditë, ministri urdhëroi verbalisht arrestimin e ankuesit. Urdhri nuk u ekzekutua asnjëherë, veçanërisht duke pasur parasysh trazirat që vijuan pas vrasjes së Anëtarit të Parlamentit (shih paragrafin 10 më lart).

14. Në vendin e ngjarjes u kryen testet e mjekësisë ligjore, si dhe u kryen ekzaminime balistike të një automatiku dhe një pistolette të gjetura në vendin e ngjarjes. Nuk u krye asnjë autopsi.

15. Në ditët pas vrasjes, policia mori informacione nga pesë dëshmitarë. Dukej se një prej dëshmitarëve, znj. A. R., deklaroi se e kishte dalluar qartë vrasësin dhe ishte në gjendje ta njohte atë. Një tjetër dëshmitar tha se kishte parë dy meshkuj të dilnin nga një makinë policie (një Mercedes benz 250 të gjelbër) dhe të qëllonin Anëtarin e Parlamentit dhe truporjat e tij. Për më tepër, ai argumentonte se një person tjetër në ndenjësën e shoferit kishte pritur në makinën e parkuar dhe pastaj kishte dalë jashtë me qëllim që të tërhiqte brenda në makinë njërin prej agresorëve, i cili ishte plagosur gjatë shkëmbimit të zjarrit.

16. Prokurori nuk mori në pyetje as ankuesin dhe as z. Berisha.

17. Më 20 shtator 1998, prokurori mori në pyetje Z.N., truporjen e plagosur, i cili i kishte shpëtuar sulmit. Ai deklaroi se kishte parë një person të panjohur, i cili kishte dalë nga ndenjësja e pasagjerit të një makine me sirenë policie në pjesën e sipërme të saj, duke qëlluar me automatik pa paralajmëruar. Ai, gjithashtu, deklaroi se ditën e krimit, moti ishte me shumë re dhe lokalet aty afër ishin mbyllur. Nuk u përmend emri i ankuesit apo përfshirja e tij në krim.

18. Në një datë të pacaktuar, Z.N. u largua nga vendi për në Belgjikë.

19. Në një datë të pacaktuar në vitin 2000, M., i cili vuante dënimin në burgun Regina Celli në Itali, u pyet nga Prokuroria e Shqipërisë. Më 18 shkurt 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë ("Gjykata e Rrethit") urdhëroi arrestimin e M. lidhur me vrasjen. Me deklarime shumë të ngatërruara, M. pranoi se kishte dhënë makinën që

ishite përdorur nga vrasësit.

20. Më 26 korrik 2000, M. u pyet për herë të dytë dhe ai akuzoi tre oficerë policie të nivelit të lartë nga qyteti i Bajram Currit për kryerjen e vrasjes, F.M., ankuesin dhe Iz. H. Ky i fundit kishte depozituar një ankim më vete pranë Gjykatës (nr. 34783/06).

21. Më 16 nëntor 2000, më kërkesën e prokurorit shqiptar, një hetues i Bruges mori në pyetje Z.N. Në dëshminë e tij, ai deklaroi se pa një person të dilte nga pjesa e pasme e një Mercedesi të zi. Ai mbante veshur një jelek antiplumb mbi një uniformë ushtarake për maskim të njëjtë me atë që mbahet nga oficerët e policisë dhe mbante në duar një automatik kallashnikov, si dhe dy karikatorë të ngjitur së bashku. Në kundërshtim me deklaratimet që kishte dhënë gjatë ditëve pas vrasjes (shih paragrafin 17 më lart), ai aludoi se ankuesi ishte pikërisht ai person.

22. Më 20 janar 2001, një kriminel përsëritës, Ç., i cili vuante dënimin në Shqipëri, dha deklarinë e tij para prokurorit. Ai kishte vëzhguar ngjarjet që çuan në vrasjen e anëtarit të parlamentit nga veranda e katit të dytë të një bari, e cila ndodhej ngjitur me vendin e ngjarjes. Sipas deklaratimeve të Ç. ankuesi dhe dy persona të tjerë, F.H. dhe N.C., qëlluan anëtarin e Parlamentit.

23. Më 10 mars 2001, në përputhje me nenin 316 § 1 (b) të Kodit të Procedurës Penale ("KPP"), prokurori i kërkoi Gjykatës së Rrethit të siguronte si provë dëshminë e Ç., i cili, pavarësisht faktit se vuante dënimin në Shqipëri, prezumohej se rrezikohej nga dhuna. Avokati i ankuesit i caktuar kryesisht, kërkoi kohë të përgatitej për mbrojtjen. Për rrjedhojë, Gjykata e shtyu seancën gjyqësore më 11 mars 2001.

24. Më 11 mars 2001, Gjykata e Rrethit pranoi kërkesën e prokurorit. Avokati i ankuesit, i caktuar nga gjykata mori pjesë në seancën gjyqësore. Dëshmitari Ç. deklaroi se ai nuk kishte marrë asnjë kërcënim, dhe as nuk i ishte bërë ndonjë premtim në shkëmbim të paraqitjes së tij në gjyq. Ai, i kishte dhënë prokurorit fillimisht deklarime shumë të kufizuara në lidhje me vrasjen nga frika se personat e implikuar në ngjarje ishin oficerë policie me precedentë penalë. Në dëshminë e tij, Ç. deklaroi se po errësohej dhe ai ishte në verandën e një bari të vendosur në krah të selisë së PD-së. Ai shikoi AP, i cili po debatonte ashpër me Is.H. (Is.H. ka depozituar një ankim më vete, nr. 29861/03, pranë Gjykatës). Ankuesi, gjithashtu, ishte i pranishëm. Më pas, ai dëgjoi një të shtënë pistolette, si dhe zjarr automatiku. Ai, gjithashtu, deklaroi se në momentin e ngjarjes, ankuesi ishte ulur në ndenjësën e pasagjerit të makinës së tij.

25. Më 12 mars 2001, prokurori veçoi procedimet penale kundër M. nga procedimet penale kundër ankuesit dhe të bashkëpandehurve të tjerë.

26. Më 31 maj 2002, prokurori rrëzoi akuzat kundër M. për mungesë provash.

### C. Arrestimi i ankuesit

27. Më 14 dhjetor 1999, prokurori vendosi të njoftonte ankuesin për akuzat kundër tij. Sipas vendimit të tij, ankuesi akuzohej në lidhje me ngjarjet e datës 12 shtator 1998 sipas neneve 79 (c), 78, 78-22, 25 dhe 278 § 2 të KP-së. Në të njëjtën ditë, prokurori kërkoi arrestimin e ankuesit. Kërkesa e prokurorit citon në lidhje me këtë çështje si më poshtë:

“Pas vrasjes, në një konferencë televizive, kryetari i Partisë Demokratike përmendi emrin e të akuzuarit Jaho Mulosmani si autor i krimit. Ky pozicion u mbajt në një deklaratë për shtyp të lëshuar nga kjo parti në ditët pas vrasjes. Ky pozicion ... fiton bazueshmërinë duke pasur parasysh se vrasja ndodhi ngjitur me selinë e PD-së dhe se lokalet dhe ambienti përreth frekuentoheshin nga anëtarët dhe admiruesit e saj.”

28. Më 15 dhjetor 1999, Gjykata e Rrethit urdhëroi arrestimin e ankuesit. Vendimi i saj citon, *inter alia*, si më poshtë:

“Autorësia e krimit të të pandehurit u deklarua nga kryetari i PD-së, z. Berisha, në një deklaratë për shtyp, po atë ditë, menjëherë pas vrasjes. Ky pozicion u mbajt në deklaratën për shtyp të PD-së, duke e quajtur të akuzuarin Jaho Mulosmani si autor të krimit.”

29. Më 4 janar 2001, Gjykata e deklaroi ankuesin në mungesë pas përpjekjeve të pasuksesshme për ta lokalizuar atë në vitin 2000. Vendimi i gjykatës deklaroi se ankuesi ishte larguar nga vendi në dhjetor 1999. Ankuesit iu caktuar një avokat i caktuar nga Gjykata.

30. Më 6 maj 2001, ankuesi u arrestua. Pavarësisht faktit se procedimet gjyqësore vazhdonin, ai u mor në pyetje nga prokurori në mungesë të avokatit. Megjithatë, atij iu tha se gëzonte të drejtën të caktonte një avokat. Ankuesi deklaroi se në natën e vrasjes, ai ishte në një hotel që ndodhej afër selisë së PD-së. Në momentin e vrasjes, ai po darkonte në restorantin e hotelit së bashku me persona të tjerë. Makina e tij ishte parkuar ngjitur me hotelin dhe selinë e PD-së. Ai nuk pranoi se kishte pasur ndonjë konflikt të mëparshëm me anëtarin e Parlamentit.

31. Më 7 maj 2001, Gjykata e Rrethit konfirmoi ligjshmërinë e arrestimit të ankuesit. Ankuesi, i cili ishte i pranishëm në seancë gjyqësore deklaroi se dëshironte të përfaqësohej vetë.

### C. Procedimet e gjykatës së shkallës së parë

32. Më 13 mars 2001, prokurori depozitoi një aktakuzë pranë Gjykatës së Rrethit. Bashkëngjitur u paraqit një listë e gjatë me dokumente mbështetëse. Ankuesi dhe katër persona të tjerë të bashkëpandehur u akuzuan për pjesëmarrjen ose organizimin e vrasjes së anëtarit të Parlamentit dhe vrasjen e mbetur në tentativë të civilëve sipas neneve 78, 79 (c) dhe 25 të KP-së.

33. Më 16 mars 2001, përfaqësuesi i ankuesit, i caktuar nga Gjykata, mori në dorëzim dosjen hetimore që përbëhej nga 324 dokumente dhe 1,409 fletë. Në të njëjtën ditë, ai paraqiti një deklaratë ku jepte dorëheqjen

e parevokueshme nga përfaqësimi i ankuesit për shkak të arsyeve të tij shëndetësore dhe personale.

34. Më 3 prill 2001 filloi gjykimi. Gjykata pranoi kërkesën e personit të bashkëpandehur për kohë shtesë për të studiuar dosjen e çështjes dhe shtyu seancën gjyqësore deri më 13 prill.

35. Më 8 maj 2001, pas mbajtjes në paraburgim, ankuesi u paraqit për herë të parë në gjyq. Ai kërkoi leje të caktonte një përfaqësues ligjor. Gjykata pranoi kërkesën dhe shtyu procesin gjyqësor, me qëllim që të thërriste avokatin e ankuesit.

36. Më 11 maj 2001, avokati i ankuesit deklaroi se kishte marrë njohje të pjesshme të materialit në dosjen e çështjes dhe i kërkoi Gjykatës të vazhdonte gjykimin.

#### 1. Dëshmitë e dëshmitarëve

37. Gjykata e shkallës së parë pyeti disa dëshmitarë në lidhje me vrasjen, duke përfshirë si më poshtë:

#### a) Dëshmitari K.G.

38. K.G. ishte shefi i përkohshëm i Komisarariatit të policisë së Bajram Currit në kohën e vrasjes. Më 23 maj 2001, ai dëshmoi se pasi ishte njoftuar për vrasjen, në mbrëmjen e datës 12 shtator 1998, thirri një mbledhje të stafit me drejtuesit e njërive, me qëllim që të forconte nivelin e sigurisë. Ankuesi nuk ishte i pranishëm. Si rezultat, në shtëpinë e ankuesit u dërgua një grup i oficerëve të policisë për të verifikuar vendndodhjen e tij. Ai u informua se ankuesi ishte i sëmurë në krevat.

#### b) Dëshmitari M.

39. Bazuar në nenin 509 të KPP-së dhe Konventës Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (“Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë”), më 23 maj 2001, prokurori kërkoi që M. të pyetej me anë të një lidhjeje audiovizive nga Italia.

40. Më 21 shtator 2001, gjykata pranoi kërkesën e prokurorit për të marrë dëshminë e M. me anë të një lidhjeje audiovizive në përputhje me nenin 151 § 3 të KPP-së. Gjykata, gjithashtu, pranoi deklaratimet e M. për dosjen e çështjes.

41. Më 29 tetor 2001, gjykata dëgjoi M. me anë të lidhjes audiovizive. Në një deklaratim të dhënë në të njëjtën ditë, të bashkëpandehurit, deklaruan qëllimin e tyre për të mos marrë pjesë në seancën gjyqësore për shkak të mungesës së bazës ligjore për lidhjen audiovizive.

42. Sipas dëshmisë së M. ankuesi e takoi atë në një nga rrugët e Tiranës në mëngjesin e datës 12 shtator 1998. Ato blenë së bashku një sirenë policie. Ankuesi po kërkonte për një makinë që të lehtësonte lëvizjet e tij në qytet. F.L., pronari i barit, të cilin M. e frekuentonte vazhdimisht, ra dakord t'i “jepte hua” ankuesit Mercedesin e tij të zi, duke nënkuptuar se ai do t'ia kthente pasdite. M. dhe ankuesi u ndanë duke rënë dakord që të takoheshin përsëri atë pasdite herët.

43. Pasdite herët, M. dhe ankuesi shëtitën me makinë. Me sugjerimin e ankuesit, ata shkuan për

shëtitje nga Liqeni i Tiranës, ku takuan F.H., i cili ishte veshur me uniformë policie.

44. Fillimisht, M. deklaroi se ankuesi mbante në dorë një celular. Ai nuk dinte nëse i përkiste apo jo ankuesit. Ai nuk mund të kujtonte nëse ankuesi kishte marrë apo kishte bërë telefonata.

45. M. argumentonte se ishte dy kilometra larg kur dëgjoi të shtënat në mbrëmjen e 12 shtatorit 1998. Ai ishte në makinën e tij, rrugës për në barin e F.L. Ai kaloi nga vendi i ngjarjes dhe pa taksit përreth vendit të ngjarjes, por jo makinën e F.L. Ai mësoi për vrasjen nga lajmet në televizion.

46. Lidhja audiovizive u ndërpre për një pushim prej 15-minutash. Pas rifillimit, M. deklaroi se njerëzit e tjerë, të cilët kishin qenë të pranishëm pranë Liqenit ishin të armatosur me kallashnikovë apo pistoleta tip TT. Ankuesi kishte marrë telefonin celular nga një i bashkëpandehur tjetër. Rrugës duke u kthyer, ankuesi F.H. dhe N.C. hipën në makinën e M. dhe shkuan të merrnin Mercedesin e zi. M. deklaroi se një furgon policie ishte parkuar në Sheshin e Ushtarit të Panjohur, ndërsa një tjetër ishte vendosur ngjitur me ndërtesën e Parlamentit.

47. M. deklaroi se kishte dëgjuar të shtëna kallashnikovi. Kur arriti në vendin e ngjarjes, dalloi Mercedesin që po largohej, si dhe tre deri në katër persona të shtrirë për tokë.

48. Ndërkohë që dëgjonte lajmet në televizion, në barin e F.L., M. foli në telefon me ankuesin, i cili i tha atij të heshte dhe shtoi se F.L. do të kompensohej për çdo dëmtim që i ishte shkaktuar mjetit.

#### c) Dëshmitari G.B.

49. G.B. kishte një bar në pronësi ngjitur me ndërtesën e PD-së dhe ishte shok fëmijërie i anëtarit të Parlamentit të vvarë. Më 28 maj 2001, G.B. dëshmoi. Ai deklaroi se nuk ishte as në bar dhe as në vendin e ngjarjes në ditën e vrasjes. Sipas tij, ishte raportuar se njerëz të armatosur, përfshirë ankuesin, ishin parë përreth selisë së PD-së. G.B. mohoi ekzistencën e ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet anëtarit të Parlamentit dhe ankuesit. Në të njëjtën kohë, ai rrëfeu një vrasje të mbetur në tentativë kundër AP në Bajram Curri. Ndërkohë që AP kishte shpëtuar për një qime, ankuesi e kishte kërcënuar AP se nuk do të shpëtonte përsëri. G.B. deklaroi, gjithashtu, se S.L., një trupprojë që punonte për PD-në, i cili ishte i pranishëm në ndërtesë në momentin e ngjarjes, nuk i kishte parë autorët e krimit.

#### d) Dëshmitari A.L.

50. A.L. ishte shofer në Komisaratin e policisë në Bajram Curri dhe më 8 maj 2001, ai bëri një deklaram para prokurorit. Sipas deklaramit, A.L. u largua me shërbim në Tiranë vonë në mbrëmjen e datës 10 shtator 1998. Kjo u bë me kërkesë të ankuesit, i cili ishte shefi i rendit. Asnjë detaj nuk është dhënë për qëllimin e

shërbimit. F.H. dhe E.H. e shoqëruan atë së bashku me ankuesin. Rrugës për në Tiranë, A.L. dalloi një Fiat Tipo pas tyre, megjithëse ai nuk mundi të dallonte shoferin e Fiat-it. Kur ata ndaluan në një bar për të pirë diçka, N.C. u bashkua me ta. Në këtë moment, A.L. pa Fiat-in duke kaluar pranë dhe dalloi se një prej të bashkëpandehurve (Is. H) ishte duke drejtuar makinën. Ato kaluan të gjithë ditën më 12 shtator 1998 nga Liqeni i Tiranës. Në mbrëmje, ata u bashkuan me njerëz të tjerë. Në një moment të caktuar, ata vendosën të ktheheshin në qytet dhe disa njerëz hipën në makina. Atij iu tha të parkonte pranë selisë së PD-së. Pasi dëgjoi të shtëna automatiku, atij iu kërkua të drejtonte makinën për në spitalin civil. Rrugës, A.L. u ndalua nga ankuesi. F.H. dhe ankuesi hipën në makinë së bashku me N.C., i cili ishte plagosur. Pasi dërguan N.C. në spital, A.L. u kthye në Bajram Curri në mbrëmjen e 12 shtatorit; ata nuk i shoqëroi asnjë makinë tjetër. Ankuesi, F.H. dhe E.H. ishin në makinë. Deklarimi iu bë i njohur të pandehurit dhe gjykatës në një datë të pacaktuar më 2001-in.

51. Më 25 korrik 2001, gjykata dëgjoi dëshminë e A.L. Ankuesi dhe avokati i tij morën pjesë në seancën gjyqësore dhe pyetën A.L.

52. Sipas dëshmisë së A.L., në mbrëmjen e datës 10 shtator 1998, ai ishte urdhëruar nga ankuesi të përgatiste një furgon policie dhe të udhëtonte drejt Tiranës së bashku me E.H. dhe F.H. Pasi ishte larguar nga Bajram Curri, ai pa që një Fiat Tipo, i cili i përkiste një prej të bashkëpandehurve (Is. H.), ishte bashkuar me autokolonën prej tri makinash. Rrugës për në Tiranë, një person i katërt, N.C., u bashkua me ta kur ndaluan në një bar për të pirë diçka. Ato kaluan pjesën më të madhe të 12 shtatorit 1998 në një bar te Liqeni i Tiranës. Në mbrëmje, E.H., F.H. dhe një i bashkëpandehur tjetër (Iz. H.) hipën në furgonin e policisë dhe u drejtuan sërish për në qytet. Ankuesi, F.H. dhe N.C. ishin në një Mercedes me sirenë policie në pjesën e sipërme të saj. A.L. i ishte thënë të parkonte pranë Sheshit të Ushtarit të Panjohur dhe të priste. Tridhjetë minuta më vonë ai dëgjoi të shtëna automatiku. Më pas, ai ishte udhëzuar të ndizte makinën dhe të drejtohej për në spitalin civil. Në një kryqëzim, ai pa makinën tip Mercedes së bashku me ankuesin dhe F.H. Ata mbartnin N.C., i cili ishte plagosur, në makinën e tij dhe u drejtuan te pavioni i urgjencës së spitalit civil. Ankuesi dhe F.H. i shpjeguan A.L. se N.C. ishte plagosur në një aksident. E.H. dhe i bashkëpandehuri tjetër (Iz. H.) dolën nga furgoni i policisë. A.L., ankuesi dhe F.H. u kthyer në Bajram Curri të njëjtën mbrëmje. Më tej, ai deklaroi se ankuesi ishte veshur me rroba civile dhe ishte armatosur me një pistoletë dhe se F.H. ishte veshur me uniformë ushtarake dhe ishte armatosur me një automatik. Ai

shtoi se të nesërmen në mëngjes kishte dëgjuar në televizion se ankuesi ishte autori i krimit.

53. Avokati i ankuesit kundërshtoi se deklarimet e A.L., të marra gjatë hetimit penal, nuk ishin bërë të njohura siç duhet nga prokurori (shih paragrafin 50 më lart). Ai i kërkoi gjykatës që t'i jepte kohë të përgatiste mbrojtjen. Për rrjedhojë, gjykata shtyu seancën gjyqësore për t'i lejuar mbrojtjes mundësinë që të pyeste A.L.

54. Më 26 korrik 2001, A.L. u pyet nga pala kundërshtare.

#### e) Dëshmia e ankuesit

55. Më 27 korrik 2001, ankuesi dëshmoi. Me kërkesën e F.H., ata së bashku me E.H. u larguan për në Tiranë në mbrëmjen e datës 10 shtator 1998 në një furgon policie të drejtuar nga A.L. Ankuesi nuk kishte dijeni për qëllimin e F.H. që të vriste z. Hajdari. Pasi ishin larguar nga qyteti, rrugës ata kishin parakaluar makinën e të bashkëpandehurit (Is. H.). Rrugës për në Tiranë, N.C., i cili kishte precedent penal, u bashkua me ta kur ndaluan për të pushuar.

56. Pasdite herët, më 12 shtator 1998, ankuesi ishte shoqëruar me makinë për te Liqeni i Tiranës. Njerëz të tjerë ose ishin aty, ose u bashkuan me ta më vonë. Atë pasdite vonë, ai, F.H. dhe N.C. hipën në makinën e M. Të tre, përveç M., hipën më vonë në një makinë tip Mercedes të zi. Çelësat e makinës ishin marrë nga M. Rreth orës 21:00, ankuesi parkoi makinën ngjitur me selinë e PD-së, meqenëse F.H. donte të fliste me AP dhe persona të tjerë për një kasetë që përmbante një diskutim në të cilin z. Berisha kishte thënë se ai dëshironte të shihte vëllanë e tij të vdekur. N.C. dhe F.H. ishin ulur në pjesën e pasme të makinës, dhe ky i fundit po komunikonte me dikë *nëpërmjet* një radioje marrëse-dhënëse.

57. Ankuesi pranoi se kishte qenë në ndenjësën e shoferit kur F.H. dhe N.C. dolën nga makina dhe hapën zjarr. Si rezultat, N.C. ishte plagosur rëndë. I paarmatosur, ai doli nga makina për të tërhequr N.C. në makinë dhe e dërgoi atë në spital. F.H. komunikoi *nëpërmjet* radios marrëse-dhënëse me një person tjetër, me të cilin ranë dakord të takoheshin afër sptialit civil. Ankuesi deklaroi se ishte identifikuar si oficer policie ndaj personave në shërbim në spital.

58. Gjatë ditëve në vijim, ai kishte qenë në detyrë në Komisaratin e policisë ku mësoi se z. Berisha i ishte referuar atij si vrasësi. Në të njëjtën ditë, ai takoi F.H., i cili i tha ankuesit se z. Berisha i kishte ofruar F.H. 200,000,000 USD, me qëllim që të mos rrëfente përfshirjen e F.H. në vrasje. Në muajt në vijim, babai i ankuesit dhe F.H. ishin vlarë nga persona të panjohur dhe ankuesi u largua në Kosovë, i frikësuar për jetën e tij. Ai i kërkoi gjykatës të urdhëronte z. Berisha të paraqitej në gjyq, me qëllim që të qartësonte pozicionin e tij dhe të shpjegonte marrëveshjen e tij me F.H.

59. Më 30 korrik 2001, ankuesi u pyet nga pala kundërshtare.

60. Më 8 mars 2002, për sa i përket kërkesës së ankuesit për të dhënë prova të tjera, Gjykata e Rrethit i kërkoi atij të jepte deklarime në të njëjtën ditë. Ankuesi kërkoi kohë shtesë për të përgatitur parashtrimet. Gjykata e refuzoi kërkesën.

#### f) Dëshmitari P.G.

61. Më 20 shtator 2001, P.G. dëshmoi. Dëshmitare okulare e vrasjeve, ajo deklaroi se AP, i cili ishte i shoqëruar nga truprojat e tij të paarmatosur, iu afrua një makine të çuditshme, e cila kishte lëvizur në atë zonë në mbrëmjen e datës 12 shtator 1998. AP pati një debat të ashpër për PD-në dhe z. Berisha me njerëzit që dolën nga makina. Ai dhe truprojat e tij u qëlluan për vdekje nga tre njerëz, njëri prej të cilëve ishte ankuesi. Ajo deklaroi se ankuesi ishte veshur me uniformë ushtarake dhe se doli nga ndenjësja e parë e pasagjerit dhe qëllou AP dhe truprojtën e tij.

62. Pas të shtënave, P.G. deklaroi se shkoi te selia e PD-së ku i tregoi ngjarjen z. Berisha.

#### g) Dëshmitari S.L.

63. Më 13 nëntor 2001, dëshmitari S.L. dëshmoi dhe u pyet nga pala kundërshtare. Megjithatë, asnjë procesverbal i kësaj seance gjyqësore nuk u vu në dispozicion të Gjykatës.

#### h) Dëshmitari B.Y.

64. Më 5 shkurt 2002, gjykata pranoi kërkesën e ankuesit për të pyetur B.Y., ekspert i mjekësisë ligjore, i cili kishte këqyruar kufomat e z. Hajdari dhe B.C. B.Y. deklaroi se z. Hajdari kishte vdekur si rezultat i plagëve të rënda në trupin e tij.

#### i) Dëshmitari Ç.

65. Më 20 shkurt 2002, Ç. dëshmoi. Ai tha se, rreth orës 21:00, më 12 shtator 1998, ai ishte ulur në verandën e një kafeneje 60 metra larg vendit të ngjarjes. Pavarësisht faktit se jashtë ishte plotësisht errësirë dhe binte shi, ai kishte parë ankuesin duke qëlluar në drejtim të AP me një automatik. Ankuesi dhe i bashkëpandehuri tjetër pyetën mbi bazueshmërinë e dëshmisë së Ç., meqenëse deklarimet e tij i referoheshin personave dhe makinave që nuk ishin përshkruar nga dëshmitarë të tjerë në vendin e ngjarjes.

66. Në një datë të pacaktuar, u pyet pronari i kafenesë ku ishte ulur Ç. në mbrëmjen e datës 12 shtator 1998. Ai deklaroi se në atë ditë, kafeneja ishte mbyllur, si zakonisht, në orën 19:00. Veranda ndodhej përreth 200 metra larg vendit të ngjarjes.

#### j) Dëshmitari Z.N.

67. Në një datë të pacaktuar, gjykata mori parashtrimet me shkrim të Z.N., i cili ishte plagosur rëndë ditën e vrasjes. Ai deklaroi, *inter alia* se, mesa mbante mend, ankuesi mund të ishte personi i cili kishte qëlluar AP.

## 2. Mosparaqitja e një dëshmitari

68. Më 23 maj, 8 qershor, 25 dhe 27 korrik 2001, gjykata thirri pa sukses z. Berisha, i cili ishte AP dhe kryetar i PD-së (shih paragrafin 9 më lart). Gjykata njoftoi ministrin e atëhershëm të Rendit, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, si dhe institucione të tjera për mospranimin e tij për t'u paraqitur në gjykatë.

69. Më 7 shtator 2001, gjykata rrëzoi kërkesën e prokurorit, *inter alia*, për një urdhër për paraqitjen e detyruar të z. Berisha dhe përsëriti thirrjet që ai të paraqitej në gjyq.

70. Më 14 dhe 26 shtator 2001, Gjykata e Rrethit, urdhëroi z. Berisha, *inter alia*, pa sukses, të paraqitej.

71. Më 29 tetor 2001, gjykata vendosi t'i referojë Gjykatës Kushtetuese çështjen e urdhrimit për paraqitjen e detyruar të z. Berisha, meqenëse ai ishte anëtar Parlamenti. Dukej se Gjykata Kushtetuese nuk kishte vendosur akoma mbi këtë çështje.

## 3. Parashtrimet përfundimtare të palëve

72. Më 18 mars 2002, prokurori bëri parashtrimet e tij përfundimtare duke kërkuar dënimin e ankuesit sipas akuzës.

73. Më 10 prill 2002, ankuesi bëri parashtrimet e tij përfundimtare.

## 4. Vendimi i Gjykatës së Rrethit i datës 29 prill 2002

74. Më 29 prill 2002, Gjykata e Rrethit dha vendimin. Ajo konstatoi se, bazuar në raportet e mjekësisë ligjore, AP dhe truproja e tij kishin vdekur "nga shoku i rëndë traumatiko-hemoragjik për shkak të plagëve të shumta tejkuese në kokë, në kraharor dhe në bark". Disa nga gëzhhojat e gjetura në vendin e ngjarjes ishin qëlluar nga një pistoletë me kalibër 9 mm, e cila, sipas dëshmitarit A.L., i përkiste ankuesit dhe ishte përdorur për kryerjen e krimit.

75. Gjykata konstatoi më tej se ankuesi, së bashku me F.H., kishte vepruar si organizatori dhe ekzekutuesi i vrasjes së AP dhe një prej truprojave të tij. Ankuesi planifikoi udhëtimin e datës 10 shtator 1998 nga Bajram Curri për në Tiranë me kërkesën e F.H. Për më tepër, ai është përfshirë direkt në sigurimin e mjeteve për kryerjen e krimit. Një gjë e tillë është konfirmuar nga dëshmitë e S.L., P.G. dhe G.B. dhe, veçanërisht nga dëshmia e A.L. Vendimi, në pjesët përkatëse, citon si më poshtë:

"Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, gjykata është e bindur se një prej autorëve të krimit ... është i pandehuri, Jaho Mulosmani, në rolin e tij si organizator dhe ekzekutues.

Është provuar nga fillimi ... se më 10 ... 11 dhe 12 shtator 1998 ... i pandehuri, në bashkëpunim me persona të tjerë që kanë vdekur, ndërmorën disa masa organizative, me qëllim që të siguronin mjetet e nevojshme dhe personat që do të merrnin pjesë në operacion dhe planifikimin [e vrasjes]. Kjo tregon rolin e tij si organizator i krimit.

Përfshirja e tij direkte në kryerjen e krimit, e vendos atë në rolin e ekzekutuesit.

Dëshmitë e dëshmitarëve A.L., S.L., P.G., G.B. etj.; si dhe të dhëna të tjera dokumentare të konstatuara në dosjen e çështjes ... provojnë pjesëmarrjen aktive të të pandehurit si organizatori dhe ekzekutuesi i krimit në bashkëpunim me të tjerët".

76. Gjykata argumentoi, gjithashtu, se AP nuk ishte vrasës për arsye politike, por për qëllime hakmarrjeje. Ankuesi kishte ndihmuar dhe nxitur F.H. në kryerjen e vrasjes meqenëse kishte si qëllim të hakmerrej për vrasjen e vëllait të tij në të cilën F.H. besonte se AP ishte i përfshirë. Për pasojë, gjykata përcaktoi akuzat kundër ankuesit si vrasje e kryer me paramendim për hakmarrje sipas nenit 78 § 2 të KP-së, i cili ka hyrë në fuqi më 24 janar 2001. Vendimi në pjesët përkatëse, citon si më poshtë:

Prokuroria përcaktoi vrasjen sipas nenit 79 (c), duke e lidhur atë me faktin që, gjatë një seance parlamentare, AP tashmë i vrasës kishte akuzuar F.H. për vrasjen [e një oficeri policie].

Mbi këtë bazë, prokurori vendosi se motivi për vrasjen e AP kishte qenë pozicioni i tij si AP. Megjithatë, provat e përfutura në gjyq, rrethanat dhe ngjarjet që çuan në vrasjen e AP vërtetuan se vrasja është kryer për motive të dobëta të hakmarrjes.

Siç vërtetohet nga disa prova, F.H. akuzoi AP se ishte përfshirë në vrasjen e vëllait të tij më 5 janar 1998.

...

Në faqen 8 të parashtrimeve përfundimtare të prokurorit, është ngritur pyetja e mëposhtme:

"Çfarë e nxititi të pandehurin Jaho Mulosmani të bëhej një nga organizatorët e vrasjes së AP?" Përgjigja është dhënë si më poshtë:

"Lidhje të ngushta familjare dhe shoqërore mbi bazën e lidhjes familjare dhe interesit kriminal me personin e kërkuar, F.H." ... Në thelb ... Jaho Mulosmani i hyri rrugës së krimit për arsye miqësore, lidhjeje të ngushta shoqërore dhe klanore me F.H., me qëllim që të hakmerrej më shumë sesa të vriste AP për arsye të pozicionit të tij.

...

Në këto rrethana, duke përcaktuar se pjesëmarrja e të akuzuarit Jaho Mulosmani bazohej në motivin e hakmarrjes dhe jo për shkak të pozicionit të viktimës si anëtar Parlamenti, akuzat kundër tij duhet të përcaktohet sipas nenit 78 § 2 e Kodit Penal në vend të nenit 79 (c)."

77. Në dhënien e vendimit për dy të bashkëpandehurit, Gjykata rrëzoi dëshmitë e dëshmitarëve Ç. dhe M. si kontradiktore dhe të pabazueshme.

78. Përfundimisht, ankuesi u shpall fajtor për: vrasjen e AP sipas neneve 78 § 2 dhe 25 të KP-së; vrasjen e B.C. sipas neneve 75 dhe 25 të KP-së; dhe, vrasjen e mbetur në tentativë të Z.N., sipas neneve 78 dhe 25 të KP-së. Ai u dënua me burgim të përjetshëm.

## D. Procedimet e gjykatave të apelit

### 1. Procedimet para Gjykatës së Apelit

79. Më 2 maj 2002, ankuesi apeloj kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit. Ai pranoi se, me kërkesën e F.H., ata ishin nisur për Tiranë në mbrëmjen e datës 10 shtator 1998. F.H. nuk mund të udhëtonte ditën për shkak të problemeve të gjakmarrjes ndërmjet tij dhe familjeve të tjera në zonë. Qëllimi i udhëtimit ishte që F.H. të merrte shpjegime nga AP në lidhje me rolin e tij si vrasës i vëllait të F.H. Rrugës për në Tiranë, ata kishin ndeshur në



makinë e policisë të bashkëpandehurit (Is. H.). Në Tiranë, ankuesi kishte lëvizur lirshëm, me qëllim që të lehtësonte takimin ndërmjet F.H. dhe AP. Këto lëvizje ishin krejtësisht të rastësishme dhe nuk synonin organizimin e njerëzve ose grupimin e bashkëpandehurve apo krijimin e lehtësirave të tjera për qëllime kriminale. Nëse ankuesi do të kishte qenë organizatori i krimit, ai do të ishte përpjekur të fshihej dhe të shmangte paraqitjen në publik. Ankuesi më tej pranoi se ishte i pranishëm në vendngjarje së bashku me F.H. dhe N.C., por ai nuk kishte qëlluar asnjëherë AP. Ishte pikërisht F.H., i cili kishte dalë nga ndenjësjë e pasme e makinës dhe kishte qëlluar AP me një automatik. Kjo u konfirmua më tej nga deklaratimet e Z.N. më 25 shtator 1998 dhe 16 nëntor 2000.

80. Ankuesi parashtroi se faji i tij nuk ishte vërtetuar përtej dyshimeve të arsyeshme, por bazohej në hamendësime, pasiguri dhe aludime. Nuk kishte prova që të vërtetonin se ai kishte qëlluar apo që të ketë pasur një pistoletë të kalibrit 9 mm. Dëshmitari A.L. nuk ishte i pranishëm në vendngjarje dhe dëshmia e tij nuk mund të ishte e besueshme për këtë qëllim. Ai pretendoi se dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë mbi të cilat u bazua gjykimi ishin kontradiktore dhe spekulative. Deklarimi i Z.N., i datës 16 nëntor 2000, ishte i mbështjellë me mister. Kufomave nuk u ishte bërë asnjë autopsi për të zbuluar nëse ata kishin vdekur nga shkaqe të tjera (për shembull, helmimi). Deklarimi i tij, i datës 6 maj 2001, kishte shërbyer si bazë për ta dënuar atë dhe, megjithatë, atij iu mohua e drejta që të dëgjohej nga gjykata e shkallës së parë më 8 mars 2002.

81. Ankuesi, argumentoi më tej se gjykata e shkallës së parë gaboi duke e dënuar atë për vrasje me paramendim. Nuk ekzistonte asnjë provë përtej dyshimit të arsyeshëm se ai kishte organizuar planin dhe kryerjen e ndonjë veprë paraprakisht. Gjykata ishte paragjyquese dhe e ndikuar nga raportet e medias, politika dhe interesa të tjera që ishin në lojë që nga fillimi i gjykimit. Përveç kësaj, gjykata nuk vërtetoi ekzistencën e asnjë motivi për kryerjen e vrasjes me paramendim: motivi i interpretuar nga gjykata bazohej kryesisht në mundësi dhe pasiguri, faktin që F.H. dëshironte të hakmerrej kundër AP për shkak të akuzave të këtij të fundit kundër F.H. gjatë një seance parlamentare. Gjykata nuk përmendi asnjë provë se ekzistonin "lidhje të ngushta familjare dhe shoqërore mbi bazën e klaneve familjare dhe interesave kriminale" ndërmjet ankuesit dhe F.H. Gjithashtu, ajo nuk përmendi as prova për ekzistencën e interesit të ankuesit në kryerjen e krimit. Gjykata nuk zbuloi ekzistencën e një marrëveshjeje të mëparshme ndërmjet ankuesit dhe të bashkëpandehurit në lidhje me kryerjen e vrasjes me paramendim, siç pretendohet.

82. Më 9 korrik 2002, Gjykata e Apelit la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit në tërësi.

## 2. Procedimet para Gjykatës së Lartë

83. Më 31 korrik 2002, ankuesi apeloj pranë Gjykatës së Lartë me të njëjtat argumente ankimi si përpara Gjykatës së Apelit, duke shtuar se, sipas dispozitave ligjore të kohës, gjykatat më të ulëta nuk ishin të autorizuar të përcaktonin akuzat penale kundër tij, prerogativë që i takonte vetëm prokurorit. Ai, gjithashtu, pretendoi se vendimeve u mungonin arsyet dhe koherenca, se disa dëshmitarë nuk ishin thirrur dhe se dëshmia e dëshmitarit M. ishte marrë në mënyrë të kundërligjshme dhe ishte pranuar në dosjen e çështjes.

84. Më 14 shkurt 2003, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta.

85. Gjykata e Lartë konstatoi se, megjithëse dosja e çështjes nuk tregoi ndonjë vendim zyrtar për të mbyllur fazën e hetimit dhe për të zbuluar dokumentet e marra gjatë hetimit penal të ankuesit dhe të bashkëpandehurit tjetër, më 3 prill 2001, Gjykata e Rrethit kishte pranuar një prej kërkesave të bashkëpandehurit për kohë shtesë për përgatitjen e mbrojtjes së tij deri më 13 prill 2001.

86. Për sa i përket ankimit të ankuesit se deklarimi i tij, i datës 6 maj 2001, ishte përdorur si provë, Gjykata e Lartë konfirmoi se deklarimi nuk ishte përfshirë në dosjen e çështjes dhe as nuk ishte pranuar si provë nga Gjykata e Lartë.

87. Gjykata e Lartë konstatoi se deklaratimet dhe dëshmia audiovizive e M. ishin marrë mbi bazën e nenit 151 § 3 dhe 509 të KPP-së dhe të Konventës për Ndhimë të Ndërsjellë. Deklarimet e M. gjatë hetimit penal kishin qenë subjekt i shqyrtimit gjyqësor me anë të lidhjes audiovizive. Ankuesi kishte të drejtë të pyeste vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij palën kundërshtare M. Fakti që disa të bashkëpandehur ishin larguar nga seanca gjyqësore, nuk e bënte paraqitjen e provave të kundërligjshme. Ndërkohë që Gjykata e Lartë dënoi sjelljen e këtyre të bashkëpandehurve në seancën gjyqësore, ajo i kërkoi gjykatës së shkallës së parë të siguronte që, në të ardhmen, të caktonte avokatë të caktuar kryesisht me qëllim që të garantonin mbrojtjen e të drejtave të palës mbrojtëse.

88. Gjykata e Lartë rrëzoi ankimin e ankuesit se nuk i ishte dhënë koha e mjaftueshme për të përgatitur deklaratimet për mbrojtjen e tij. Ajo konstatoi se gjatë procedimeve në mungesë, gjykata e shkallës së parë caktoi një avokat për të përfaqësuar interesat e ankuesit. Në paraqitjen e tij të parë në gjyq, u pranua kërkesa e tij që të mbrohej nga një avokat i zgjedhur prej tij. Më 27 korrik 2001, ankuesi u lejua të jepte dëshminë e tij dhe të pyetej nga pala kundërshtare. Ai mori pjesë në të gjitha seancat gjyqësore në vijim dhe i pyeti dëshmitarët. Më 8 mars 2002, gjykata e shkallës së parë i kërkoi ankuesit të jepte deklarime shtesë në të njëjtën ditë. Ai nuk e bëri një gjë të tillë, dhe gjykata e shkallës së parë vazhdoi me parashtrimet përfundimtare të palëve.

89. Fakti që ankuesi dhe të bashkëpandehurit nuk ishin pajisur më parë me një kopje të deklarimit të A.L. nuk cenonte të drejtat e mbrojtjes së tyre: A.L. kishte dëshmuar në gjyq me kërkesën e ankuesit dhe ky i fundit kishte pasur mundësinë ta pyeste atë.

90. Në lidhje me ankimin e ankuesit se në gjyq nuk kishte dëshmuar asnjë ekspert i mjekësisë ligjore, Gjykata e Lartë theksoi se, më 18 shkurt 2002, kishte dëshmuar një ekspert i mjekësisë ligjore duke dëshmuar se AP dhe truproja e tij kishin vdekur nga plagë të rënda në trupat e tyre.

91. Gjykata e Lartë konstatoi më tej se përcaktimi i akuzave kundër ankuesit nga gjykata e shkallës së parë ishte në përputhje me ligjin, më specifikisht neni 375 i KPP-së, i cili kishte hyrë në fuqi më 13 qershor 2002.

92. Në përfundim, Gjykata e Lartë rrëzoi pjesën tjetër të ankimeve të ankuesit me arsyetimin se ato lidheshin me vlerësimin e provave, gjë që ishte në kompetencë të gjykatave më të ulëta.

### 3. Procedimet para Gjykatës Kushtetuese

93. Në një datë të pacaktuar, ankuesi depozitoi ankim kushtetues pranë Gjykatës Kushtetuese, duke u bazuar në të njëjtat argumente ankimi si para gjykatave më të ulëta.

94. Më 9 korrik 2003, Gjykata Kushtetuese, duke gjykuar si trup i plotë gjykues prej nëntë gjyqtarësh, e deklaroi ankimin të papranueshëm me arsyetimin se ankimi nuk zbulonte shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë. Nuk u dha asnjë arsye.

## II. E DREJTA PËRKATËSE E BRENDSHME DHE NDËRKOMBËTARE

### A. Kodi Penal

95. Sipas nenit 26, organizatorë janë ata persona, të cilët organizojnë dhe drejtojnë aktivitetin për kryerjen e veprës penale. Ekzekutues janë ata persona të cilët kryejnë veprime direkte për kryerjen e veprës penale.

96. Në kohën e kryerjes së veprës penale, neni 78, i ndryshuar në vitin 1996, parashikonte se vrasja me paramendim përfshinte dënimin me burgim të përjetshëm. Neni 79 (c), i cili rregullonte veprën penale të vrasjes me dashje për shkak të rrethanave të tjera cilësuese të viktimës, parashikonte dënimin me burgim të përjetshëm.

97. Pas miratimit të ligjit nr. 8733, datë 24 janar 2001, nenet 78 dhe 79 (c) u ndryshuan si më poshtë:

#### Neni 78 – Vrasja me paramendim

“1. Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzetepesë vjet.

2. Vrasja e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje dënohet me njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.”

#### Neni 79: Vrasja me dashje në rrethana të tjera cilësuese

“Vrasja me dashje e kryer kundër: ...

c) anëtarit të Parlamentit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit,

policit, ushtarakut, funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura;

dënohet nga 20 vjet deri në burgim të përjetshëm.”

### B. Kodi i Procedurës Penale (“KPP”)

98. Sipas nenit 156, i pandehuri në një veprë penale të përbashkët ose i pandehuri, i cili ndiqet në një procedim të lidhur nuk mund të pyetet si dëshmitar. Megjithatë, sipas nenit 167, i pandehuri në një procedim të lidhur mund të pyetet me kërkesën e palës ose kryesisht.

99. Neni 151 § 3 autorizon gjykatën të marrë një provë që nuk rregullohet me ligj nëse ajo vlen për të provuar faktet dhe nuk cenon vullnetin e lirë të personit.

100. Sipas nenit 162, zyrtarë të nivelit të lartë të shtetit, të tillë si: Presidenti, kryetari i Parlamentit, Kryeministri, kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, mund të dëshmojnë nga vendi ku ushtrojnë detyrën.

101. Sipas nenit 164 § 1 “kur një dëshmitar, i cili është thirrur nuk paraqitet në sallën e gjyqit në vendin, ditën dhe kohën e caktuar, pa pasur pengesa të ligjshme, gjykata mund të urdhërojë shoqërimin e detyrueshëm të dëshmitarit.”

102. Nenet 316-322 drejtojnë institucionin e sigurimit të provave gjatë fazës së hetimit penal. Palët mund të kërkojnë sigurimin e provës, për shembull, dëshminë e një dëshmitari, paraqitjen për njohje, raport eksperti, kur ka arsye të besohet se ata mund të pengohen për të marrë prova të tilla në të ardhmen. Kërkesa duhet të paraqitet me shkrim në sekretarinë e gjykatës. Sigurimi i provave të tilla bëhet në një seancë gjyqësore në prani të palëve.

103. Sipas nenit 324 § 4 veprimet hetimore, të kryera pas skadimit të afatit kohor për kryerjen e hetimit penal, nuk mund të përdoren në gjyq.

104. Në kohë materiale, neni 364 § 1 parashikonte, *inter alia*, pyetjen e dëshmitarëve në shtëpinë e tyre, në praninë e të pandehurit ose përfaqësuesit të tij, në rast të pamundësisë absolute për të dhënë dëshminë në gjyq.

105. Neni 375, në fuqi në kohën e miratimit të vendimit të Gjykatës së Rrethit, parashikonte se gjykata duhet të njoftojë palët për përcaktimin e ri ligjor që mund t’u bëjë fakteve, të ndryshëm nga ai i dhënë nga prokurori, me kusht që vepra penale të jetë brenda kompetencës së saj. Neni 375, i ndryshuar më 13 qershor 2002, citon se “në vendimin e saj të formës së prerë, gjykata mund t’u japë fakteve një përcaktim të ri ligjor, të ndryshëm nga ai i dhënë nga prokurori ..., më të lehtë ose më të rëndë, me kusht që vepra penale të jetë në kompetencë të saj.”

Më 30 korrik 1997, Gjykata Kushtetuese vendosi se neni 375 ishte në përputhje me Kushtetutën (vendimi nr. 50/99). Për përcaktimin e veprës, vepra penale duhet të jetë në juridiksionin e gjykatës. Vendimi për

përcaktimin duhet t'u njoftohet palëve. Nëse vendimi merret në momentin që gjykata tërhiqet për diskutimet, gjykata duhet të përsërisë procedimin, të njoftojë palët për përcaktimin dhe të dëgjojë argumentet e tyre.

106. Neni 425 § 1 përcakton objektin e shqyrtimit të një ankimi nga Gjykata e Apelit. Ajo parashikon se shqyrtimi i një çështjeje nga Gjykata e Apelit nuk kufizohet me argumentet e ankimit, por përfshin të gjithë çështjen, që do të thotë shqyrtimin, si të fakteve ashtu edhe të së drejtës. Gjykata e Apelit mund të bëjë rivlerësim të plotë të provave të marra dhe shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë, rast në të cilin vendos rishtaz mbi fajësinë apo pafajësinë e apellesit. Sipas nenit 427, Gjykata e Apelit mund të përsërisë shqyrtimin gjyqësor të çështjes. Në rastin kur një prej palëve kërkon rishqyrtimin e provave të administruara gjatë procedimeve gjyqësore në shkallë të parë ose kërkon marrjen e provave të reja shtesë, Gjykata e Apelit, kur e çmon të domosdoshme, mund të vendosë për përsëritjen e procedimeve gjyqësore, pjesërisht ose tërësisht (neni 427 § 1). Në rastin kur provat janë zbuluar pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose kur provat janë zbuluar gjatë procedimit të ankimit, Gjykata e Apelit vendos sipas rastit në lidhje me pranimin e tyre (neni 427 § 2). Përsëritja e çështjes mund të vendoset, gjithashtu, kryesisht kur çmohet e domosdoshme (neni 427 § 3). Gjykata e Apelit mund të rishqyrtojë, gjithashtu, provat, me kusht që i pandehuri të mos ketë qenë i pranishëm në gjyqin e shkallës së parë, për shkak se nuk ka marrë dënimin ose për shkak se nuk ka mundur të paraqitet për shkaqe ligjore. Neni 428 përcakton se Gjykata e Apelit mund të vendosë të pushojë ankimin dhe të lërë fuqi vendimin e shkallës së parë, të ndryshojë vendimin e shkallës së parë, të pushojë vendimin e shkallës së parë dhe të përfundojë çështjen ose të pushojë vendimin e shkallës së parë dhe ta kthejë çështjen për rigjykim.

107. Kundër vendimeve të Gjykatës së Apelit mund të ankimohet pranë Gjykatës së Lartë në përputhje me një nga dispozitat e mëposhtme të nenit 432: a) e drejta penale nuk është respektuar ose është zbatuar në mënyrë të gabuar; b) ka pasur shkelje, të cilat kanë bërë që vendimi i gjykatës të shpallet i pavlefshëm në përputhje me nenin 128 të këtij Kodi; c) Ka pasur shkelje të rregullave procedurale, të cilat kanë ndikuar negativisht në miratimin e vendimit. Neni 434 parashikon se Gjykata e Lartë shqyrton çështjen brenda kufijve të shkaqeve të ngritura. Ajo ka të drejtë të shqyrtojë dhe të vendosë me propozimin e saj dhe në çdo fazë ose shkallë të procedimeve çështje ligjore, të cilat nuk janë shqyrtuar më parë. Sipas nenit 441, Gjykata e Lartë mund të vendosë: a) të lërë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët; b) të ndryshojë përcaktimin e veprës penale, në lidhje me llojin, dënimin dhe pasojat civile; c) të

pushojë vendimin e gjykatës më të ulët dhe të miratojë një vendim pa e kaluar çështjen për rishqyrtim në gjykatën më të ulët; d) të pushojë vendimin e gjykatës më të ulët dhe ta kalojë çështjen për rishqyrtim; e) të pushojë vendimin e Gjykatës së Apelit dhe të lërë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit.

#### **C. Konventa Evropiane për Ndihmën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (“Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë”)**

108. Konventa për Ndihmën e Ndërsjellë hyri në fuqi për Shqipërinë më 3 korrik 2000. Ajo përcakton rregullat e përbashkëta në fushën e ndihmës së ndërsjellë në çështjet penale, të tilla si pyetja e dëshmitarëve ose ekspertëve. Kërkesat për ndihmë të ndërsjellë bëhen nëpërmjet letër-porosive, të cilat Ministria e Drejtësisë e palës kërkuese ia drejton Ministrisë së Drejtësisë së palës së kërkuar.

#### **D. Rekomandimi 1386 (1998) i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës**

109. Rezoluta, në pjesët përkatëse, citon si më poshtë:

“5. Asambleja dënon me forcë vrasjen e parlamentarit të Partisë Demokratike, Azem Hajdari dhe truporjës së tij. Autoritetet duhet t'i vërtetojnë komunitetit ndërkombëtar se po bëjnë çdo përpjekje për të çuar sa më shpejt para drejtësisë personat përgjegjës dhe për të lejuar hetim të pavarur ndërkombëtar.

6. Asambleja më tej dënon me forcë dhunën politike të të dyja palëve pas këtyre vrasjeve. Sulmet ndaj institucioneve demokratike të shtetit nuk mund të justifikohen me argumente politike. Çdo përpjekje për të marrë pushtetin me forcë është qartësisht i papranueshëm. (...)”.

#### **E DREJTA**

#### **I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 §§ 1 DHE 3 TË KONVENTËS**

110. Ankuesi bëri ankime të shumta sipas nenit 6 § 1 të Konventës. Ai u ankua se gjykatat e brendshme kishin pranuar dëshmi që ishin marrë në mënyrë të kundërligjshme, të tilla si dëshmitë e M. dhe Ç., si dhe deklarinimin e tij të datës 6 maj 2001. Më tej, ai kundërshtoi vlerësimin e provave, të tilla si raportet e ekspertëve të mjekësisë ligjore dhe pretendoi se vendimet e gjykatave të brendshme nuk kishin arsye të mjaftueshme.

111. Ankuesi pretendoi, gjithashtu, shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 6 § 3 (a) deri (d). Ai u ankua se avokati i tij i caktuar nga gjykata nuk kishte kohën e mjaftueshme për të studiuar dosjen e hetimit. Ai nuk kishte akses në të gjitha dokumentet e dosjes dhe veçanërisht deklarinimin e A.L. të datës 8 maj 2001. Gjykatat e brendshme kishin ndryshuar përcaktimin ligjor të akuzave pa i dhënë atij mundësinë të vihej në dënimin të natyrës së akuzave të reja dhe të përgatiste mbrojtjen e duhur ndaj tyre. Ankuesit iu mohua mundësia të jepte dëshmi më 8 mars 2002. Gjykatat e brendshme nuk arritën të detyronin z. Berisha të jepte dëshminë e tij. Ankuesi e konsideronte atë dëshmitarin kryesor.

112. Neni 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri në (d) citon si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundër tij, kushdo gëzon të drejtën e të dëgjuarit ... të drejtën ... nga [1] ... gjykatë ... “

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka këto të drejta minimale:

a) të informohet menjëherë në një gjuhë që e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur kundër tij;

b) të ketë kohën e mjaftueshme dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) të mbrohet personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit ligjor të zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin ligjor, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në emër të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës.”

#### A. Pranueshmëria

113. Gjykata vlerëson se ankimet e ankuesit nuk janë haptazi të pabazuara në kuptim të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke mos qenë të papranueshme për arsye të tjera, për rrjedhojë, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

#### B. Meritat

##### 1. Parashtrimet e palëve

##### a) Ankuesi

114. Ankuesi parashtrori se nuk kishte pasur mbrojtje ligjore për periudhën fillestare prej 13-muajsh, ku avokati i parë mbrojtës i caktuar nga gjykata ishte caktuar më 4 prill 2001. Ai nuk ishte përfaqësuar nga një avokat në seancën gjyqësore të konfirmimit të ligjshmërisë së arrestimit të tij. Për më tepër, meqenëse avokati mbrojtës, i caktuar nga gjykata, u tërhoq nga çështja më 16 mars 2001, atij nuk iu mundësua koha e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij.

115. Disa prova ishin marrë në mënyrë të kundërligjshme, duke përfshirë deklarin e A.L., më 8 maj 2001, e cila ishte fshehur prej tij dhe dëshminë e M., e cila ishte marrë me anë të lidhjes audiovizive në shkelje të së drejtës së brendshme, si dhe dëshminë e Ç. Kërkesat e ankuesit për sqarimin e raporteve të mjekësisë ligjore dhe thirrjen e ekspertëve të tjerë ishin refuzuar. Këto veprime, si dhe mungesa e arsyeve në vendimet e brendshme çuan në mungesën e paanshmërisë dhe pavarësisë së gjykatave të brendshme.

116. Ankuesi më tej pretendoi se dëshmia është një detyrim civil. Imuniteti parlamentar i z. Berisha nuk mund të interpretohej si një pengesë që e pengonte atë të jepte dëshminë. Neni 162 i KPP-së lejon që zyrtarët e lartë të shtetit, duke përfshirë Presidentin e Republikës të japin dëshminë e tyre. Nëse gjykatat do të ishin të shqetësuara për sigurinë personale të z. Berisha, ata mund ta lejonin atë të pyetej në përputhje me nenin 364 § 1 të KPP-së. Ndërkohë që z. Berisha nuk dëshmoi, deklaratat e tij se ankuesi ishte autori i krimit shërbyen si thelbi i dënimit të tij.

#### b) Qeveria

117. Qeveria parashtrori se ankuesi nuk e ngriti ankimin e tij para gjykatave të brendshme për mungesën e përfaqësimit ligjor për periudhën fillestare prej 13-muajsh. Avokati i ankuesit i caktuar *kryesisht* ishte vënë në dijeni të aktakuzës më 16 mars 2001 dhe nuk bëri asnjë kërkesë për kohë shtesë për të studiuar dosjen e çështjes. Pas ekstradimit, ankuesi është vënë menjëherë në dijeni për akuzat kundër tij. Ai rezervoi të drejtën për të caktuar një avokat të zgjedhur prej tij. Në seancën gjyqësore mbi vlefshmërinë e arrestimit të tij, ai vendosi të përfaqësohej vetë.

118. Për sa i përket pranimit të dëshmimeve, Qeveria argumentoi se dëshmitë e M. dhe Ç. ishin marrë në përputhje me të drejtën e brendshme. A.L. dha dëshminë e tij në gjyq dhe u pyet nga pala kundërshtarë. Deklarimi i ankuesit i datës 6 maj 2001 nuk u pranua si provë. Eksperti i mjekësisë ligjore dha dëshminë e tij në gjyq dhe u pyet nga ankuesi. Kërkesat e ankuesit të datave 18 dhe 20 shkurt 2002 për përgatitjen e raportit të ekspertit mbi kapacitetin mendor dhe psikologjik të P.G. u rrëzuan si haptazi të pabazuara.

119. Qeveria argumentoi se gjykata e shkallës së parë ishte e autorizuar t'i jepte fakteve një përcaktim të ri, sipas nenit 375 të KPP-së. Për më tepër, ndërmjet datave 20 shkurt dhe 8 mars 2002, gjykata kishte shtyrë dy seanca gjyqësore, me qëllim që t'i jepte ankuesit mundësinë të parashtronte deklarin e tij. Më 8 mars 2002, ajo rrëzoi kërkesën e ankuesit për kohë shtesë si të paarsyeshme.

120. Qeveria më tej parashtrori se z. Berisha ishte thirrur disa herë, por pa sukses për të dhënë dëshminë e tij. Megjithatë, ai nuk ishte dëshmitari vendimtar as për prokurorin dhe as për ankuesin. Ai gëzonte imunitet parlamentar, heqja e të cilit nga Parlamenti ishte kushti paraprak për të dëshmuar. Bazuar në *A. v. Mbretërisë së Bashkuar* (nr. 35373/97, ECHR 2002-X), Qeveria argumentoi se imuniteti parlamentar i z. Berisha nuk impononte kufizim të tepruar për mbrojtjen e të drejtave të ankuesit. Për më tepër, arsyet e sigurisë shpjegonin mosparaqitjen e tij. Në dritën e përpjekjeve për të vvarë z. Berisha, siguria e tij personale nuk mund të grantohet në gjyq.

121. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, vendimet e gjykatave të brendshme ishin të arsyetuara dhe bazoheshin në disa dëshmi të dëshmitarëve.

#### 2. Vlerësimi i Gjykatës

##### a) Parime të përgjithshme

122. Duke qenë se garancitë e paragrafit 3 të nenit 6 përbëjnë aspektet specifike të së drejtës për gjykim të drejtë, përcaktuar në paragrafin 1, Gjykata shqyrton ankimet e ankuesit sipas dy dispozitave të marra së bashku (shih, *inter alia*, *A.S. v. Finland*, nr. 40156/07, § 47, 28 shtator 2010).

123. Dispozitat e paragrafit 3(a) të nenit 6 theksojnë domosdoshmërinë për t'i kushtuar vëmendje të veçantë vënies në dijëni të pandehurit për "akuzën". Të dhënat e hollësishme të veprës luajnë rol vendimtar në procesin penal, për faktin që pikërisht nga momenti i njoftimit të tyre i pandehuri vihet në dijëni zyrtarisht me shkrim mbi bazën faktike dhe ligjore të akuzave kundër tij (shih, *Kamanski k. Austrisë*, vendim i datës 19 dhjetor 1989, seria A, nr. 168, pp. 36-37, § 79). Neni 6 § 3 (a) i Konventës i njeh të pandehurit të drejtën të informohet jo vetëm për "shkakun" e akuzës, që do të thotë veprimet që ai pretendohet se ka kryer dhe mbi të cilat bazohet akuzat, por edhe karakterizimin ligjor që i është dhënë këtyre veprimeve. Ky informacion duhet të jetë i detajuar (shih *Pélissier dhe Sassi k. Francës*, [GC], nr. 25444/94, § 51, ECHR 1999-II). Gjithashtu, objekti dhe qëllimi i nenit 6 §§ 1 dhe 3 tregojnë se një person i akuzuar për një vepër penale "ka të drejtë të marrë pjesë në një seancë gjyqësore dhe të dëgjohet" në praninë e tij nga një "gjykatë" (shih, ndër të tjera, *Barberá, Messegué dhe Jabardo k. Spanjës*, 6 dhjetor 1988, §§ 68 dhe 78, seria A, nr. 146).

124. Ndërkohë që neni 8 garanton të drejtën për gjykim të drejtë, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e dëshmisë si të tillë, gjë që përbën kryesisht një çështje për rregullim sipas të drejtës së brendshme (shih *Schenk k. Zvicër*, 12 korrik 1988, § 45, seria A, nr. 140; *Teixeira de Castro k. Portugalisë*, 9 qershor 1998, § 34, raportet 1998-IV; *Jalloh k. Gjermanisë* [GC], nr. 54810/00, §§ 94-96, ECHR 2006-IX, dhe *Bykov k. Rusisë* [GC], nr. 4378/02, § 88, ECHR 2009-...). Për rrjedhojë, nuk është roli i Gjykatës të vendosë, parimisht, nëse lloje të veçanta provash – për shembull, prova të marra në mënyrë të paligjshme në lidhje me të drejtën e brendshme – mund të jenë të pranueshme, ose, në të vërtetë, nëse ankuesi ishte apo jo fajtor. Pyetja që kërkon përgjigje është nëse kanë qenë të drejta procedimet në tërësi, përfshirë mënyrën në të cilën janë marrë provat. Kjo përfshin shqyrtimin e "paligjshmërisë" në fjalë dhe, për sa i përket Konventës, natyrën e shkeljes së konstatuar (shih, ndër të tjera, *Khan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 35394/97, § 34, ECHR 2000-V; *P.G. dhe J.H. k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 44787/98, § 76, ECHR 2001-IX; *Heglas k. Republikës Çeke*, nr. 5935/02, §§ 89-92, 1 mars 2007; *Allan k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 48539/99, § 42, ECHR 2002-IX, dhe *Bykov*, citur më lart, § 89).

125. Në përcaktimin nëse procedimet në tërësi ishin të drejta, duhet t'i kushtohet rëndësi faktit nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në veçanti, duhet të shqyrtohet nëse ankuesit i është dhënë mundësia të kundërshtojë vërtetësinë e provave dhe përdorimin e tyre. Gjithashtu, duhet të merret në konsideratë cilësia e provave, duke përfshirë faktin nëse rrethanat në të cilat

janë marrë provat hedhin dyshime mbi bazueshmërinë apo saktësinë e tyre. Ndërkohë që nuk ngrihet domosdoshmëri problem i drejtësisë kur provat e marra nuk janë mbështetur nga materiale të tjera, mund të vërehet se kur provat janë shumë të forta dhe nuk ekziston risku të jenë të pabazueshme, domosdoshmëria për prova mbështetëse është përkatësisht më e dobët (shih, *mutatis mutandis*, *Khan* §§ 35 dhe 37, *Allan*, § 43, dhe *Bykov*, § 90, të gjitha cituar më lart).

126. As forma dhe as përmbajtja e nenit 6 të Konventës nuk pengojnë një person që me vullnetin e tij të lirë, të heqë dorë në mënyrë të shprehur ose nënkuptuar, nga e drejta e garantimit të një gjykimi të drejtë, duke përfshirë të drejtën për të pyetur dhe të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët që kanë dëshmuar kundër tij (shih *Hermi k. Italisë*, [GC], nr. 18114/02, § 73, ECHR 2006-XII). Megjithatë, heqja dorë nuk duhet të jetë në kundërshtim me asnjë interes të rëndësishëm publik, duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe kërkon garancitë minimale në përpjesëtim me rëndësinë e heqjes dorë (shih *Blake k. Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 68890/01, § 127, 26 shtator 2006).

#### a) Zbatimi i parimeve të përgjithshme për çështjen konkrete

127. Gjykata vëren se, në seancën gjyqësore të datës 7 maj 2001, në lidhje me ligjshmërinë e arrestimit të tij, ankuesi u përfaqësua vetë, megjithëse, një ditë më parë, atij iu tërhoq vëmendja në të drejtën e tij për të zgjedhur një avokat (shih paragrafin 30 më lart). Ai nuk ngriti asnjë çështje në këtë drejtim në apel. Për më tepër, caktimi nga ana e ankuesit të një avokati të zgjedhur prej tij, është pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Në seancën gjyqësore të datës 11 maj 2001, avokati i ankuesit kërkoi vazhdimin e gjykimit.

128. Në lidhje me pranimin e provave të marra në mënyrë të paligjshme, Gjykata vëren se gjykatat e brendshme rrëzuan dëshmitë e Ç. dhe M. si kontradiktore dhe që u mungon besueshmëria dhe nuk u bazua në to. Dukej se dëshmia e A.L. e datës 8 maj 2001 fillimisht u fsheh nga mbrojtja. Megjithatë, çdo padrejtësi e shkaktuar prej saj, është ndrequr nga gjykata e shkallës së parë, e cila siguroi se A.L. dëshmoi. Ankuesi dhe avokati i tij morën pjesë në seancën gjyqësore dhe pyetën palën kundërshtare – A.L. Deklarimi i ankuesit, i datës 6 maj 2001, nuk u pranua dhe as nuk u përdor si provë për dënimin e tij.

129. Gjykata e shkallës së parë rrëzoi kërkesën tjetër të ankuesit për kohë për të dhënë prova shtesë më 8 mars 2002, ka shumë të ngjarë, duke pasur parasysh dëshminë e detajuar që ai tashmë kishte dhënë më 27 korrik 2001. Dosja e çështjes nuk zbulon natyrën e "provave shtesë" që ankuesi dëshironte të jepte. Në çdo rast, ai kishte mundësinë për të bërë dhe, në të vërtetë bëri, parashtrime të detajuara me shkrim në apel.

130. Për sa i përket mosparaqitjes së z. Berisha në gjyq, Gjykata thekson se paragrafët 1 dhe 3 (d) të nenit 6 kërkojnë që të pandehurit t'i jepet mundësia të kundërshtojë dhe të pyesë një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai jep deklaratimet e tij, qoftë në një fazë të mëvonshme (shih, ndër të tjera, *Sadak dhe të tjerë k. Turqisë* (nr. 1), nr. 29900/96, 29901/96, 29902/96 dhe 29903/96, § 64, 17 korrik 2001). Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se z. Berisha nuk ishte dëshmitar okular. Ai nuk bëri asnjë deklaratë gjatë hetimit dhe nuk dëshmoi në gjyq. Deklarata e tij e datës 12 shtator 1998 nuk u paraqit si provë në gjyq, e aq më pak nuk shërbeu si bazë nga gjykatat e brendshme kundër ankuesit. Ankuesi nuk tregoi mënyrën se si dëshmia e z. Berisha mund të kishte qenë vendimtare për të vërtetuar pafajësinë e tij të akuzave.

131. Në disa raste, gjykata e shkallës së parë mori masa, megjithëse pa sukses, për të thirrur z. Berisha. Në parashtrimet e tij pranë kësaj Gjykate, ankuesi u bazua në nenet 162 dhe 364 § 1 të KPP-së si mënyra alternative që autoritetet duhet të kishin përdorur për të mundësuar atë të pyeste z. Berisha (shih paragrafin 116 më lart). Megjithatë, dukej se ankuesi nuk iu drejtua asnjëherë dispozitave të mësipërme në ankimet e tij të brendshme. Për më tepër, dënimi i ankuesit është bazuar dhe vërtetuar, *inter alia*, nga dëshmitë e dëshmitarëve A.L., S.L., P.G. dhe G.B. Gjykata nuk konstaton asnjë element arbitrariteti apo paarsyeshmërie në vlerësimin e këtyre pjesëve të rëndësishme të provave.

132. Në vlerësimin e drejtësisë së procedimeve penale në tërësi, Gjykata ka pranuar se përcaktimi i një veprë nuk dëmton të drejtat e mbrojtjes nëse i pandehuri, në procedurat e rishikimit, kishte mundësi të mjaftueshme për t'u mbrojtur vetë (shih *Dallos k. Hungarisë*, nr. 29082/95, §§ 47-53, 1 mars 2001; dhe *Sipavić k. Lituanisë*, nr. 49093/99, § 30, 21 shkurt 2002). Në çështjen në fjalë, ankuesi kundërshtoi dënimin e tij, si dhe përcaktimin e veprës para Gjykatës së Apelit, e cila ishte kompetente për të trajtuar këtë çështje. Ajo e rrëzoi ankimin duke dhënë arsye të mjaftueshme. Gjykata e Lartë shqyrtoi, gjithashtu, një tjetër ankim në lidhje me përcaktimin e veprës. Kjo gjykatë ishte kompetente për t'i siguruar të pandehurit lehtësirat që kërkonte (shih paragrafin 91 më lart), por në mënyrë të arsyeshme ajo i rrëzoi parashtrimet.

133. Gjykata për pasojë vlerëson se, duke pasur parasysh faktet e dosjes së çështjes, veçanërisht parashtrimet përfundimtare të prokurorit në gjyq, përcaktuar në vendimin e Gjykatës së Rrethit (shih paragrafin 76 më lart), nuk mund të thuhet se ankuesi nuk mund të parashikonte përcaktimin e akuzës penale kundër tij. Ankuesi kishte kohën dhe lehtësirat e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen për akuzën e riformuluar. Në këtë drejtim, çështja në fjalë duhet të dallohet nga çështja *Pélissier* dhe *Sassi* përmendur më

lart, ku Gjykata e Kasacionit nuk rishqyrtoi "diskrecionin" e gjykatës së apelit në përcaktimin e akuzës. Fakti që, në çështjen në fjalë, ankimet e ankuesit janë rrëzuar, nuk tregon se procedurat e rishikimit nuk ishin në gjendje të ndreqnin mangësitë e procedimeve të shkallës së parë.

134. Në përfundim, Gjykata vëren se, në të gjitha fazat e procedimeve të brendshme, ankuesi është përfaqësuar nga një avokat i zgjedhur prej tij, ka marrë pjesë pothuajse në të gjitha seancat gjyqësore përkatëse, ka pasur mundësinë të parashtrijë prova dhe të pyesë shumë dëshmitarë.

135. Duke pasur parasysh vlerësimet e mësipërme, Gjykata vlerëson se procedimet e brendshme, në tërësi, nuk zbulojnë asnjë element të padrejtësisë procedurale. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) të Konventës në këtë drejtim.

## II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 2 TË KONVENTËS

136. Ankuesi u ankua se deklarata e z. Berisha, në datën 12 shtator 1998, e privoi atë nga përfitimi i prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6 § 2 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"2. Çdo person i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm deri kur të vërtetohet fajtor sipas ligjit."

137. Gjykata thekson se prezumimi i pafajësisë parashikuar në nenin 6 § 2, është një nga elementet e gjykimit të drejtë. Ai shkelet nëse një deklaratë e një zyrtari publik në lidhje me një person të akuzuar për veprë penale pasqyron opinionin se ai është fajtor para se të jetë vërtetuar si i tillë sipas ligjit (shih, për shembull, *Shuvalov k. Estonisë*, nr. 14942/09, § 75, 29 maj 2002; dhe, *mutadis mutandis*, *Allenet de Ribemont k. Francës*, nr. 15175/89, § 35, 10 shkurt 1995). Për të zbuluar nëse një deklaratë e një zyrtari publik është në shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, duhet të vendoset në kontekstin e rrethanave të veçanta në të cilat është bërë deklarata e vënë në dyshim (shih *Daktaras k. Lituanisë*, nr. 42095/98, § 43, ECHR 2000-X).

138. "Akuza", për qëllimet e nenit 6, mund të përcaktohet si "njoftimi zyrtar që i bëhet një individ nga autoriteti kompetent për pretendimin se ka kryer një veprë penale", një përkufizim që, gjithashtu, korrespondon me testin nëse "situata e të [pandehurit] është ndikuar negativisht në mënyrë të konsiderueshme" (shih, për shembull, *McFarlane k. Irlandës* [GC], nr. 31333/06, § 143, 10 shtator 2010).

139. Duke iu kthyer fakteve të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se deklarata e z. Berisha, asnjë kopje e së cilës nuk i është paraqitur Gjykatës, është bërë më 12 shtator 1998. Është e qartë se deklarata është dhënë para se të jetë bërë "akuza" kundër ankuesit ose para se "situata e tij të jetë ndikuar negativisht në mënyrë të konsiderueshme". Megjithatë, deklarata ishte pjesë e tillë e pronës publike në masën që më 15 dhjetor 1999,

më shumë se një vit pasi është bërë, Gjykata e Rrethit akoma u bazua në të duke urdhëruar arrestimin e ankuesit. Për rrjedhojë, mund të vlerësohet se ka pasur impakt të vazhdueshëm.

140. Gjykata më tej thekson se ka konstatuar shkelje të nenit 6 § 2 të Konventës kur kundër ankuesit janë bërë deklarata paragjyquese në shtyp, para se ai të deklarohej zyrtarisht fajtor nga persona, të tillë si: agjentë policie të përfshirë në hetim (*Maksim Petrov k. Rusisë*, nr. 23185/03, 6 nëntor 2012), oficerë policie të nivelit të lartë (*Dovzhenko k. Ukrainës*, nr. 36650/03, 12 janar 2012; *Allenet de Ribemont k. Francës*, 10 shkurt 1995, seria A, nr. 308), Ministra (*G.C.P. k. Rumanisë*, 20899/03, 20 dhjetor 2011; dhe *Allenet de Ribemont*, cituar më lart), Kryeministri (*Konstas k. Greqisë*, nr. 53466/07, 24 maj 2011), kryetari i Parlamentit (*Butkevičius k. Lituanisë*, nr. 48297/99, ECHR 2002-II (ekstrakte)), titullari i shërbimit të shtypit të Ministrisë së Brendshme (*Huseyn dhe të tjerë k. Azerbajxhanit*, nr. 35485/05, 45553/05, 35680/05 dhe 36085/05, 26 korrik 2011) dhe prokurori i përgjithshëm (shih G.C.P., cituar më lart; *Fatullayev k. Azerbajxhanit*, nr. 40984/07, 22 prill 2010; dhe *Butkevičius*, cituar më lart).

141. Duke pasur parasysh praktikën ligjore të mësipërme dhe pavarësisht faktit se ankuesi nuk iu referua shkeljes së nenit 6 § 2 të Konventës para gjykatave të brendshme, Gjykata vlerëson se z. Berisha nuk mund të vlerësohet se ka vepruar si zyrtar publik në kuptim të nenit 6 § 2 të Konventës. Z. Berisha nuk është përfshirë në hetimin penal të vrasjes së AP si oficer policie, hetues apo prokuror. Ai nuk kishte ndonjë detyrë publike apo ushtronte autoritet publik dhe, në të vërtetë, asnjë kompetencë nuk i është deleguar zyrtarisht nga ndonjë organ shtetëror. Z. Berisha veproi si një individ privat, në cilësinë e tij si kryetari i një partie politike, e cila ishte ligjërisht dhe financiarisht e pavarur nga shteti. Deklarata e tij, e cila u bë në një klimë të ndezur politike, mund të konsiderohej si dënimi i partisë së tij ndaj vrasjes së AP. Si e tillë, fakti i thjeshtë se veprimet e tij mund të kenë qenë të dobishme nga ana sociale me kërkesën që drejtësia të vihet në vend, nuk e shndërron atë në një zyrtar publik që vepron në interesin publik (shih, *mutadis mutandis*, *Kotov k. Rusisë* [GC], nr. 54522/00, §§ 91-107, 3 prill 2012).

142. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ky ankim duhet të deklarohej i papranueshëm si haptazi i pabazuar në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

### III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 7 TË KONVENTËS

143. Ankuesi duket se i referohet nenit 7 § 1 të Konventës bazuar në faktin se ai u deklarua fajtor sipas nenit 78 § 2 të KP-së, i cili nuk përbënte veprë penale sipas së drejtës së brendshme në kohën kur është kryer vepra.

Neni 7 § 1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Askush nuk mund të dënohet për një veprim ose një mosveprim, që në momentin kur është kryer nuk përbënte veprë penale, sipas së drejtës së brendshme ose ndërkombëtare. Po ashtu, nuk mund të jepet një dënim më i rëndë se ai që ishte i zbatueshëm në momentin kur është kryer vepra penale.”

144. Gjykata vëren se, në ankimet e brendshme, ankuesi u ankua shprehimisht për përcaktimin e paligjshëm të pretenduar të veprës penale nga gjykatat e brendshme, duke argumentuar se nuk janë respektuar të drejtat e tij të mbrojtjes. Ai nuk ngriti asnjë ankim, të paktën në thelb, në kuptimin që janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 7 të Konventës.

145. Në këto rrethana, Gjykata rrëzon ankimin e ankuesit për mosshkrim të mjeteve të brendshme ligjore në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

### PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT

1. *Deklaron* ankimet e ankuesit sipas nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) të pranueshme dhe pjesën e mbetur të ankimit të papranueshëm.

2. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 dhe 3 (a) deri (d) të Konventës.

Bërë në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 8 tetor 2013, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Françoise Elens-Passos**  
SEKRETAR

**Ineta Ziemele**  
KRYETAR

SEKSIONI I KATËRT  
**ÇËSHTJA SHERO VOGLI KUNDËR SHQIPËRISË**  
*Ankimi nr. 18343/11*

### VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt), e mbledhur në datën 15 tetor si Komitet i përbërë nga:

David Thór Björgvinsson, president

Vincent A. De Gaetano,

Krzysztof Woljtyczek, gjykatës,

dhe Françoise Elens-Passos, regjistruer Seksioni,

Duke marrë në konsideratë ankimin e mësipërm të depozituar në datën 7 mars 2011,

Duke marrë në konsideratë deklaratat zyrtare që pranojnë një zgjidhje miqësore të çështjes,

Pas shqyrtimit, të çështjes, vendos si më poshtë:

**FAKTET DHE PROCEDURA**

Ankuesja, znj. Shero Vogli është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur, në vitin 1955, dhe banuese në Tiranë.

Qeveria shqiptare (“Qeveria”) u përfaqësua nga agjenti i saj nga Avokatura e Shtetit, znj. L. Mandia.

Ankuesi u ankua se ka pasur një shkelje të neneve 6 § 1 dhe 13 të Konventës për shkak të moszbatimit të një vendimi të formës së prerë të dhënë në favor të saj.

Në datat 30 janar dhe 26 shkurt dhe në vitin 2013, Gjykata mori deklaratat për zgjidhjen miqësore të nënshkruara nga palët sipas të cilave ankuesja kishte rënë dakord të hiqte dorë nga pretendime të mëtejshme kundër Shqipërisë në lidhje me faktet mbi të cilat bazohet ankimi kundër një angazhimi nga Qeveria për t'i paguar asaj 7,500 (shtatë mijë e pesëqind euro) për mbulimin e çdo dëmi monetar dhe jomonetar, si dhe për kostot dhe shpenzimet që do të konvertohen në monedhën vendase në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe nuk do t'u nënshtrohen taksave që mund të jenë të zbatueshme. Kjo shumë do të jetë e pagueshme brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të marrë nga Gjykata. Në rast mospagimi brenda periudhës së lartpërmendur tremujore, Qeveria mori përsipër të paguajë interes të thjeshtë për të, nga mbarimi i periudhës deri në shlyerje, në një normë të barabartë me normën e huadhënies marzhinale të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit të interesave plus tri pikë për qind. Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

#### E DREJTA

Gjykata vëren zgjidhjen miqësore të arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut që përcaktohen në Konventë dhe protokollin e saj dhe nuk konstaton asnjë arsye për justifikimin e vazhdimin të shqyrtimit të ankimit. Sa më sipër, është e përshtatshme që çështja të fshihet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata unanimisht

Vendos të fshijë ankimin nga lista e çështjeve në përputhje me nenin 39 të Konventës.

**Françoise Elens-Passos**      **David Thór Björgvinsson**  
REGJISTRUES                      PRESIDENT

### SEKSIONI I KATËRT ÇËSHTJA IZET HAXHIA KUNDËR SHQIPËRISË (Ankimi nr. 34783/06)

VENDIM  
STRASBURG  
5 nëntor 2013

*Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.*

#### Në çështjen Izet Haxhia kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Katërt i Mëparshëm), duke gjykuar si Dhomë e përbërë nga:

Ineta Zieme, *president*  
David Thór Björgvinsson,  
George Nicolaou,  
Zdravka Kalaydjieva,  
Vincent A. De Gaetano,  
Paul Mahoney, *gjykatës*,

Altina Xhoxhaj, *gjykatës ad hoc*,  
dhe Françoise Elens-Passos, *regjistruer i Seksionit*,  
Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 15 tetor 2013,  
shpall vendimin e mëposhtëm të miratuar në atë datë:  
PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 34783/06) kundër Republikës së Shqipërisë, të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga shtetasi shqiptar, z. Izet Haxhia ("ankuesi") më 28 gusht 2006.

2. Ankuesi u përfaqësua nga z. F. Shanaj dhe z. Sh. Dizdari, avokatë që ushtrojnë profesionin në Tiranë. Qeveria shqiptare ("Qeveria") u përfaqësua fillimisht nga agentët e atëhershëm të saj, znj. S. Mëneri e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Shqipëri dhe znj. Ledi Hajro nga zyra e Avokatit të Shtetit dhe, më pas, nga znj. L. Mandia nga zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, gjykatës i zgjedhur për Shqipërinë, nuk ishte në gjendje të gjykonte çështjen (neni 28 i rregullores së Gjykatës). Për rrjedhojë, presidenti i Dhomës vendosi të caktojë znj. Altina Xhoxhaj si gjykatëse *ad hoc* në vend të tij (neni 29 § 1(b)).

4. Ankuesi pretendoi disa shkelje sipas neneve 5, 6 dhe 7 të Konventës.

5. Më 17 mars 2008, presidenti i Seksionit të Katërt, të cilit i është caktuar çështja, vendosi të njoftonte Qeverinë mbi ankimin. Gjithashtu, u vendos të shqyrtohej pranueshmëria dhe meritat e ankimit në të njëjtën kohë (neni 29 § 1).

#### FAKTET

##### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

6. Ankuesi ka lindur në vitin 1966. Ai ishte truproja i presidentit të atëhershëm të Shqipërisë, z. Sali Berisha. Në kohën e paraqitjes së ankimit, ai është ndaluar në Turqi në pritje të rezultatit për ekstradimin e tij në Shqipëri.

7. Më 12 shtator 1998, rreth orës 21:15, z. Azem Hajdari, anëtar parlamenti ("AP") dhe truprojat e tij, B.C. dhe Z.N. u qëlluan ndërkohë që po dilnin nga selia e Partisë Demokratike ("PD") në Tiranë. Zoti Hajdari dhe B.C. vdiqën në të njëjtën ditë në spital. Truproja e dytë, Z. N. u plagos rëndë. Zoti Hajdari ishte anëtar drejtues i PD-së, e cila ishte një nga dy partitë kryesore politike në Shqipëri dhe, në kohë materiale, në opozitë. Për këtë vrasje u hap hetimi penal.

8. Më 13 janar 2001, prokuroria lëshoi urdhërarrestin për ankuesin, si i dyshuar për përfshirjen e tij në vrasjen e AP dhe një prej truprojave të tij, si dhe për vrasjen e mbetur në tentativë të truprojës tjetër. Gjithashtu, prokurori urdhëroi arrestimin e katër personave të tjerë në lidhje me këtë vrasje.

9. Më 31 janar 2001, Gjykata e Rrethit Tiranë ("Gjykata e Rrethit") urdhëroi arrestimin e ankuesit. Ai u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga gjykata.



10. Më 3 mars 2001, Gjykata e Rrethit e deklaroi ankuesin në mungesë pas përpjekjeve pa sukses për të gjetur vendndodhjen e tij. Sipas vendimit, familja e ankuesit nuk kishte dijeni për vendndodhjen e tij. Fqinjët, gjithashtu, pohuan se prej dy vjetësh askush nuk kishte banuar në banesën e ankuesit.

11. Më 13 mars 2001, prokurori depozitoi një aktakuzë pranë Gjykatës së Rrethit. Ankuesi dhe katër të bashkëpandehurit e tjerë akuzoheshin për pjesëmarrjen dhe organizimin e vrasjes së AP, trupprojës së tij dhe vrasjes së mbetur në tentativë të civilëve.

12. Procedimet gjyqësore kundër ankuesit janë kryer në mungesë. Ai u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga familja e tij sipas nenit 48 § 3 të Kodit të Procedurës Penale ("KPP").

13. Më 29 prill 2001, Gjykata e Rrethit e dënoi ankuesin në mungesë. Ai u dënua me njëzet e pesë vjet burgim.

14. Avokati i ankuesit, i caktuar nga familja, si dhe i të bashkëpandehurve të tjerë ankuan kundër dënimit në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë.

15. Më 9 korrik 2002 dhe 14 shkurt 2003, Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë, respektivisht, lanë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit. Ankuesi u përfaqësua nga një avokat i caktuar nga familja.

16. Avokati i caktuar nga familja nuk depozitoi ankim kushtetues për shkak të mungesës së prokurës për të bërë një gjë të tillë. Ankimet kushtetuese të dy prej të bashkëpandehurve, në lidhje me padrejtësinë e përgjithshme të procedimeve, u deklaruan të papranueshme nga Gjykata Kushtetuese, më 9 korrik 2003, me arsyetimin se ankimet nuk zbulonin shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë.

17. Një përshkrim i detajuar i fakteve, hetimit penal dhe vendimeve të gjykatave të brendshme, është përshkruar në çështjen *Haxhia k. Shqipërisë*, nr. 29861/03, 8 tetor 2013, për të cilën akoma nuk është dhënë vendimi i formës së prerë dhe çështjen *Mulosmani k. Shqipërisë*, nr. 298618/03, tetor 2013, për të cilën akoma nuk është dhënë vendimi i formës së prerë.

18. Më 3 qershor 2006, ankuesi u arrestua nga autoritetet turke, me sa duket mbi bazën e një urdhërarresti të lëshuar nga autoritetet shqiptare. Dukej se autoritetet shqiptare kërkonin ekstradimin e ankuesit. Gjykatës nuk i është paraqitur një kopje e kërkesës për ekstradim. Asnjë informacion tjetër nuk është dhënë në lidhje me rezultatin për procedurat e ekstradimit në Turqi.

## II. E DREJTA DHE PRAKTIKA PËRKATËSE E BRENDSHME DHE NDËRKOMBËTARE

### A. E drejta e brendshme

#### 1. Kodi i Procedurës Penale ("KPP")

19. Dispozitat përkatëse të KPP-së në lidhje me caktimin dhe përfaqësimin nga një avokat, parashikojnë si më poshtë:

#### Neni 48 – Mbrojtësi i zgjedhur nga i pandehuri

"1. I pandehuri ka të drejtë të zgjedhë jo më shumë se dy mbrojtës.

2. Zgjedhja bëhet me deklaram të bërë para organit të procedurës ose me akt të dhënë mbrojtësit ose të dërguar atij rekomande.

3. Zgjedhja e mbrojtësit për personin e ndaluar, të arrestuar ose të dënuar me burgim, derisa ky person nuk e ka bërë vetë zgjedhjen mund të bëhet nga një i afërm i tij, në përputhje me procedurat e parashikuara nga paragrafi 2 më lart".

#### Neni 410 – Ankimi i të pandehurit

"2. Kundër vendimit të dhënë në mungesë, mbrojtësi mund të bëjë ankim vetëm kur është i pajisur me një akt përfaqësimi të lëshuar në përputhje me ligjin".

20. Dispozitat përkatëse të KPP-së në lidhje me kërkesën për rivendosje në afat parashikojnë si më poshtë:

#### Neni 147 – Rivendosja në afat

"1. Prokurori, i pandehuri, palët private dhe mbrojtësit mund të kërkojnë rivendosjen në afatin e caktuar kur provojnë se nuk kanë pasur mundësi ta respektojnë afatin për shkak të rasteve të paparashikuara ose të forcës madhore.

2. Në qoftë se është dhënë vendimi në mungesë, i pandehuri mund të kërkojë rivendosjen në afat për të bërë ankim kur provon se nuk ka marrë dijeni për vendimin.

3. Kërkesa për rivendosjen në afat paraqitet brenda dhjetë ditëve nga dita ... kur i pandehuri ka marrë dijeni efektivisht për aktin. Rivendosja në afat nuk lejohet më shumë se një herë për secilën palë për çdo shkallë të procedimit.

4. Për kërkesën vendos organi që procedon në kohën e paraqitjes së saj.

5. Vendimi që lejon rivendosjen në afat për bërjen e ankimit mund të ankimohet vetëm bashkë me vendimin përfundimtar.

6. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për rivendosje në afat mund të bëhet ankim".

#### Neni 148 – Efektet e rivendosjes në afat

"1. Gjykata që ka vendosur rivendosjen në afat, me kërkesën e palës dhe për aq sa është e mundur, urdhëron përsëritjen e veprimeve në të cilat pala kishte të drejtë të merrte pjesë".

21. Nenet 449-461 të KPP-së drejtojnë zbatimin për rishikimin e një vendimi të formës së prerë.

#### Neni 450 – Rastet e rishikimit

"1. Rishikimi mund të kërkohet:

a) kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

b) kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile, i cili është revokuar më pas;

c) kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;

d) kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit;

të akteve të gjykimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale".

22. Kërkesa për rishikim duhet të depozitohet në Gjykatën e Lartë.

2. *Ligji për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në çështjet penale (ligji nr. 10193, datë 3.12.2009)*

23. Seksioni 51 § 4 i ligjit për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në çështjet penale parashikon se "një vendim penal i formës së prerë kundër një personi të ekstraduar, i cili është dhënë në mungesë të

tij, mund të rishikohet me kërkesën e personit, me kusht që ministri i Drejtësisë të ketë siguruar shtetin kërkues në lidhje me këtë. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 30 ditëve nga mbërritja e ankuesit në territorin e Shqipërisë dhe shqyrtimi i saj është subjekt i dispozitave të Kodit të Procedurës Penale”.

**B. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 8577, datë 10 shkurt 2000)**

24. Dispozitat përkatëse të ligjit për Gjykatën Kushtetuese parashikojnë si më poshtë:

Pjesa 30

“1. Depozitimi i ankimit në Gjykatën Kushtetuese është subjekt i afateve të përcaktuara në këtë ligj.

2. Ankimi i një individi për shkeljen e të drejtave të tij kushtetuese mund të paraqitet jo më vonë se dy vjet nga ndodhja e shkeljes. Nëse ligji parashikon mjetin ligjor, individi mund të depozitojë ankimin e tij në Gjykatën Kushtetuese pasi ka shteruar të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të tij. Në raste të tilla, afati për depozitimin e ankimit është dy vjet nga njoftimi i vendimit të organit të shkallës së fundit”.

**C. Praktika ligjore e brendshme**

1. Në lidhje me kërkesën për rivendosjen në afat

**a) Praktika ligjore e gjykatave më të ulëta**

25. Më 3 maj 2007 dhe 10 tetor 2007, Gjykata e Rrethit Gjyrokastër pranoi kërkesat e dy të pandehurve për rivendosjen në afat kundër dënimit të tyre në *mungesë*. Të pandehurit i bënë kërkesat e tyre pasi u ekstraduan në Shqipëri. Ndërkohë, ata depozituan dy ankime më vete pranë Gjykatës (*Hysi k. Shqipërisë*, nr. 72361/11 dhe *Malo k. Shqipërisë*, nr. 72359/11) për drejtësinë e rigjykimin. Këto ankime janë në pritje të datës së miratimit të vendimit konkret.

26. Më 2 nëntor 2010, Gjykata e Rrethit Shkodër pranoi kërkesën e njërit prej të pandehurve për rivendosjen në afat kundër vendimit të tij në *mungesë*. I pandehuri e bëri kërkesën e tij pasi u ekstradua në Shqipëri (shih vendimin e Gjykatës së Lartë nr. 37/2011 për më shumë informacion).

**b) Praktika ligjore e Gjykatës së Lartë**

27. Në vendimin e tij unifikues nr. 2, të datës 14 tetor 2002, Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë vendosi që, duke pasur parasysh karakterin e tij personal rigoroz, kërkesa për rivendosjen në afat duhet të depozitohet vetëm nga i pandehuri ose nga një avokat i zgjedhur prej tij, brenda dhjetë ditëve nga data në të cilën i pandehuri është vënë në dijeni efektivisht për vendimin e dhënë në *mungesë* (vendimi nr. 2/2002). E drejta nuk mund të ushtrohet nga anëtarët e familjes së të pandehurit nëse i pandehuri nuk ishte realisht në dijeni të vendimit në *mungesë*. Kërkesa për rivendosjen në afat duhet të shqyrtohet nga Gjykata e Rrethit, prej një trupi gjyqës të përbërë nga tre gjyqtarë. Vendimi i Gjykatës së Rrethit mund të ankimohet në Gjykatën e Apelit dhe, më pas, në Gjykatën e Lartë. Megjithatë,

konstatimi i fundit është korrigjuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 31/2012 (shih paragrafin 36 më poshtë).

28. Në vendimin e tij unifikues nr. 1 të datës 20 janar 2011, Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë shqyrtoi tri çështje në lidhje me kërkesën për rivendosjen në afat (vendimi nr. 1/2011). Ankuesi ishte dënuar në *mungesë*. Avokatit të tij të caktuar nga familja iu pranua rivendosja në afat kundër dënimit në *mungesë* në Gjykatën e Apelit. Ankimet në vijim të avokatit mbi meritat e çështjes u rrëzuan nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Pas ekstradimit të tij në Shqipëri ankuesit iu pranua rivendosja në afat në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit. Në procedimet para Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë, ankuesi u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej tij.

29. Së pari, Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë vendosi që, kur një ankim është shqyrtuar më parë dhe rrëzuar nga Kolegji i Gjykatës së Lartë, në procedimet në *mungesë* në të cilat i pandehuri është përfaqësuar nga një avokat i caktuar nga familja në përputhje me nenet 48 § 3 dhe 410 § 2 të KPP-së, si i pandehuri ashtu edhe avokati i tij nuk mund të (ri)-depozitojnë kërkesë për rivendosjen në afat kundër vendimit të Gjykatës së Apelit me arsyetimin se i pandehuri nuk është vënë në dijeni të vendimit meqenëse një gjë e tillë është në kundërshtim me parimet e *res judicata*. I njëjti arsyetim zbatohet për kërkesën për rivendosjen në afat kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit.

30. Së dyti, Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë vendosi se i pandehuri ka të drejtë të depozitojë kërkesë për rivendosjen në afat në përputhje me nenin 147 § 1 të KPP-së vetëm kur gjykata më e lartë ka pushuar ankimin si të parashkruar, pa shqyrtuar meritat (themelin) apo ligjshmërinë e ankesave të ngritura në themelin e ankimit.

31. Konstatimi i tretë ka të bëjë me efektin e ankimit të depozituar nga një i pandehur, në *mungesë* të ankimit të bashkëpandehurit, mbi kërkesën e këtij të fundit për rivendosjen në afat. Kolegji i Bashkuar i Gjykatës së Lartë vendosi që, si rregull, “në procedimet penale kundër disa të bashkëpandehurve, gjykata nuk duhet të pranojë kërkesën e një të pandehuri për rivendosjen në afat, nëse është vërtetuar se [meritat] e çështjes janë shqyrtuar pas ankimit të depozituar nga një i bashkëpandehur”.

32. Më 5 tetor 2011, pas kërkesave të dy të pandehurve për rivendosje në afat, Gjykata e Lartë, duke u bazuar në vendimin e saj unifikues nr. 1/2011, refuzoi këto kërkesa (vendimet nr. 121/2011 dhe 122/2011). Gjykata e Lartë vendosi që avokatët e të pandehurve, të cilët ishin caktuar nga anëtarët e familjes në përputhje me nenet 48 § 3 dhe 410 § 2 të KPP-së,

kishin ankuar më parë dhe pa sukses kundër dënimit të pandehurve në *mungesë*, si në Gjykatën e Apelit ashtu edhe në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, dënimi i tyre në *mungesë* “kishte marrë fuqinë e *res judicata*”, e cila ndalonte rigjykimin.

33. Pas ekstradimit nga Italia, një i pandehur depozitoi një kërkesë për rivendosjen në afat. Më 12 tetor 2011, duke u bazuar në vendimin e saj unifikues nr. 1/2011, Gjykata e Lartë e refuzoi këtë kërkesë me arsyetimin se avokati i të pandehurit, i caktuar nga familja kishte ankuar më parë dhe pa sukses kundër dënimit të të pandehurit në *mungesë*, si në Gjykatën e Apelit ashtu edhe në Gjykatën e Lartë (vendimi nr. 218/2012).

34. Më 5 shtator 2012, duke u bazuar në vendimin e saj unifikues nr. 1/2011, Gjykata e Lartë vendosi, *inter alia*, se gjykata më e ulët kishte gabuar në pranimin e të pandehurit për rivendosjen në afat, meqenëse avokati i të pandehurit i caktuar nga familja kishte ankuar më parë dhe pa sukses kundër dënimit të pandehurit në *mungesë* (vendimi nr. 218/2012).

#### c) Praktika ligjore e Gjykatës Kushtetuese

35. Në përgjigje të një kërkesë referimi të Gjykatës së Lartë mbi kushtetutshmërinë e neneve 48 § 3 dhe 410 § 2 të KPP-së, Gjykata Kushtetuese vendosi, me anë të vendimit nr. 30, datë 17 qershor 2010 (vendimi nr. 30/2010), se caktimi i avokatit nga një anëtar i familjes duhet të pranohet nga gjykatat e brendshme, në qoftë se mund të përcaktohet se kjo përbën një manifestim të shprehur të qëllimit të të pandehurit për të mos ndjekur procedimet. I njëjti arsyetim zbatohet për kërkesën për rivendosjen në afat të bërë nga avokati i caktuar nga familja e të pandehurit. Autoritetet duhet të përcaktojnë se i pandehuri nuk ka qenë efektivisht në dijeni të dënimit të tij në *mungesë* dhe se i pandehuri ka qenë efektivisht në dijeni të caktimit të avokatit nga familja e tij.

36. Në përgjigje të një kërkesë referimi të Gjykatës së Lartë mbi kushtetutshmërinë e neneve 147 §§ 4 dhe 6 të KPP-së, nëpërmjet vendimit nr. 31, datë 17 maj 2012 (vendimi nr. 31/2012), Gjykata Kushtetuese sqaroi se termi “organi procedues”, parashikuar nga neni 147 § 4 i referohej gjykatës kundër vendimit të së cilës i pandehuri kërkon rivendosjen në afat. Nëse i pandehuri do të kërkonte rivendosjen në afat kundër vendimit të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa për rivendosjen në afat duhet të depozitohet dhe shqyrtohet nga gjykata e apelit në vend të Gjykatës së Rrethit. Ajo që ngatërroi interpretimin e përkufizimit të mësipërm është përdorimi i fjalëve “në gjykatën e apelit” në nenin 147 § 6 të KPP-së. Gjykata Kushtetuese vendosi se këto fjalë ishin jokushtetuese dhe se mund të zëvendësoheshin me fjalët “në një gjykatë më të lartë”. Meqenëse neni 147 i KPP-së nuk parashikonte të drejtën [direkte] të palëve për të ankuar kundër vendimit që ka miratuar rivendosjen në afat (neni 147 § 5 i KPP-së) në

kundërshtim me të drejtën e palëve për të ankuar kundër vendimit që ka refuzuar rivendosjen në afat (neni 147 § 6 i KPP-së), Gjykata Kushtetuese më tej vendosi që legjislatura duhet të parashikojë më vete të drejtën e palëve për të apeluar kundër miratimit të kërkesës për rivendosjen në afat para shqyrtimit të meritave të ankimit. Ligji si i tillë nënkuptonte se, në shqyrtimin e meritave, Gjykata e Lartë do të duhej, gjithashtu, të shqyrtonte ligjshmërinë dhe themelin e ankimit për rivendosjen në afat, gjë që nuk ishte në përputhje me natyrën e procedimeve para kësaj shkalle.

2. Në lidhje me ankimin për rishikimin e vendimit të formës së prerë

37. Më 17 shtator 2010, Gjykata e Lartë vendosi se personi i ekstraduar mund të bënte kërkesën për rishikimin e dënimit të formës së prerë në *mungesë*, sipas nenit 450 të KPP-së, me kusht që ministri i Drejtësisë të ketë siguruar shtetin të cilit i kërkohet ekstradimi se personi i ekstraduar do të rigjykohej pas ekstradimit (vendimi nr. 812/2010). Në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë u bazua në nenin 3 të protokollit të dytë shtesë të Konventës Evropiane për Ekstradimin, e cila është ratifikuar nga Shqipëria dhe, rrjedhimisht, fitoi përparësi mbi të drejtën e brendshme në përputhje me Kushtetutën, si dhe në seksionin 51 § 4 të ligjit për marrëdhëniet juridiksionale në çështjet penale (shih paragrafët 23 më lart dhe 42 më poshtë). Në këtë rast, ankuesi është ekstraduar nga Spanja, duke u bazuar në sigurimin e ministrit të Drejtësisë se ai do të rigjykohej. Gjykata e Lartë e pranoi kërkesën e tij për rishikimin e dënimit në *mungesë* sipas nenit 450 të KPP-së, me të gjitha arsyet e shteruara të rishikimit të renditura në nenin 450.

38. Më 19 janar 2011, Gjykata e Lartë, duke u bazuar në vendimin e saj nr. 812/2010, pranoi kërkesën e ankuesit për rishikimin e dënimit të tij në *mungesë* sipas nenit 450 të KPP-së (vendimi nr. 9/2011). Ankuesi u ekstradua nga Mbretëria e Bashkuar, duke u bazuar në sigurimin e ministrit të Drejtësisë se ai do të rigjykohej.

39. Më 16 shkurt 2011, Gjykata e Lartë, pranoi kërkesën e ankuesit për rishikimin e dënimit të tij në *mungesë* sipas nenit 450 të KPP-së (vendimi nr. 33/2011). Ankuesi u ekstradua nga Gjermania, duke u bazuar në sigurimin e ministrit të Drejtësisë se ai do të rigjykohej.

3. Në lidhje me mundësinë për të depozituar ankimin kushtetues

40. Në vendimin nr. 30, të datës 26 nëntor 2009, Gjykata Kushtetuese pranoi ankimin kushtetues të ankuesit kundër gjykimin të tij në *mungesë*, pas ekstradimit të tij në Shqipëri. Ankuesi ishte dënuar me një vendim të formës së prerë nga Gjykata e Lartë, më 24 mars 2000, në *mungesë*, dhe ishte ekstraduar në Shqipëri më 4 qershor 2008. Gjykata Kushtetuese konstatoi shkelje të së drejtës për mbrojtje të ankuesit

për shkak të moscaktimit nga ana e gjykatave të brendshme të një avokati për ta përfaqësuar atë.

41. Në vendimin nr. 83, të datës 5 korrik 2013 dhe 118 të datës 30 tetor 2012, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ankuesit nuk kishin depozituar ankim kushtetues kundër vendimit të tyre në mungesë brenda afatit dyvjeçar të njohur me ligj, afat, i cili kishte filluar ditën që janë ekstraduar në Shqipëri. Në të dyja rastet, ankuesit u dënuan më vete në mungesë me vendim të Gjykatës së Lartë, përkatësisht në vitin 2001 dhe 2004. Ata u ekstraduan në një datë të pacaktuar në vitin 2007, njëri nga Mbretëria e Bashkuar dhe tjetri nga Gjermania. Pas ekstradimit, ata depozituan kërkesat për rivendosjen në afat, por këto kërkesa u rrëzuan nga Gjykata e Lartë, respektivisht më 6 maj 2011 dhe 19 janar 2012. Gjykata Kushtetuese vendosi që, duke pasur parasysh vendimin unifikues nr. 1/2011 (shih paragrafin 28 më lart) të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të mos pranohet që ankuesit të depozitojnë kërkesat për rivendosjen në afat, meqenëse avokatët e caktuar nga familjet e tyre kishin ankuar më parë dhe pa sukses kundër vendimit të tyre në mungesë. Ankuesit duhet të kishin depozituar ankimet e tyre kushtetuese brenda afatit dyvjeçar të njohur me ligj, afat i cili kishte filluar ditën e ekstradimit të tyre në Shqipëri, kur ata ishin vënë në dijeni të vendimeve të dhëna në mungesë. Në vend të kësaj, ata kishin depozituar këto kërkesa pas përfundimit të procedimeve lidhur me kërkesën e tyre për rivendosjen në afat, pas skadimit të afatit dyvjeçar të njohur me ligj.

#### D. E Drejta Ndërkombëtare

##### *Konventa Evropiane për Ekstradimin*

42. Konventa Evropiane për Ekstradimin është ratifikuar nga Shqipëria më 19 maj 1998 dhe ka hyrë në fuqi më 17 gusht 1998. Neni 3 i protokollit të dytë shtesë parashikon si më poshtë:

##### **“Neni 3 – Vendimet në mungesë”**

1. Kur pala kontraktuese i kërkon një pale tjetër kontraktuese ekstradimin e personit për të kryer dënimin apo urdhër ndalimin sipas vendimit të marrë kundër tij në mungesë, pala së cilës i kërkohet ekstradimi mund të refuzojë ekstradimin për këtë qëllim nëse, sipas mendimit të saj, procedimet që çuan në këtë vendim nuk përmbushnin të drejtat minimale të mbrojtjes të njohura për pasojë për çdo person të akuzuar për një vepër penale. Megjithatë, ekstradimi lejohet nëse pala kërkuese jep siguri të mjaftueshme për t'i garantuar personit të pretenduar të drejtën për rigjykim, gjë që mbron të drejtën e mbrojtjes. Ky vendim autorizon palën kërkuese ose të zbatojë vendimin konkret, nëse personi i dënuar nuk kundërshton ose, në të kundërt, të fillojë procedimet kundër personit të ekstraduar.

2. Kur pala së cilës i kërkohet ekstradimi informon personin për të cilin është kërkuar ekstradimi për vendimin e marrë kundër tij në mungesë, pala kërkuese nuk duhet ta vlerësojë këtë komunikim si njoftim zyrtar për qëllimet e procedurës penale në atë shtet”.

#### E DREJTA

#### I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

43. Ankuesi pretendoi se procedimet penale dhe dënimi në mungesë ishin të padrejta në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili në pjesët përkatëse parashikon si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e ... çdo akuze penale kundër tij, kushdo gëzon të drejtën e të dëgjuarit ... të drejtën ... nga [1] ... gjykatë ...”

3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka këto të drejta minimale:

a) të informohet menjëherë në një gjuhë që e kupton dhe në detaje, për natyrën dhe shkakun e akuzës së ngritur kundër tij;

b) të ketë kohën e mjaftueshme dhe lehtësirat për përgatitjen e mbrojtjes së tij;

c) të mbrohet personalisht ose nëpërmjet mbrojtësit ligjor të zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin ligjor, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;

d) të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes së dëshmitarëve në emër të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës;

e) t'i ofrohet ndihma falas e një përkthyesi nëse nuk kupton ose flet gjuhën e përdorur në gjyq”.

#### **A. Pranueshmëria**

##### *1. Parashtrimet e palëve*

44. Qeveria ngriti dy argumente kryesore të papranueshmërisë. Së pari, ajo argumentoi se kërkesa ishte depozituar jashtë afatit gjashtëmuor. Së dyti, ajo argumentoi se ankuesi nuk kishte shteruar mjetet e brendshme ligjore. Ai nuk depozitoi ankim kushtetues në Gjykatën Kushtetuese për të ankuar, për padrejtësinë e procedimeve. Ai nuk paraqiti asnjë ankim për rishikimin e dënimin të formës së prerë në mungesë, sipas nenit 450 të KPP-së, dhe as për rivendosjen në afat sipas nenit 147 të KPP-së.

45. Ankuesi parashitroi se ai depozitoi një ankim pranë Gjykatës pasi ishte arrestuar nga autoritetet turke, kur për herë të parë ishte vënë në dijeni mbi vendimin e autoriteteve shqiptare në mungesë. Për sa i përket shterimit të mjeteve ligjore të brendshme, ai argumentoi se ishin të paefektshme.

##### *2. Vlerësimi i Gjykatës*

**a) Në lidhje me mosrespektimin e afatit gjashtëmuor**

46. Gjykata përsërit se ajo “mund të shqyrtojë një çështje ... brenda gjashtë muajve nga data kur është marrë vendimi i formës së prerë” (shih, ndër të tjera, *Alimuçaj k. Shqipërisë*, nr. 20134/05, § 139, 7 shkurt 2012; dhe *Paul dhe Aundrey Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar* (dec.), nr. 46477/99, 7 qershor 2001). Periudha gjashtëmuore fillon që nga data në të cilën ankuesi ka marrë dijeni të mjaftueshme dhe efektive mbi vendimin e brendshëm të formës së prerë (shih, ndër të tjera, *Baghli k. Francës*, nr. 34374/97, § 31, ECHR

1999-VIII). Është detyrë e shtetit, i cili bazohet në mosrespektimin e afatit gjashtëmuor të përcaktojë datën kur ankuesi u njoftua për vendimin e brendshëm të formës së prerë (*Sahmo k. Turqisë* (dec.), nr. 37415/97, 1 prill 2003).

47. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se dënimi i ankuesit në *mungesë* është lënë në fuqi nga me anë të vendimit të formës së prerë të Gjykatës së Lartë më 14 shkurt 2003. Ankuesi është njoftuar për këtë vendim më 3 qershor 2006 kur është arrestuar nga autoritetet turke. Ky fakt nuk është kundërshtuar. Ai depozitoi një ankim pranë Gjykatës më 28 gusht 2006, brenda afatit gjashtëmuor të njoftimit të dënimit të tij në *mungesë*. Në këto rrethana, Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë.

#### **b) Në lidhje me mosshkrimin e mjeteve të brendshme ligjore**

##### *i) Mosparaqitja e ankimit kushtetues*

48. Gjykata përsërit se detyrimi i ankuesve është pikërisht shkrimi i mjeteve të brendshme ligjore, të cilat janë të vlefshme në teori dhe praktikë në periudhën përkatëse dhe të cilat ata mund t'i fillojnë vetë – që do të thotë, mjete ligjore që janë të aksesueshme, që mund të sigurojnë ndreqjen e ankimeve të tyre dhe që ofrojnë perspektiva të arsyeshme suksesi (shih, për shembull, *Sejdovic k. Italisë* [GC], nr. 56581/00, § 46, 1 mars 2006). Për më tepër, vlerësimi nëse janë shtruar mjetet e brendshme ligjore normalisht bëhet duke i referuar datës në të cilën është depozituar ankimi në Gjykatë, megjithëse ky rregull përbën një përjashtim, i cili mund të justifikohet nga rrethanat specifike sipas rastit (shih *Baumann k. Francës*, nr. 33592/96, § 47, ECHR 2001-V, dhe *Babylonová k. Sllovakisë*, nr. 69146/01, § 44, ECHR 2006-VIII).

49. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se dënimi i ankuesit në *mungesë* është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë më 14 shkurt 2003. Ajo nuk ishte e mendimit që ankuesi të depozitonte ankim kushtetues brenda dy vjetëve nga data e vendimit të Gjykatës së Lartë, meqenëse ishte përcaktuar se ai nuk kishte marrë dijeni për dënimin e tij në *mungesë* deri më 3 qershor 2006, kur ai u arrestua nga autoritetet turke (shih *Shkalla k. Shqipërisë*, nr. 26866/05, §§ 52 dhe 53, 10 maj 2011, në të cilën Gjykata Kushtetuese, më 1 shkurt 2005, e deklaroi ankimin kushtetues të ankuesit të parashkruar, ku afati kohor ka filluar në datën e dhënies së vendimit në *mungesë* të Gjykatës së Lartë dhe jo në momentin kur ankuesi është vënë në dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë). Për rrjedhojë, në kohën e depozitimit të ankimit të tij pranë Gjykatës, nuk mund të pritët që ankuesi të ketë depozituar ankimin kushtetues, i cili në atë kohë nuk i ofronte atij asnjë perspektivë të arsyeshme suksesi (shih *Pikić k. Kroacisë*, nr. 16552/02, §§ 30-32, 18 janar 2005). Qeveria nuk parashtrroi asnjë provë për të

kundërtën dhe nuk ekzistojnë rrethana të veçanta për të justifikuar përjashtimin e këtij rregulli (krahaso *Balakchiev dhe të tjerë k. Bullgarisë* (dec.), nr. 65187/10, 18 qershor 2013; *Demopoulos dhe të tjerë k. Turqisë* (dec.), [GC], nr. 46113/99, 3843/02, 13751/02, 13466/03, 10200/04, 14163/04, 19993/04 dhe 21819/04, ECHR 2010; *Nogolica k. Kroacisë* (dec.), nr. 77784/01, 5 shtator 2002; *Andrášik dhe të tjerë k. Sllovakisë* (dec.), nr. 57984/00, 60237/00, 60242/00, 60679/00, 60680/00, 68563/01 dhe 60226/00, ECHR 2002-IX; *Brusco k. Italisë* (dec.), nr. 69789/01, ECHR 2001-IX). Për rrjedhojë, Gjykata e rrëzoi këtë kundërshtim.

50. Megjithatë, duke pasur parasysh zhvillimet në praktikën ligjore të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafët 40 dhe 41 më lart), Gjykata do të pranonte se, pas datës 26 nëntor 2009, në çështje të ngjashme me atë konkrete, ankuesit nuk mund të shkarkohen nga detyrimi i tyre për të depozituar ankim kushtetues kundër gjykimit të tyre dhe dënimit në *mungesë* menjëherë pasi ata janë ekstraduar në Shqipëri dhe u është dhënë një kopje e vendimit të dhënë në *mungesë*.

51. Për Gjykatën, çështja është nëse ankuesi kishte mjetet për të kërkuar rifillimin e procedimeve të mbajtura në *mungesë*. Gjykata do t'i kthehet kësaj çështjeje më poshtë.

##### *ii) Mosparaqitja e ankimit për rishikimin e vendimit të formës së prerë*

52. Gjykata vëren se, në kohën e paraqitjes së ankimit dhe deri në vitin 2010, arsyet shtruese të nenit 450 të KPP-së nuk mund të ishin të bazueshme për të depozituar ankimin për rishikimin e vendimit përfundimtar, e aq më pak të vendimit në *mungesë*. Qeveria nuk ka parashtruar asnjë provë për të kundërtën. Më 17 shtator 2010, Gjykata e Lartë e zgjeroi zbatimin e nenit 450 për të lejuar rishikimin e vendimeve të formës së prerë të dhëna në *mungesë* lidhur me personin e ekstraduar, me kusht që ministri i Drejtësisë të ketë siguruar se personi i ekstraduar do të rigjykohej. Kjo linjë praktikash ligjore është zbatuar në rastet vijuese nga Gjykata e Lartë (shih paragrafët 37-39 më lart).

53. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, ndërkohë që kërkesa e ekstradimit ka të ngjarë të jetë bërë nga autoritetet shqiptare, Gjykatës nuk i janë paraqitur kushtet e asnjë sigurie dhënë Turqisë nga Shqipëria. Po kështu, Gjykata nuk është në dijeni të ndonjë lëshimi të bërë për të mundësuar Gjykatën e Lartë të procedojë sipas nenit 450 të KPP-së me një kërkesë për rigjykim. Në këto rrethana, Gjykata rrëzon si të pabazuar kundërshtimin e Qeverisë sipas këtij kreu.

##### *iii) Mosparaqitja e ankimit për rivendosjen në afat*

54. Gjykata vëren se sipas nenit 147 § 2 të KPP-së i pandehuri mund të depozitonte ankim për rivendosjen në

afat, me kusht që dënimi të jetë dhënë në *mungesë* dhe i pandehuri të mos jetë vënë në dënimin për dënimin. Ankimi për rivendosjen në afat duhet të depozitohet brenda dhjetë ditëve nga njoftimi i dënimit në *mungesë* pranë gjykatës që dënoi të pandehurin (shih paragrafin 36 më lart). Sipas praktikës së brendshme ligjore, afati dhjetëditor fillon nga data kur i pandehuri i është dorëzuar autoriteteve shqiptare, kur supozohet se është vënë në dënimin për vendimin në *mungesë* (shih vendimin e Gjykatës së Rrethit në paragrafët 25-26 më lart). Menjëherë pasi është lejuar rivendosja në afat, i pandehuri ka mundësinë të ankojë kundër vendimit në *mungesë*, duke parashtruar argumente faktike dhe ligjore, të cilat i konsideron të nevojshme për mbrojtjen e tij gjatë procedimeve të ankimit.

55. Gjykata vëren më tej se, sipas praktikës ligjore të kohëve të fundit të Gjykatës së Lartë, kërkesa e të pandehurit për rivendosjen në afat nuk do të pranohet kur avokati i caktuar nga familja ka ankuar më parë dhe pa sukses pranë Gjykatës së Lartë dhe kur një i bashkëpandehur ka ankuar kundër vendimit dhe meritat e çështjes janë shqyrtuar në tërësi (shih paragrafët 28-43 më lart).

56. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se avokati i caktuar nga familja i ankuesit jo vetëm ka apeluar më parë dhe pa sukses pranë Gjykatës së Lartë, por edhe i bashkëpandehuri tjetër ka ankuar më parë dhe pa sukses kundër të gjitha vendimeve të gjykatave. Në këto rrethana, kërkesa për rivendosjen në afat do të ishte e destinuar të dështonte.

57. Gjykata rrëzon kundërshtimin e Qeverisë sipas këtij kreu.

#### **b) Konkluzioni**

58. Gjykata vlerëson se ky ankim nuk është haptazi i pabazuar në kuptim të nenit 35 § 3 (a) të Konventës. Duke mos qenë i papranueshëm për arsye të tjera, për rrjedhojë, duhet të deklarohet i pranueshëm.

#### **B. Meritat (themeli)**

##### *1. Parashtrimet e palëve*

59. Ankuesi pretendonte se ishte gjykuar dhe dënuar në *mungesë* dhe se nuk ekzistonin mjetet ligjore për t'i siguruar mundësinë e rigjyimit.

60. Qeveria pranoi se ankuesi ishte gjykuar dhe dënuar në *mungesë*. Megjithatë, duke u bazuar në parashtrimet e çështjes *Haxhia k. Shqipërisë* (nr. 29861/03), ajo argumentoi se procedimet e brendshme nuk kishin qenë të padrejta. Ajo, gjithashtu, argumentoi se i pandehuri ishte përfaqësuar nga një avokat i caktuar nga gjykata ose nga familja dhe se ishin respektuar të drejtat e mbrojtjes së ankuesit.

##### *2. Vlerësimi i Gjykatës*

61. Gjykata kujton parimet e përgjithshme për sa u përket procedimeve në *mungesë* të përshkruara në vendimin *Sejdovic*, cituar më lart (referimet janë hequr).

“81. Megjithëse nuk përmendet shprehimisht në paragrafin 1 të nenit 6, objekti dhe qëllimi i nenit marrë në tërësi tregon se një person “i akuzuar për një vepër penale” ka të drejtë të marrë pjesë në seancën gjyqësore. Për më tepër, nënparagrafët (c), (d) dhe (e) të paragrafit 3 i garantojnë “çdo personi të akuzuar për një vepër penale” të drejtën “të mbrohet vetë” “të pyesë ose të kërkojë të pyeten dëshmitarët” dhe “t’i ofrohet ndihma falas e një përkthyesi nëse ai nuk kupton ose flet gjuhën e përdorur në gjykatë”, dhe është e vështirë të kuptohet se si ai mund të ushtronte këto të drejta pa qenë i pranishëm (...).

82. Megjithëse procedimet e bëra në *mungesë* të pandehurit nuk janë në vetvete të papajtueshme me nenin 6 të Konventës, gjithsesi mohimi i drejtësisë ndodh pa dyshim kur një person i dënuar në *mungesë* nuk është në gjendje më pas të përfitojë nga gjykata, e cila ka dëgjuar përcaktimin e tij të ri të meritave të akuzës, si për sa i përket së drejtës ashtu edhe fakteve, kur nuk është përcaktuar se ai ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur vetë (...) ose se ai synonte t’i shpëtonte gjykimin (...).

83. Konventa u lë shteteve kontraktuese diskrecion të gjerë në lidhje me zgjedhjen e mjetit të llogaritur për të garantuar se sistemet e tyre ligjore janë në përputhje me dispozitat e nenit 6. Detyra e Gjykatës është të përcaktojë nëse është arritur rezultati i kërkuar sipas Konventës. Në veçanti, mjetet procedurale, të ofruara nga e drejta dhe praktika e brendshme, duhet të tregojnë se janë efektive kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk ka hequr dorë nga e drejta e tij për t’u paraqitur dhe për t’u mbrojtur vetë dhe as nuk ka kërkuar t’i shmanget gjykimin.

84. Gjykata më tej ka vendosur se detyra për të garantuar të drejtën e të pandehurit penal për të qenë i pranishëm në sallën e gjyqit... ose gjatë procedimeve të para ose në rigjykim – radhitet si një nga kërkesat themelore të nenit 6 (...). Për rrjedhojë, refuzimi për të rifilluar procedimet e kryera në *mungesë* të të pandehurit, pa treguar se i pandehuri ka hequr dorë nga e drejta e tij për të qenë i pranishëm gjatë gjykimin, është konstatuar si “mohim flagrant i drejtësisë”, duke bërë që procedimet të jenë “haptazi në kundërshtim me dispozitat e nenit 6 ose parimet e shprehura në të” (...).

85. Gjykata ka vendosur, gjithashtu, se rivendosja në afat e ankimit kundër dënimit në *mungesë*, kur i pandehuri gëzonte të drejtën të merrte pjesë në seancën gjyqësore në gjykatën e apelit dhe të kërkonte pranimin e provave të reja, krijonte mundësinë e përcaktimit të ri faktik dhe ligjor të akuzës penale, prandaj procedimet në tërësi mund të thuhet se kanë qenë të drejta (...).

86. As forma dhe as përmbajtja e nenit 6 të Konventës nuk pengojnë një person që me vullnetin e tij të lirë, të heqë dorë në mënyrë të shprehur ose nënkuptuar, nga e drejta e garantimit të një gjykimi të drejtë (...). Megjithatë, nëse duhet të jetë e efektshme për qëllimet e Konventës, heqja dorë nga e drejta për të marrë pjesë në një gjykim duhet të përcaktohet në mënyrë të qartë dhe kërkon garancitë minimale në përpjesëtim me rëndësinë e saj (...). Për më tepër, ajo nuk duhet të jetë në kundërshtim me asnjë interes të rëndësishëm publik.

87. Gjykata ka vendosur se kur një person i akuzuar për një vepër penale nuk është vënë në dënimin personalisht, nuk mund të arrihet thjesht në përfundimin nga statusi i tij “në *mungesë*”, që u krijua nga prezumimi me bazë të pamjaftueshme faktike, se ai ka hequr dorë nga e drejta të paraqitet në gjyq dhe të mbrohet vetë (...). Ajo pati rastin, gjithashtu, të theksojë se, para se të mund të thuhet se i pandehuri në mënyrë të nënkuptuar, nëpërmjet sjelljes së tij, ka hequr dorë nga një e drejtë e rëndësishme sipas nenit 6 të Konventës, duhet të tregohet se në mënyrë të arsyeshme ai mund të kishte parashikuar se cilat do ishin pasojat e sjelljes së tij (...).

88. Për më tepër, një personi të akuzuar për një vepër penale nuk duhet t'i lihet barra e provës për të vërtetuar se nuk kërkonte t'i shmangej drejtësisë apo se mungesa e tij ishte për shkak të një force madhore (...). Në të njëjtën kohë, është pikërisht detyrë e autoriteteve të brendshme të vlerësojnë nëse i pandehuri kishte arsye të forta për mungesën e tij apo nëse dosja e çështjes përmbante ndonjë element që justifikonte konstatimin se ai kishte munguar për arsye jashtë kontrollit të tij (...).

89. Sipas termave të paragrafit 3 (a) të nenit 6 të Konventës, çdo person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtën "të informohet menjëherë, në gjuhën që ai kupton dhe në detaje, mbi natyrën dhe shkakun e akuzës kundër tij". Kjo dispozitë thekson domosdoshmërinë për vëmendjen e veçantë që duhet t'i kushtohet njoftimit të "akuzës" të pandehurit. Aktakuza luan rol thelbësor në procesin penal, në faktin që pikërisht nga momenti i njohjes së saj i pandehuri vihet në dijeni zyrtarisht mbi bazën ligjore dhe faktike të akuzave kundër tij (...).

90. Qëllimi i dispozitës së mësipërme duhet të vlerësohet në veçanti në dritën e së drejtës më të përgjithshme për një gjykim të drejtë garantuar nga neni 6 § 1 i Konventës. Në çështjet penale, sigurimi i informacioneve të plota dhe të detajuara lidhur me akuzat kundër të pandehurit, dhe për pasojë karakterizimi ligjor se gjykata mund të miratonte çështjen, përbën një kusht paraprak thelbësor për të garantuar se procedimet janë të drejta (...).

91. Megjithëse joabsolote, e drejta e çdo personi të akuzuar për një vepër penale për t'u mbrojtur efektivisht nga një avokat, nëse është e nevojshme, të caktuar zyrtarisht, përbën një nga karakteristikat themelore të një gjykimi të drejtë (...). Personi i akuzuar për një vepër penale nuk humbet përfitimim e kësaj të drejte thjesht për shkak të mospranisë së tij në gjyq (...). Është me rëndësi vendimtare për drejtësinë e sistemit të drejtësisë penale që i pandehuri të mbrohet si duhet, si në shkallë të parë ashtu edhe në apel (...).

92. Në të njëjtën kohë, është me rëndësi kryesore që i pandehuri duhet të paraqitet, si për shkak të së drejtës së tij për të marrë pjesë në gjyq ashtu edhe për shkak të domosdoshmërisë për të vërtetuar saktësinë e deklarimeve të tij dhe për t'i krahasuar me ato të viktimës – interesat e të cilit dhe të dëshmitarit duhet të mbrohen. Për pasojë, legjislatura duhet të jetë në gjendje të prapësojë mungesa të pajustificuara, me kusht që sanksionet e përdorura të mos jenë në disproporcion me rrethanat e çështjes dhe të pandehurit të mos i hiqet e drejta e mbrojtjes me avokat (...).

93. Është detyrë e gjykatave të sigurojnë se gjykimi ishte i drejtë dhe, për rrjedhojë, se avokati, i cili mori pjesë në gjyq për të mbrojtur të pandehurin në mungesë të tij, të ketë mundësinë të kryejë këtë detyrë (...).

94. Ndërkohë që çdo personi të akuzuar për një vepër penale i njihet e drejta "të mbrohet vetë ose nga një avokat ...", neni 6 § 3 (c) nuk specifikon mënyrën se si ushtrohet kjo e drejtë. Për rrjedhojë, janë pikërisht shtetet kontraktuese që zgjedhin mjetin për të garantuar sigurimin e kësaj të drejte në sistemin e tyre gjyqësor, ku detyra e Gjykatës është të sigurojë nëse metoda e zgjedhur prej tyre është në përputhje me kërkesat për një gjykim të drejtë (...). Në lidhje me këtë, duhet të kujtohet se Konventa është hartuar "të garantojë jo të drejtat që janë teorie ose zhgënjyese, por të drejtat që janë praktike dhe efektive" dhe se përcaktimi i avokatit nuk siguron në vetvete efektivitetin e ndihmës që ai duhet t'i japë të pandehurit (...).

95. Megjithatë, shteti nuk mund të jetë përgjegjës për çdo mangësi të avokatit të caktuar për ndihmë ligjore ose të pandehurit. Nga pavarësia e profesionit ligjor nga shteti, rrjedh se sjellja e mbrojtjes është në thelb çështje ndërmjet të pandehurit

dhe avokatit të tij, nëse është caktuar nëpërmjet skemës së ndihmës ligjore apo është financuar privatisht (...). Sipas nenit 6 § 3 (c), autoritetet e brendshme kompetente duhet të ndërhyjnë vetëm në rast se është treguar ose në ndonjë mënyrë tjetër është sjellë mjaftueshmërisht në vëmendjen e tyre, mungesa e ndihmës ligjore për të siguruar përfaqësimin efektiv (...). "

62. Gjykata thekson më tej se garancitë e shprehura në paragrafin 3 të nenit 6 janë aspekte specifike të së drejtës për një gjykim të drejtë përcaktuar në paragrafin 1 (shih *Edwards k. Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, §33, seria A nr. 247-B).

63. Në çështjen në fjalë, nuk është kundërshtuar nga palët se i pandehuri është gjykuar dhe dënuar në mungesë. Po kështu, nuk është treguar se ai kishte dijeni të mjaftueshme për procedimet ligjore kundër tij. Në të vërtetë, është argumentuar se ai ishte njoftuar për dënimin e tij në mungesë vetëm më 3 qershor 2006, kur u arrestua nga autoritetet turke. Gjithashtu, nuk është treguar se në mënyrë të shprehur apo nënkuptuar ai ka autorizuar anëtarët e familjes të bëjnë ankimet në apel ose në mënyrë të qartë ka hequr dorë nga e drejta e tij për t'u paraqitur në gjyq duke iu shmangur në mënyrë të qëllimshme drejtësisë. Sipas së drejtës së brendshme, ankuesi nuk ka pasur mundësi të kërkojë rigjykimin e çështjes së tij (shih paragrafët 48-57 më lart).

64. Sa më sipër, Gjykata konstaton se ankuesi nuk kishte mundësinë të përfntonte një përcaktim të ri të meritave të akuzave kundër tij nga një gjykatë, e cila do ta dëgjonte atë gjatë procedimeve në përputhje me garancitë e drejtësisë të nenit 6.

65. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

## II. SHKELJE TË TJERA TË PRETENDUARA TË KONVENTËS

66. Ankuesi ngriti ankime sipas nenit 5 §§ 1 dhe 2, nenit 6 § 2, si dhe nenit 7 të Konventës, të ngjashme me ato të ngritura nga dy prej të bashkëpandehurve të tij në rastet *Haxhia*, cituar më lart, i cili akoma nuk ka marrë formë të prerë dhe *Mulosmani*, cituar më lart, i cili akoma nuk ka marrë formë të prerë.

67. Gjykata ka shqyrtuar ankimet e mësipërme të parashtruara nga ankuesi. Megjithatë, në dritën e të gjitha materialeve që posedon, dhe për çështjet e ankimuar, të cilat janë në kompetencë të saj, Gjykata konstaton se ato nuk zbulojnë asnjë element të shkeljes të të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë apo protokollin e saj. Rezulton se kjo pjesë e ankimit është haptazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

## III. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

68. Neni 41 i Konventës parashikon:

"Kur Gjykata konstaton se ka pasur shkelje të Konventës apo të protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e palës së lartë kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar."

**A. Dëmi**

69. Ankuesi nuk parashtroi pretendime për dëmet. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se nuk ka arsye t'i akordojë ndonjë shumë mbi këtë bazë.

70. Gjykata përsërit konstatimet e saj në çështjen *Shkalla k. Shqipërisë* (nr. 26866/05, §§ 77-79, 10 maj 2011), se kur një ankues është dënuar në shkelje të drejtave të tij të garantuara nga neni 6 i Konventës, forma më e përshtatshme e ndreqjes do të ishte që sa të jetë e mundur ankuesi të vendoset në pozicionin që do të kishte qenë nëse kjo dispozitë do të respektohej. Forma më e përshtatshme e ndreqjes, në parim, do të ishte gjykimi *de novo* ose rifillimi i procedimeve nëse kërkohet (shih, gjithashtu, *Xheraj k. Shqipërisë*, nr. 37959/02, § 82, 29 korrik 2008; *Caka k. Shqipërisë*, nr. 44023/02, § 122, 8 dhjetor 2009, dhe *Laska k. Shqipërisë*, cituar më lart, §§ 73-77).

**B. Kostot dhe shpenzimet**

71. Ankuesi pretendoi 200,000 lekë (1,409 euro) për kostot dhe shpenzimet e bëra para kësaj Gjykate dhe 275,000 lekë (1,937 euro) për kostot dhe shpenzimet e bëra para gjykatave të brendshme.

72. Qeveria nuk parashtroi asnjë koment.

73. Referuar praktikës ligjore të Gjykatës, ankuesi ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm në masën që është provuar se ato janë shkaktuar në të vërtetë dhe domosdoshmërisht dhe ishin të arsyeshme në masë. Në çështjen në fjalë, duke marrë parasysh faktin se nuk është vërtetuar qartë se ankuesi ka bërë shpenzimet e pretenduara para gjykatave të brendshme, Gjykata vlerëson të arsyeshme t'i akordojë shumën prej 1,400 eurosh për procedimet para Gjykatës.

**C. Interesi i mospagimit**

74. Gjykata çmon të nevojshme se interesi i mospagimit duhet të bazohet në nivelin marxhinal të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, të cilit duhet t'i shtohen 3 për qind.

**PËR KËTO ARSYE, GJYKATA UNANIMISHT**

1. *Deklaron* ankimin e ankuesit sipas nenit 6 të Konventës të pranueshëm lidhur me dënimin e tij në mungesë dhe pjesën e mbetur të ankimit të papranueshëm.

2. *Vendos* se ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës.

3. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t'i paguajë ankuesit, brenda tre muajve nga data e daljes së vendimit përfundimtar, në përputhje me nenin 44 § 2 të Konventës, 1,400 euro (një mijë e katërqind euro) për kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund të vihet, të konvertuara në monedhën e brendshme në kursin e këmbimit në datën e pagesës;

b) që prej skadimit të periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në pagim, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë të barabartë me kursin marxhinal të huas të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 për qind.

4. *Rrëzon* pjesën tjetër të mbetur të pretendimit të ankuesit për shpërblim të drejtë.

Bërë në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 5 nëntor 2013, në përputhje me nenin 77 §§ 2 dhe 3 të rregullores së Gjykatës.

**Françoise Elens-Passot**  
SEKRETAR

**Ineta Ziemele**  
KRYETAR



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014

Adresa: bulevardi “Gjergj Fishta”, pas ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel: 04 24 27 005, 04 24 27 006

Çmimi 60 lekë